

LIGJ
Nr.9918, datë 19.5.2008

PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË¹
(ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012, nr. 107/2018, datë 20.12.2018)
(i ndryshuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efikente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përjashtimi nga fusha e zbatimit

1. Ky ligj nuk zbatohet për përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike.

2. Ky ligj nuk zbatohet për pajisjet e komunikimeve (në veçanti të tilla, si sistemet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve), të ndërtuara dhe të përdorura ekskluzivisht për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Megjithatë edhe në këtë rast, përdorimi i frekuencave do të kryet sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Ky ligj nuk zbatohet për transmetimet radiotelevizive, për sa kohë nuk është përcaktuar ndryshe në legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Përkufizime

(ndryshuar pikat 5, 36, 37 dhe 45 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akses” është bërja e disponueshme e lehtësive dhe/ose shërbimeve një sipërmarrësi tjetër, sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive ose joekskluzive, për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Akses, ndërmjet të tjerash, përfshin akses në elementet e rrjetit dhe fasiliteteve shoqëruese, të cilat mund të përfshijnë lidhjen e pajisjeve në mënyrë fikse ose jofikse (në veçanti kjo përfshin akses të hapur në rrjetin lokal dhe akses në fasilitetet dhe shërbimet e nevojshme, për të ofruar dhe mundësuar shërbimet e bazuara në rrjetin lokal); akses në infrastrukturën fizike, përfshirë ndërtesat, tubacionet dhe kullat; akses në sistemet e *software*-ve përkatëse, përfshirë sistemet mbështetëse operacionale; akses në përkthimin e numrit (*number translation*) apo në sistemet, që ofrojnë funksionalitet të njëvlefshëm; aksesin në rrjetet fikse apo të lëvizshme, në veçanti për *roaming-un*; aksesin në shërbimet e rrjeteve virtuale.

2. “Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare” (më poshtë AKEP) është organi rregullator, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator, të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të

¹ Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84, datë 10 qershor 2008.

Ligji nr. 102/2012, datë 24.10.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 145, datë 14 nëntor 2012.

Ligji nr. 107/2018, datë 20.12.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë 15 janar 2019.

përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

3. “Autorizim i përgjithshëm” është një akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga kuadri ligjor, i përcaktuar nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe /ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

4. “Facilitet”, si pjesë e infrastrukturës shoqëruese të komunikimeve elektronike, përfshin ndërtesën, pjesë të një ndërtese, apo mjediset e pavarura brenda një ndërtese ku janë instaluar pajisje të komunikimeve elektronike, si edhe elemente ndërtimore, të tilla si tubacione kabllorë, shtylla, antena etj.

5. “Facilitetet shoqëruese” janë ato shërbime shoqëruese, infrastruktura fizike dhe facilitete të tjera ose elemente të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi ose kanë potencial për ta bërë këtë, e që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, ndërtesat ose hyrjen në ndërtesa, kabllo të ndërtesave, antenat, kullat dhe ndërtime të tjera mbështetëse, kanalizime, tubacione, shtylla, puseta dhe kabinete.

6. “Integritet i rrjetit” është funksionimi dhe aftësia për të hyrë në veprim e rrjeteve të komunikimeve elektronike të interkonektuara mes tyre dhe mbrojtja e këtyre rrjeteve ndaj defekteve të shkaktuara nga shqetësimet elektromagnetike dhe/ose ngarkesat e punës.

7. “Identifikimi i linjës thirrëse” është funksioni që, në bazë të numrit ose kodit të caktuar për pikën fundore të rrjetit, i mundëson pajtimtarit marrësin të thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku ka pikënisjen thirrja.

8. “Identifikimi i linjës së thirrur” është funksioni, që lejon dërguesin e thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku përfundon thirrja, bazuar në numrin ose kodin që i është caktuar kësaj pike fundore të rrjetit.

9. “Interferencë” është ndikimi i një energjie të padëshiruar, të shkaktuar nga një ose më shumë kombinime të emetimeve, rrezatimeve ose induktimeve kundrejt marrësit në një sistem/stacion radiokomunikimi, i cili shoqërohet me përkeqësim të cilësisë, keqinterpretim ose humbje të informacionit, që duhet të përfitohet në mungesë të energjisë së padëshiruar.

10. “Interferencë e dëmshme” është ndërhyrja, e cila rrezikon funksionimin e shërbimit të radionavigimit ose shërbimeve të tjera të radiokomunikacioneve, të ofruara për qëllime sigurie, ose ndërhyrja që seriozisht përkeqëson, pengon ose ndërpret, në mënyrë të përsëritur, shërbimet e radiokomunikimeve, që janë duke punuar në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera nënligjore.

11. “Interkoneksioni” është lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të komunikimit, të cilat përdoren nga i njëjti operator apo operatorë të ndryshëm, në mënyrë që t’i lejojë përdoruesit e një operatori të komunikojnë me përdoruesit e të njëjtit operator ose të një operatori tjetër, ose të lejojë aksesin për shërbimet e ofruara nga një operator tjetër. Interkoneksioni është një lloj i veçantë aksesit, që zbatohet ndërmjet operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit.

12. “Kod numeracioni” është një numër apo një kombinim numrash pa prefiksin kombëtar “0”, i cili karakterizon zonën e numeracionit të thirrur. Nëse plani kombëtar i numeracionit është “i hapur” dhe kur pajtimtari thirrës dhe ai i thirrur u përkasin zonave të ndryshme të numeracionit, ky kod formohet përpara numrit të pajtimtarit të thirrur.

13. “Komunikim” është shkëmbimi ose transmetimi i informacionit ndërmjet një numri të kufizuar përdoruesish, por që nuk përfshin transmetimin e informacionit që është pjesë e transmetimeve radio-televizive nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, përveç rasteve kur informacioni mund të ketë të bëjë me një pajtimtar ose përdorues të mirënjohur, i cili merr këtë informacion.

14. “Linja me qira” është një shërbim, që përfshin ofrimin e kapaciteteve transmetuese, ndërmjet pikave të ndryshme të të njëjtit rrjet ose të rrjeteve të ndryshme, pa përfshirë funksionet komutuese, të kontrolluara prej përdoruesit të vet.

15. “Ministri” është ministri që mbulon sektorin e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, nëpërmjet drejtorisë përkatëse.

16. “Ndërfaqe” është tërësia e karakteristikave që përshkruajnë pikën e lidhjes ndërmjet dy njësive të komunikimeve elektronike, si p.sh. ndërmjet dy rrjeteve të komunikimeve, ose ndërmjet një rrjeti të komunikimeve dhe pajisjes së përdoruesit. Ndërfaqja mund të jetë pajisje (*hardware*) ose program (*software*).

17. “Numër” është një seri alfa-numerike e përcaktuar në planin e numeracionit, që shërben për adresim në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

18. “Numrat e shërbimeve të emergjencës” janë numrat e përcaktuar në planin e numeracionit për shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike për policinë, zjarrfikësit, numrat e emergjencës për shërbimet shëndetësore, shërbimet lajmëruese dhe ato të deklaruara, që përfshihen në numrin e harmonizuar evropian “112”.

19. “Numër gjeografik” është një numër kombëtar, i cili i përket një rajoni gjeografik të caktuar.

20. “Numrat jogjeografikë” janë numrat kombëtarë, që nuk i përkasin një rajoni gjeografik të caktuar dhe përfshijnë:

a) numrat për akses në rrjetet publike të lëvizshme të komunikimit;

b) numrat për akses në shërbimet me vlerë të shtuar;

c) numrat për akses në shërbimet, për të cilat e gjithë tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet nga ofruesi i shërbimeve, pra drejt numrave që janë pa pagesë për përdoruesit (numra pa pagesë, numrat jeshil);

ç) numrat për akses në shërbimet, për të cilat tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet pjesërisht nga thirrësi dhe pjesërisht nga ofruesi i shërbimit, pra drejt numrave, të cilët i janë dhënë përdoruesit përkundërt një marrëdhënie të paracaktuar (numra me ndarje të kostos, numër blu);

d) numrat për shërbim publik telefonik nomadik.

21. “Operator” është një sipërmarrës, që ofron ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese;

22. “Operator i rrjetit të komunikimeve publike” është sipërmarrësi, i cili ka të drejtë të ndërtojë, të posedojë, të japë me qira dhe të shfrytëzojë një rrjet të komunikimeve publike dhe facilitetet shoqëruese, si dhe të ofrojë shërbime të komunikimeve publike.

23. “Ofruesi i shërbimit të komunikimeve publike” është sipërmarrësi që ofron shërbime komunikimi publike, duke siguruar akses te një operator i rrjetit të komunikimeve publike.

24. “Ofrimi i një rrjeti të komunikimeve elektronike” është ndërtimi, përdorimi, mbikëqyrja ose bërja e disponueshme e një rrjeti të tillë;

25. “Ofruesi i shërbimit universal” është sipërmarrësi që ofron shërbimin universal.

26. “Pajisje fundore” është pajisja e lidhur në pikën fundore të rrjetit, e cila shërben për transmetimin, marrjen dhe përpunimin e komunikimeve.

27. “Pajisje e komunikimeve elektronike” janë pajisjet teknike për emetimin, transmetimin, rrugëzimin, komutimin dhe/ose marrjen e sinjaleve nëpërmjet valëve elektromagnetike.

28. “Pajtimtar” është cildo që ka lidhur një kontratë me një sipërmarrës që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për përfitimin e shërbimeve të ofruara.

29. “Përdorues” është cildo që përdor ose kërkon të përdorë shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.

30. “Përdorues fundor” është një përdorues, i cili nuk ofron rrjete komunikimesh publike ose shërbime komunikimesh elektronike, të disponueshme për publikun.

31. “Pika fundore e rrjetit” është pika fizike, në të cilën një pajtimtar ka akses në rrjetin e komunikimeve publike. Në rastin e rrjeteve, që përfshijnë komutimin ose rrugëzimin pika fundore e rrjetit identifikohet si një adresë specifike e rrjetit, e cila mund të lidhet me numrin ose emrin e një pajtimtari.

32. “Plani i numeracionit” është struktura e numrave dhe e serive të numrave, si dhe caktimi i tyre për sigurimin e aksesit në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.

33. “Plani kombëtar i frekuencave” është dokumenti, që përcakton brezat e frekuencave për shërbime të ndryshme dhe vendos kushtet bazë për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, për përdorimin me efektivitet të spektrit të frekuencave dhe shmangien e interferencave.

34. “Postë elektronike” është çdo mesazh në formën e tekstit, tingullit apo imazhit, të dërguar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve, i cili mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen fundore të marrësit derisa marrësi ta marrë atë.

35. “Qarku lokal” është qarku fizik, që lidh pikën fundore të rrjetit në mjedisin e pajtimtarit me permutatorin (MDF) ose pajisjet e barazvlefshme në rrjetin publik telefonik fiks.

36. “Rrjet i komunikimeve elektronike” janë sistemet e transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse tokësore (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kabllave elektrike, në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe rrjetet kabllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.

37. “Rrjet i komunikimeve publike” është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret,

tërësisht ose kryesisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun dhe që suporton transferimin e informacionit ndërmjet pikave fundore të rrjetit.

38. “Rrjet telefonik publik” është një rrjet i komunikimeve elektronike, i cili përdoret për të ofruar shërbime telefonike të disponueshme për publikun. Ai mundëson përcjelljen ndërmjet pikave fundore të rrjetit të komunikimit zanor, si edhe të formave të tjera të komunikimit, të tilla si faksimile dhe të dhëna etj.

39. “Rrjet i qëndrueshëm (fiks) i komunikimeve publike “ është rrjeti, në të cilin pikat fundore janë të vendosura në vende të fiksuara.

40. “Rrjet i lëvizshëm i komunikimeve publike “ është rrjeti, në të cilin pikat fundore nuk janë të vendosura në vende të fiksuara.

41. “Sipërmarrës” është çdo person fizik, juridik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, i cili ofron rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike.

42. “Spektri i frekuencave” përfshin valët elektromagnetike në diapazonin e frekuencave 9 KHz deri 3000 GHz, të cilat përhapen në efir pa nevojën e linjave të veçanta.

43. “Shërbim i komunikimeve elektronike” është shërbimi, normalisht përkundrejt një pagese, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përfshin shërbimet e telekomunikacioneve dhe shërbimet e transmetimit në rrjetet e përdorur për transmetime radiotelevizive dhe në rrjetet e televizionit kabllor, por duke përjashtuar shërbimet, të cilat ofrojnë përmbajtje nëpërmjet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së ofruar për transmetimin, duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit, të cilat nuk përbëhen, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike.

44. “Shërbimi i komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun” është shërbimi i komunikimeve elektronike, nga përdorimi i të cilit asnjë person nuk është, paraprakisht, i përjashtuar.

45. “Shërbim telefonik i disponueshëm për publikun” është një shërbim i disponueshëm për publikun për origjinimin dhe marrjen direkte ose indirekte të thirrjeve kombëtare, apo kombëtare e ndërkombëtare, nëpërmjet një ose më shumë numrave në një plan numeracioni telefonik kombëtar ose ndërkombëtar.

46. “Shërbim publik telefonik i lëvizshëm tokësor” është shërbimi publik telefonik, i ofruar për përdoruesit, nëpërmjet një rrjeti publik telekomunikacionesh pikat fundore të të cilit nuk janë në vendndodhje të qëndrueshme, duke u dhënë mundësi përdoruesve të komunikojnë brenda zonave të mbuluara nga ky shërbim, pavarësisht nga vendndodhja.

47. “Shërbim publik telefonik i qëndrueshëm (i palëvizshëm)” është shërbimi publik telefonik, i ofruar për përdoruesit, pajisjet fundore të të cilëve lidhen në pikat fundore me vendndodhje të qëndrueshme të rrjetit publik të telekomunikacioneve.

48. “Shërbim publik telefonik nomadik” është shërbimi publik telefonik i ofruar për përdoruesit nëpërmjet një rrjeti të komunikimeve elektronike, ku pajisjet fundore të përdoruesit lidhen me pikat fundore të rrjetit të qëndrueshëm, të cilat mund të ndodhen në njësi gjeografike të ndryshme.

49. “Shërbimi i radiokomunikimeve” është veprimtaria, që mbulon komunikimet, që përfshin transmetimin, emetimin dhe marrjen e sinjaleve nëpërmjet valëve të radios.

50. “Shërbimet e shoqërisë së informacionit” janë shërbime që ofrohen përkundrejt pagesës, në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit. “Në distancë” kuptohet se shërbimi ofrohet pa qenë e nevojshme që të dyja palët të jenë të pranishme në të njëjtën kohë. “Nëpërmjet mjeteve elektronike” kuptohet se shërbimi dërgohet nga pika e origjinës dhe merret në destinacionin përfundimtar, nëpërmjet pajisjeve elektronike të përpunimit (duke përfshirë edhe kompresimin numerik) dhe ruajtjes së të dhënave. Dërgimi, transmetimi dhe marrja e plotë bëhen nëpërmjet kablllove, radiovalëve, mjeteve optike dhe mjeteve të tjera elektromagnetike. “Me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit” kuptohet se shërbimet ofrohen nëpërmjet transmetimit të të dhënave me kërkesën individuale të marrësit.

Shërbimet e shoqërisë së informacionit përfshijnë, në veçanti, shitjen e mallrave dhe të shërbimeve, shërbimet e aksesit të informacionit apo të reklamave në internet dhe aksesit në shërbimet e rrjeteve publike të komunikimit, në transmetimin e të dhënave ose ruajtjen e të dhënave të marrësit në rrjetin publik të komunikimeve.

51. “Shërbim me vlerë të shtuar” është shërbimi që ofron informacion, përkundrejt pagesës, nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit.

52. “Shërbimi universal” është një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballueshme.

53. “Tarifë e orientuar drejt kostos” është tarifa që reflekton kostot e shfrytëzimit eficient dhe të frytshëm, duke mundësuar një normë fitimi të arsyeshme për sipërmarrësin.

54. “Telefon publik me pagesë” është telefoni i disponueshëm për publikun, përdorimi i të cilit paguhet me mjete, si monedha dhe/ose kartë krediti, debiti dhe/ose karta të parapaguara, përfshirë dhe kartat me kod aksesi.

55. “Të dhëna për trafikun e komunikimeve” është çdo e dhënë e përpunuar për qëllime të transmetimit të komunikimeve në një rrjet të komunikimeve elektronike ose për qëllime faturimi.

56. “Të dhëna për vendndodhjen” është çdo e dhënë e përpunuar në një rrjet të komunikimeve elektronike, që tregon pozicionin gjeografik të pajisjes fundore të një përdoruesi të rrjetit të komunikimeve elektronike.

57. “Transmetim radioteleviziv” është transmetimi i programeve të shërbimeve të radios dhe televizionit nëpërmjet një antene tokësore, rrjeti të komunikimeve elektronike ose satelitore, në formë të koduar ose jo, për t’u marrë nga publiku.

58. “Thirrje” është lidhja ndërmjet dy pikave fundore, e realizuar nëpërmjet shërbimit telefonik të disponueshëm për publikun, e cila lejon komunikimin dydrejtimësh.

59. “Zonë numeracioni gjeografike” është një rajon gjeografik i përcaktuar, i cili ka një kod të caktuar numeracioni.

60. “Organi i Rregullatorëve Europeanë për Komunikimet Elektronike (BEREC)” është organi i krijuar nga Rregullorja (KE) nr. 1211/2009 e Parlamentit European dhe e Këshillit e 25 nëntorit 2009.

61. “Përcaktimi i një brezi frekuencash” është destinimi i një brezi të dhënë frekuencash në Planin Kombëtar të Frekuencave, me qëllim përdorimi nga një ose më shumë shërbime radio-komunikimi, sipas kushteve specifike.

62. “Caktim i frekuencave” është dhënia e autorizimit për përdorimin e një frekuence apo kanali frekuence, sipas kushteve specifike.

63. “Pëlqim i subjektit të të dhënave” është çdo deklaratë me vullnet të plotë e të lirë, e dhënë shprehimisht dhe në dijeni të plotë për çfarë të dhënash do të përpunohen, me të cilën nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij.

64. “Skedar” është një bashkësi të dhënash të ndërlidhura mes tyre, që ruhen në një pajisje ruajtje të dhënash elektronike.

65. “Shërbime shoqëruese” janë ato shërbime të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi ose kanë potencial për ta bërë këtë, dhe që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, përkthimin e numrave ose sistemet e ofritit të funksionalitetit ekuivalent, sistemet e aksesit të kushtëzuar dhe udhëzuesit e programit elektronik, gjithashtu, shërbime të tjera të tilla, si shërbimet e identitetit, vendndodhjes dhe prezencës.

66. “Cenim i të dhënave personale” është çdo cenim i sigurisë që çon në shkatërrimin, humbjen, ndryshimin ose shpërndarjen e paautorizuar, aksidentale apo të paligjshme ose aksesit në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara, në lidhje me ofrimin e një shërbimi të komunikimeve elektronike të disponueshëm për publikun.

KREU II

ORGANET KOMPETENTE NË FUSHËN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE KOMPETENCAT E TYRE

Neni 4

Organet kompetente në fushën e komunikimeve elektronike

Organet kompetente në fushën e komunikimeve elektronike janë ministri, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit (KKRT).

Neni 5

Kompetencat e ministrit

(shtuar fjalë në pikën 3, ndryshuar pikat 4 dhe 10 dhe shfuqizuar pikat 12 dhe 13 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

Ministri përgjegjës ka këto kompetenca:

1. Harton dhe paraqet në Këshillin e Ministrave propozimet për politikën e sektorit të komunikimeve elektronike.

2. Ndjek zbatimin e politikës së Qeverisë të Republikës së Shqipërisë në sektorin e komunikimeve elektronike.

3. Harton dhe paraqet në Këshillin e Ministrave projektaktet ligjore e nënligjore, për zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike.

4. Mund të nxjerrë urdhra dhe udhëzime me karakter normativ për çështje që lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe politikave të zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

5. Përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë në fushën e komunikimeve elektronike. Harton dhe nënshkruan, në emër të Republikës së Shqipërisë, marrëveshje ndërkombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe, në fushën e komunikimeve elektronike.

6. Ndjek zbatimin e detyrimeve për fushën e komunikimeve elektronike, që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare, ku aderon Republika e Shqipërisë.

7. Kërkon dhe përpunon të dhënat statistikore nga sipërmarrësit, që kryejnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike.

8. Bashkëpunon me Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme dhe Shërbimin Informativ të Shtetit për çështje të fushës së komunikimeve elektronike, që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare.

9. Harton Planin Kombëtar të Frekuencave dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikat ndërkombëtare të zhvillimit të spektrit të frekuencave.

10. Bazuar në propozimet e AKEP-it, miraton kufizimet e mundshme për dhënien e frekuencave, procedurat përkatëse të konkurrimit publik, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave dhe vlerën minimale për dhënien e tyre.

11. Miraton ofruesin e shërbimit universal, edhe procedurat përkatëse për zgjedhjen e ofruesit/ofruesve të shërbimit universal, bazuar në propozimet e AKEP-it.

12. Shfuqizuar.

13. Shfuqizuar.

Neni 6

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

2. AKEP-i është një person juridik, publik, jobuxhetor, i pavarur, i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. AKEP-i në punën dhe në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij është i pavarur. AKEP-i e ka selinë në Tiranë.

Neni 7

Objektivat rregullatorë

(ndryshuar pika 1 dhe shkronja "a" e pikës 3 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i ushtron funksionet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera normative, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike e me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqipërisë është palë. AKEP-i merr parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Europian dhe BEREC-it.

2. Rregullimi në fushën e komunikimeve elektronike duhet të respektojë parimin e paanshmërisë teknologjike. Teknologjitë dhe shërbimet e reja, si edhe tregjet e sapokrijuara do të jenë subjekt i rregullimit, sipas këtij ligji, deri në masën e nevojshme për të parandaluar deformimet e konkurrencës dhe për të arritur objektivat e këtij ligji.

3. AKEP-i nxit konkurrencën efikente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera:

a) për t'u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të kenë përfitime maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë.

- b) për të mbrojtur interesat e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë e përdoruesve;
- c) për të mbrojtur interesat e sigurisë publike;
- ç) për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike;
- d) për të siguruar integritetin dhe sigurinë e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike;
- dh) për të nxitur investimet efikente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre;
- e) për të nxitur përdorimin e frytshëm të frekuencave dhe serive numerike si burime të fundme;
- ë) për të siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Neni 8

Kompetencat e AKEP-it

(ndryshuar fjalë në shkronjën “c”, shtuar fjalë në shkronjën “n”, shfuqizuar shkronja “r” dhe shtuar shkronjat “t”, “th”, “u” dhe “v” me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë, të përcaktuara nga ky ligj, AKEP-i ka kompetencë:

- a) mbikëqyr, kontrollon dhe monitoron veprimtaritë e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji;
- b) rregullon aksesin dhe interkoneksionin midis rrjeteve të komunikimeve elektronike, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe siguron që sipërmarrësit të mos diskriminohen dhe të kenë mundësi të barabarta, kushte transparente, objektive dhe të ndershme;
- c) miraton ofertën e referencës për aksesin dhe/ose interkoneksionin, si dhe ofertën e referencës për akses të hapur në rrjetin lokal të sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij ligji, me aktet nënligjore, si dhe tarifa të orientuara në kosto;
- ç) përcakton sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg;
- d) kryen regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit;
- dh) ndërmerr dhe përcakton masat mbrojtëse ndaj sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mos lejuar praktika antikonkurrese;
- e) bashkëpunon me ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave;
- ë) përgatit Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe administron brezat e frekuencave të caktuara për qëllime civile, për përdorim publik ose privat, me përjashtim të brezit të frekuencave, të caktuara për transmetime radio e televizione, të cilat administrohen nga KKRT-ja;
- f) monitoron përdorimin e spektrit të frekuencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave;
- g) lëshon autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave;
- gj) kryen procedurat e përcaktuara, sipas këtij ligji, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës;
- h) bashkërendon punën me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radiofrekuncave, për pjesën e spektrit që administron;
- i) harton, miraton dhe administron Planin Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
- j) cakton numrat dhe seritë numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- k) administron domain cc.TLD.al, nëndomanet e tij, si edhe ENUM;
- l) merr masat administrative, në përputhje me këtë ligj, në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tij;
- ll) mbikëqyr respektimin e kërkesave të ligjit për tarifën e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun dhe merr masat e nevojshme rregullatore në zbatim të këtij ligji;
- m) menaxhon dhe administron fondin e shërbimit universal;
- n) zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe

shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve, sipas parashikimeve të këtij ligji;

nj) krijon, mirëmban dhe përditëson bazën e të dhënave elektronike për sektorin e komunikimeve elektronike dhe siguron që këto të dhëna, në formë informacioni, t'i bëhen të vlefshme publikut, në përputhje me rregullat për informimin publik dhe të ruajtjes së konfidencialitetit;

o) mbledh të dhëna dhe informacion nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;

p) nxjerr rregulloret në zbatim të këtij ligji, të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar;

q) kryen njohjen e konformitetit për pajisjet "radio" dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve;

r) Shfuqizuar;

rr) merr masat, që sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendje të jashtëzakonshme;

s) bashkëpunon me organizatat, kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën e komunikimeve elektronike;

sh) kryen procedurat për përcaktimin e sipërmarrësit të shërbimit universal, sipas kërkesave të përcaktuara në kreun V të këtij ligji.

t) përcakton rregullat për funksionimin e shërbimit të radiondërlidhjes bregdetare;

th) përcakton rregullat dhe kërkesat teknike për funksionimin e shërbimeve radioamatore në Republikën e Shqipërisë;

u) siguron disponueshmërinë e një baze qendrore të dhënash për portabilitetin e numrit;

v) përcakton masa për rregullimin e tarifave, si dhe çmimet maksimale që mund të aplikohen në një seri të caktuar të numrave të përdorur për shërbimet me vlerë të shtuar, premium, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve.

Neni 9

Raportimi i AKEP-it

(ndryshuar fjalë dhe shtuar një fjali në pikën 2 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012))

1. AKEP-i është përgjegjës për punën e tij përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

2. Në përfundim të çdo viti, AKEP-i paraqet në Kuvend, brenda katër muajve të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit pararendës. Një kopje e raportit i dërgohet ministrit.

3. Raporti vjetor, i përmendur në pikën 2 të këtij neni, duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë:

a) raportin e punës së AKEP-it për vitin e mëparshëm;

b) programin vjetor të punës për vitin në vazhdim;

c) raportin për statusin e shërbimit universal;

ç) raportimin për realizimin e treguesve financiarë vjetorë të AKEP-it.

4. Raporti vjetor i AKEP-it duhet të jetë i disponueshëm për publikun.

Neni 10

Sigurimi i informacionit në ministri

Gjatë vitit, AKEP-i i siguron ministrit çdo informacion që e gjykon të nevojshëm për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit dhe për përmbushjen e kompetencave të përcaktuara në këtë ligj dhe në ligjin për shërbimin postar.

Neni 11

Kompetencat e KKRT-së

Organizimi, detyrat dhe kompetencat e KKRT-së përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 12

Bashkëpunimi

1. AKEP-i bashkëpunon me organet dhe strukturat shtetërore, organizatat e mbrojtjes së interesave të përdoruesve për çështje që lidhen me zbatimin e këtij ligji.

2. AKEP-i dhe Autoriteti i Konkurrencës bashkëpunojnë për çështje me interes të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për konkurrencën e sektorit të komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar.

KREU III REGJIMI I AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 13

Autorizimi

(ndryshuar pika 4 dhe shtuar pika 5 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Cilido sipërmarrës është i lirë të ofrojë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

2. Ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet kundrejt autorizimit nga AKEP-i, me përjashtim të rasteve kur rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike:

- a) nuk kanë qëllime fitimi (tregtimi) dhe kur nuk janë të disponueshme për publikun;
- b) përdoren vetëm për nevoja të përdorimit privat ose për nevoja të brendshme të institucioneve.

3. Autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet:

a) përmes njoftimit, kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nuk kërkon përdorimin e burimeve natyrore të kufizuara;

b) pas njoftimit dhe dhënies së të drejtës së përdorimit, në rastin kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike kërkon përdorimin e burimeve natyrore të fundme.

4. Sipërmarrësi i autorizuar, sipas këtij neni, ka të drejtë:

- a) të ofrojë rrjete apo shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
- b) të aplikojë për marrjen e së drejtës së instalimit të faciliteteve të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Kur një sipërmarrës i autorizuar, sipas këtij neni, ofron rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike për publikun, atëherë autorizimi i përgjithshëm i jep të drejtë:

a) të negociojë për interkoneksion dhe, kur është e zbatueshme, për të marrë akses nga sipërmarrësit e tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve të disponueshme për publikun, në përputhje me këtë ligj;

b) të marrë pjesë në përcaktimin si ofrues i shërbimit universal për shërbime të veçanta në skemën e shërbimit universal ose në pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 14

Njoftimi

(ndryshuar pikat 2, 5, 7 dhe 9 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Cilido sipërmarrës që, për qëllime fitimi, parashikon të ofrojë një rrjet ose shërbim të komunikimeve elektronike, duhet të njoftojë AKEP-in përpara fillimit të funksionimit, ndryshimit ose ndërprerjes.

2. Njoftimi i sipërmarrësit bëhet me shkrim, sipas rregullave të miratuara nga AKEP-i, dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e ofruesit;
- b) të dhënat e regjistrimit ligjor të sipërmarrësit;
- c) personat e kontaktit të sipërmarrësit;
- ç) përshkrimin e shkurtër të rrjetit ose shërbimit;
- d) datën kur është parashikuar fillimi i ofrimit, i ndryshimit ose veprimtarisë.

3. Njoftimi shoqërohet me deklaratën se:

- a) informacioni është i saktë;
- b) sipërmarrësi do t'i zbatojë detyrimet ligjore.

4. Sipërmarrësit (operatorët dhe ofruesit e shërbimit) janë të detyruar të raportojnë në AKEP të gjitha ndryshimet në informacionin e paraqitur gjatë njoftimit, brenda 30 ditëve nga ndodhja e tyre.

5. AKEP-i regjistron sipërmarrësit brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, në bazën

elektronike të të dhënave, si dhe duhet t'u konfirmojë atyre me shkrim kryerjen e regjistrimit.

6. Brenda 7 ditëve nga data e marrjes së një njoftimi jo të plotë në dokumentacion, sipas kërkesave në pikat 2 e 3 të këtij neni, AKEP-i informon sipërmarrësin për nevojën e plotësimit të informacionit të munguar. Nëse sipërmarrësi nuk e plotëson informacionin e munguar brenda 15 ditëve, AKEP-i informon sipërmarrësin se nuk do ta regjistrojë atë. Sipërmarrësi ka të drejtë të ankohet në Këshillin Drejtues të AKEP-it për këtë çështje.

7. Nëse AKEP-i nuk konfirmon me shkrim brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose nuk informon sipërmarrësin për plotësimin e informacionin të munguar, sipas pikës 6 të këtij neni, njoftimi vlerësohet i plotë dhe regjistrimi përkatës quhet i kryer.

8. AKEP-i, me anë të një dokumenti rregullator, përcakton, në zbatim të këtij ligji, në mënyrë të hollësishme formën dhe përmbajtjen e kërkesës për njoftim të dokumentacionit mbështetës dhe konfirmimit të regjistrimit. Ky dokument publikohet dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga publiku.

9. AKEP-i administron një regjistër të përditësuar, bazë të dhënash (*database*) për personat fizikë dhe juridikë, të cilët kanë njoftuar, sipas përcaktimeve të këtij neni. Baza e të dhënave përmban, detyrimisht, informacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni. Baza e të dhënave është publikisht e aksesueshme.

Neni 15

Kushtet e përgjithshme

(ndryshuar numërtimi, shtuar fjalë në shkronjën “dh”, ndryshuar shkronja “e”, shtuar shkronjat “ll” dhe “m” në pikën 1 dhe shtuar pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Në autorizimin e përgjithshëm, AKEP-i vendos kushte për:
 - a) kontributin financiar për financimin e shërbimit universal;
 - b) bashkëveprimin e shërbimeve dhe interkoneksionin e rrjeteve;
 - c) sigurimin e disponueshmërisë dhe përdorimin e numrave nga plani i numeracionit për përdoruesit fundorë, duke përfshirë kushtet për këtë përdorim;
 - ç) mbrojtjen e mjedisit, planifikimin territorial, aksesin në pronat e patundshme, përfshirë përdorimin e tyre, bashkëvendosjen ose përdorimin e përbashkët të pajisjeve, përfshirë, nëse është e zbatueshme, çfarëdo garancie financiare ose teknike, që mund të jetë e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë;
 - d) mbrojtjen e të dhënave vetjake dhe të privatësisë;
 - dh) mbrojtjen e konsumatorit duke përfshirë sigurimin e aksesit për përdoruesit me aftësi të kufizuara;
 - e) respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, sipas rregullimeve përkatëse ligjore në fuqi;
 - ë) informacionin, i cili duhet të paraqitet në procedurën e njoftimit, sipas nenit 14 të këtij ligji, në procedurën për dhënien e së drejtës së përdorimit të burimeve të fundme (frekuenca dhe numeracion), si edhe informacionin, që duhet të paraqitet në AKEP dhe në organet e tjera, sipas nenit 16 të këtij ligji;
 - f) lejin e përgjimit nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për përgjimin e telekomunikimeve dhe zbatimin e detyrimeve, që burojnë nga ky legjislacion;
 - g) kushtet për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në rastet e gjendjes së emergjencës apo të gjendjes së luftës;
 - gj) mbrojtjen e shtetasve ndaj veprimeve të dëmshme të rrezatimit elektromagnetik, të përhapur nga rrjetet e komunikimeve elektronike;
 - h) detyrimin për të ofruar akses;
 - i) mirëmbajtjen e integritetit të rrjeteve të komunikimeve publike dhe parandalimin e ndërhyrjeve elektromagnetike ndërmjet rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;
 - j) mbrojtjen e rrjeteve të komunikimeve publike ndaj aksesit të paautorizuar;
 - k) përdorimin e frekuencave, duke siguruar përdorimin eficient të spektrit të frekuencave dhe parandalimin e interferencave të dëmshme;
 - l) detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të shërbimeve e faciliteteve shoqëruese, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
 - ll) përdorimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit nga autoritetet publike, për të paralajmëruar publikun për kërcënimet e pashmangshme nga katastrofat e mëdha dhe për zbutjen e pasojave nga katastrofat e mëdha;

m) detyrimet e operatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike që ofrojnë komunikimin ndërmjet pikave fundore të rrjetit për transparencë dhe informim për kufizimet e aksesit ose të përdorimit të shërbimeve, aplikimeve në rastin e zbatimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kushtet e vendosura nga AKEP-i, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jenë jodiskriminuese, proporcionale, transparente, të justifikuara për rrjetin ose shërbimin në fjalë dhe nuk duhet të dublojnë kushte që aplikohen ndaj sipërmarrësve nga akte të tjera ligjore në fuqi. Autorizimi i përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve dhe/ose rrjeteve të komunikimeve elektronike është subjekt i kushteve, sipas rregullores së miratuar nga AKEP-i.

3. Në rastin e përdorimit të frekuencave, sipërmarrësit duhet të përmbushin kushtet e përdorimit të frekuencave, sipas përcaktimeve në kreun VII të këtij ligji. Në rastin e përdorimit të numrave sipërmarrësit duhet të përmbushin kushtet, sipas përcaktimeve në kreun IX të këtij ligji, si dhe parimet e përcaktuara nga AKEP-i për tarifat dhe çmimet maksimale që mund të aplikohen në një seri të caktuar numerike.

Neni 16

Detyrimi për të dhënë informacion

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar t'i japin AKEP-it, me kërkesë të tij, çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur detyrimet funksionale të AKEP-it, sipas këtij ligji.

2. Në veçanti, AKEP-i mund të kërkojë informacion, duke përfshirë informacione financiare, të cilat janë të nevojshme për:

a) verifikimin sistematik ose rast pas rasti të pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji;

b) për procedurat dhe vlerësimin e kërkesave për dhënie të drejtave të përdorimit;

c) publikimin e përmbledhjeve krahasuese të cilësisë dhe çmimeve të shërbimeve në interes të përdoruesit;

ç) qëllime statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që rrjedhin nga marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe organizatave ndërkombëtare;

d) informacion lidhur me zhvillimet e ardhshme të rrjeteve ose shërbimeve që mund të kenë ndikim në shërbimet me shumicë, të cilat sipërmarrësit ua ofrojnë konkurrentëve; dhe

dh) analizën e tregjeve, në përputhje me kreun VI të këtij ligji. Sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg për tregjet me shumicë, gjithashtu, mund t'u kërkohej të paraqesin të dhënat e kontabilitetit për tregjet me pakicë, të cilat shoqërohen me ato të tregjeve me shumicë.

3. Sipërmarrësit ofrojnë informacionin, sipas kërkesës e në përputhje me afatet kohore dhe nivelin e detajeve të kërkuara nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të parashikuara në rregulloren përkatëse. Në rast mosparaqitjeje të informacionit të kërkuar, AKEP-i zbaton përcaktimet e paragrafëve VI dhe VII të nenit 137 të këtij ligji.

4. Informacioni i kërkuar nga AKEP-i do të jetë proporcional me përmbushjen e detyrave funksionale, për të cilat është kërkuar, dhe AKEP-i do të japë arsyet për të cilat ky informacion është kërkuar.

5. Nëse informacioni është vlerësuar si konfidencial, AKEP-i e siguron atë në përputhje me legjislacionin në fuqi për sekretin tregtar të biznesit. Nëse informacioni nuk është konfidencial, AKEP-i e publikon ose e vë në dispozicion të publikut, sipas kërkesës së tij, kur kjo është e nevojshme për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues. Nëse konfidencialiteti i informacionit është i diskutueshëm, AKEP-i vendos për konfidencialitetin pasi të ketë dëgjuar sipërmarrësin, vlerësuar interesat e sipërmarrësit për të trajtuar informacionin si konfidencial, si dhe interesat e publikut për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues.

6. Sipërmarrësit, të cilët ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, janë të detyruar t'i paraqesin ministrit, me kërkesë të tij, të gjithë informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrat funksionale të ministrit, sipas këtij ligji. Ministri nxjerr udhëzim për të dhënat statistikore që raportohen pranë tij.

Neni 17

Detyrime të veçanta

1. AKEP-i ka të drejtë të marrë vendim që, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të vendosë detyrime të veçanta për sipërmarrësit, të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike.

Këto detyrime do të vendosen jashtë kushteve të cilësuar në autorizimin e përgjithshëm dhe në përputhje me procedurat e këshillimit, të përcaktuara në nenet 35 dhe 110 të këtij ligji.

2. Detyrimet e veçanta, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, janë:

a) detyrimet për ofrimin e shërbimit universal, në përputhje me kreun V të këtij ligji;
b) detyrimet e veçanta, të cilësuar në këtë ligj për sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg në tregjet përkatëse;

c) detyrimet për aksesin në rrjet, në përputhje me nenin 42 të këtij ligji.

3. AKEP-i publikon informacionet për vendosjen e detyrimeve të veçanta, sipas përcaktimit në nenin 118 të këtij ligji.

Neni 18

Ndryshimi ose revokimi i autorizimit të përgjithshëm

1. AKEP-i ndryshon ose revokon të drejtat, kushtet dhe procedurat për autorizimin e përgjithshëm dhe të drejtat e përdorimit, në raste objektivist të justifikuara dhe në mënyrë proporcionale, pas kryerjes së një këshillimi publik, sipas përcaktimit në nenin 110 të këtij ligji. Me raste objektivist të justifikuara nënkuptohen:

a) ndryshimi i fakteve, në bazë të të cilave janë përcaktuar të drejtat, kushtet dhe procedurat në autorizimin e përgjithshëm dhe të drejtat për përdorim;

b) përmbushja e angazhimeve, që burojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare;

c) nevoja e mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit;

ç) nevoja e mbrojtjes së interesit publik.

2. Ndryshimi ose revokimi i të drejtave, kushteve dhe procedurave për autorizimin e përgjithshëm dhe për të drejtat e përdorimit bëhet me vendim të AKEP-it.

Neni 19

Dhënia e së drejtës për përdorim

1. Sipërmarrësit që kanë nevojë për caktim të burimeve natyrore të fundme (frekuenca dhe numeracion), në njoftimin që paraqesin në AKEP, sipas nenit 14 të këtij ligji, kërkojnë dhënie të së drejtës së përdorimit të tyre.

2. Dhënia e së drejtës për përdorim të frekuencave bëhet në përputhje me parashikimet e kreut VII të këtij ligji.

3. Dhënia e së drejtës për përdorim të numeracionit bëhet në përputhje me parashikimet e kreut IX të këtij ligji.

KREU IV

RRJETET DHE SHËRBIMET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 20

Ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike

1. Sipërmarrësit, që ndërtojnë dhe/ose përdorin rrjete të komunikimeve elektronike dhe ofrojnë shërbime janë të detyruar të zbatojnë kushtet e këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe rregulloret e nxjerra në zbatim të këtij ligji, që të mos rrezikojnë rendin publik, jetën dhe shëndetin e qytetarëve, sigurinë publike dhe mbrojtjen e vendit.

2. Në rastet kur rrjetet e komunikimeve elektronike kërkojnë përdorimin e frekuencave, sipërmarrësit janë të detyruar të marrin një miratim paraprak për përdorimin e frekuencave, sipas parashikimeve të kreut VII të këtij ligji.

Neni 21

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve të komunikimeve elektronike

1. Rrjetet e komunikimeve elektronike dhe infrastruktura shoqëruese me to duhet të ndërtohen dhe shfrytëzohen në përputhje me këtë ligj dhe me aktet në zbatim të tij, me legjislacionin në fuqi për planifikimin territorial dhe ndërtimin, për mbrojtjen e mjedisit, si dhe me standardet e tjera teknike.

2. Mirëmbajtja e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe infrastruktura shoqëruese me to duhet të jenë në përputhje me rregullat e ndërtimit për:

- a) përfundimin dhe përmirësimin e faciliteteve ekzistuese dhe të pajisjeve të rrjeteve publike të komunikimit;
- b) rindërtimin e sistemeve të antenave ekzistuese;
- c) rinovimin dhe rindërtimin e faciliteteve ekzistuese të rrjeteve të komunikimeve elektronike;
- ç) zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese apo instalimin e sistemeve të reja të komunikimit dhe rrjetet e aksesit publik;
- d) zgjerimin e sistemeve ekzistuese të furnizimit me energji elektrike.

Neni 22

Përdorimi i përbashkët i faciliteteve dhe aseteve

1. Në rastet kur kërkohet përdorimi ekonomik i hapësirave, planifikimi urban dhe mbrojtja e mjedisit, sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve publike elektronike, që kanë të drejtë të ndërtojnë dhe të instalojnë pajisje komunikimi në mjedise private ose publike duhet t'i ndërtojnë ose instalojnë ato, për të mundësuar përdorimin e përbashkët të tyre.

2. Sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimeve janë të detyruar të lidhin marrëveshje për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve në kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. AKEP-i nxit sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimit të lidhin marrëveshje për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve.

4. Sipërmarrësi i një rrjeti publik të komunikimeve mund të refuzojë kërkesën për përdorim të përbashkët të faciliteteve dhe aseteve në rastet kur:

- a) përdorimi i përbashkët i faciliteteve dhe aseteve është teknikisht i pamundur dhe pengon integritetin e sigurinë e rrjetit;
- b) pala, që kërkon përdorim të përbashkët, nuk pranon të paguajë tarifat përkatëse.

5. Kur sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimit nuk arrijnë marrëveshje ndërmjet tyre, AKEP-i, me kërkesë të çdo pale, ndërmerr një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas parashikimeve të këtij ligji.

6. Në rastet kur përdorimi i përbashkët kërkon rindërtimin e faciliteteve dhe të aseteve të komunikimit, shpenzimet e rindërtimit mbulohen nga pala, që kërkon përdorimin e përbashkët.

7. Në rastet kur sipërmarrësit nuk arrijnë një marrëveshje për pagesën për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve, AKEP-i, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga cilado palë e interesuar, vendos për pagesën, në përputhje me rregullat e miratuara.

Neni 23

Përdorimi i rrjeteve për përdorim privat për shërbime të komunikimit publik

1. Personat juridikë, të cilët nuk kanë veprimtari kryesore ofrimin e shërbimeve dhe/ose të rrjeteve të komunikimeve elektronike, por kanë në pronësi rrjete apo shërbime të komunikimeve elektronike për përdorim privat, në rast se vendosin të ofrojnë shërbime apo rrjete të komunikimeve elektronike për publikun, janë të detyruar të njoftojnë AKEP-in sipas detyrimeve të përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji.

2. Kur personat juridikë vendosin, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, të ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike publike, janë të detyruar të krijojnë një person tjetër juridik, ose të mbajnë llogari financiare të ndara, për të ardhurat, që rrjedhin nga ofrimi i shërbimeve dhe/ose rrjeteve publike.

Neni 24

Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike

1. Sipërmarrësit, që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit, janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga AKEP-i. Kjo pagesë bëhet për të mbuluar kostot administrative të AKEP-it.

2. Pagesa vjetore, e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nuk duhet të jetë më shumë se 0,5 për qind e së ardhurës vjetore të vitit kalendarik të mëparshëm.

3. Sipërmarrësi duhet të bëjë pagesën vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike pranë AKEP-it brenda datës 30 prill të çdo viti, menjëherë pas dorëzimit të bilancit vjetor dhe

të raportit të ekspertit kontabël, i cili depozitohet nga sipërmarrësi pranë AKEP-it.

4. Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, brenda kufirit prej 0,5 për qind të së ardhurës vjetore, përcaktohet në rregulloren e AKEP-it, të nxjerrë në përputhje me këtë ligj.

5. Përcaktimi i nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut nuk duhet të deformatë konkurrencën apo të krijojë pengesa për hyrjen në treg të sipërmarrësve të rinj.

6. Para miratimit të rregullores, sipas përcaktimeve në pikën 4 të këtij neni, AKEP-i duhet të njoftojë me shkrim sipërmarrësit, për të paraqitur mendimet dhe propozimet e tyre, me shkrim, për pagesën vjetore, mënyrën e përlllogaritjes dhe të zbatimit të saj. Afati i dërgimit të propozimeve nga sipërmarrësit është 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit. Mosdërgimi i mendimeve dhe propozimeve brenda këtij afati, nuk përbën pengesë për AKEP-in që të veprojë sipas pikës 4 të këtij neni.

7. Pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike duhet të bëhet në llogaritë e AKEP-it.

KREU V SIGURIMI I SHËRBIMIT UNIVERSAL

Neni 25

Disponueshmëria e shërbimit universal (ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Shërbimet e përfshira në shërbimin universal, sipas këtij ligji, duhet të jenë të disponueshme për përdoruesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendndodhjes gjeografike, me cilësinë dhe kushtet e përcaktuara në aktin rregullator të nxjerrë nga AKEP-i, dhe me çmim të përballueshëm, në përputhje me kushtet specifike kombëtare.

2. AKEP-i, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për shërbimin universal, merr masat e duhura rregulluese, bazuar në parimet e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, për garantimin e ofrimit të shërbimit universal, të përmendur më sipër, me sa më pak dëmtime të mundshme të tregut, në veçanti nga ofrimi i shërbimeve me çmime, terma dhe kushte të tjera nga ato të ofruara nga tregu për qëllim të interesit publik.

Neni 25/1

Sigurimi i aksesit nga një vendndodhje fikse dhe ofrimi i shërbimit telefonik (shtuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Çdo kërkesë e arsyeshme për lidhje me rrjetin e komunikimeve publike në një vendndodhje fikse duhet të mundësohet nga, të paktën, një sipërmarrës. AKEP-i merr masat e duhura rregullatore për përmbushjen e këtij detyrimi nga ofruesi/t e caktuar për ofrimin e shërbimit universal.

2. Lidhja e ofruar me rrjetin e komunikimeve publike duhet t'i krijojë përdoruesit mundësi:

- a) të bëjë dhe të marrë thirrje lokale, kombëtare e ndërkombëtare;
- b) komunikimin me faks;
- c) komunikimin e të dhënave me një shpejtësi të kënaqshme për të lejuar aksesin funksional të internetit, duke marrë parasysh teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe mundësitë e realizimit teknologjik.

Neni 25/2

Sigurimi i numërorit telefonik dhe rubrika e informimit për numrat (shtuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Ofrimi i shërbimit universal duhet të garantojë që:

a) të paktën, një numëror telefonik i përgjithshëm të jetë i disponueshëm për përdoruesit fundorë, sipas formatit të miratuar nga AKEP-i, në formë të printuar ose elektronike, si dhe të përditësohet rregullisht, të paktën, një herë në vit;

b) të paktën, një shërbim i informacionit për numrat telefonikë të përgjithshëm të jetë i disponueshëm për të gjithë përdoruesit fundorë, përfshirë përdoruesit e telefonave me pagesë.

AKEP-i merr masat e duhura rregullatore për përmbushjen e këtij detyrimi.

2. Numërori Telefonik i Përgjithshëm dhe shërbimi i informacionit për numrat duhet të

repektojnë kërkesat e këtij ligji për mbrojtjen e privatësisë në komunikimet elektronike dhe të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Sipërmarrësi/t, që ofrojnë shërbimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, zbatojnë parimin e mosdiskriminimit në trajtimin e informacionit të dhënë nga sipërmarrësit e tjerë.

Neni 25/3

Telefonat publikë me pagesë dhe pikat e tjera të aksesit publik telefonik

(shtuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i mund të imponojë detyrime ndaj sipërmarrësve, me qëllim që telefonat publikë me pagesë ose pika të tjera të aksesit publik telefonik të ofrohen duke plotësuar nevojat e arsyeshme të përdoruesve fundorë në termat e mbulimit gjeografik, numrit të telefonave ose pikave të aksesit, aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar dhe cilësisë së shërbimit.

2. AKEP-i, mbi bazën e një konsultimi me palët e interesuara, mund të vendosë të mos imponojë detyrime, sipas pikës 1 të këtij neni, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në pjesë të tij, nëse këto shërbime ose të tjera të krahasueshme janë gjerësisht të disponueshme.

3. Telefonat publikë me pagesë duhet të mundësojnë thirrjen drejt numrit 112 dhe numrave të tjerë të emergjencës pa pagesë dhe pa qenë nevoja e përdorimit të mjetit të pagesës, të parashikuar për to.

Neni 25/4

Masat për përdoruesit me aftësi të kufizuar

(shtuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i vendos kushte për sigurimin e kushteve për akses të barasvlershëm dhe përdorimin e shërbimeve telefonike të disponueshme për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, duke përfshirë akses në shërbimet e thirrjeve të emergjencës dhe për informimin në numërorin telefonik për të gjithë përdoruesit në Republikën e Shqipërisë.

2. AKEP-i, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për përfshirjen sociale, bën vlerësimin për nevojat e përgjithshme dhe kërkesat specifike, duke përfshirë masën dhe formën konkrete të këtyre masave specifike për personat me aftësi të kufizuar.

Neni 26

Sigurimi i shërbimit universal

(ndryshuar pikat 1, 3, 5, shfuqizuar pikat 2, 4, dhe shtuar pika 8 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i mund të përcaktojë një ose më shumë sipërmarrës për të garantuar ofrimin e shërbimit universal, sipas përcaktimeve të nenit 25 të këtij ligji, përfshirë, për aq sa është e zbatueshme, kërkesat e pikës 3 të nenit 27 të këtij ligji, në mënyrë që i gjithë territori i vendit të jetë i mbuluar. AKEP-i mund të përcaktojë sipërmarrës të ndryshëm ose një bashkim sipërmarrësish për ofrimin e elementeve të ndryshme të shërbimit universal dhe/ose për mbulimin e pjesëve të ndryshme të territorit të vendit.

2. Shfuqizuar.

3. Rregullat për përcaktimin e ofruesit/esve të shërbimit universal miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Në procesin e përcaktimit të një ose më shumë ofruesve të shërbimit universal, AKEP-i respekton parimet e efektivitetit, të objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit. Asnjë sipërmarrës nuk është i përjashtuar paraprakisht nga e drejta për të qenë ofrues i shërbimit universal.

4. Shfuqizuar.

5. AKEP-i kryen procedurën e përcaktimit të ofruesit/esve të shërbimit universal, sipas rregullave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë në konsideratë:

a) rrethanat dhe zhvillimin e tregut të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, lidhur me nevojën e zbatimit të shërbimit universal;

b) aftësitë teknike, financiare dhe besueshmërinë e sipërmarrësit/ve për sigurimin e shërbimit universal në një zonë të caktuar ose gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda periudhës kohore të përcaktuar;

c) kostot përkatëse neto për ofrimin e shërbimit universal, si dhe, për sa është e zbatueshme, vlerën

korresponduese të kompensimit, që mund të kërkohej nga operatori për ofrimin e shërbimit universal.

6. Në përfundim të procedurës së përcaktimit dhe pas miratimit paraprak të ministrit, AKEP-i nënshkruan marrëveshjen përkatëse me ofruesin e shërbimit universal.

7. AKEP-i, në mënyrë të vazhdueshme, mbikëqyr veprimtarinë e ofruesit të shërbimit universal. Ofruesi i shërbimit universal, nga ana e tij, është i detyruar të paraqesë në AKEP, të paktën një herë në vit, të dhëna rreth veprimtarisë së tij.

8. Kur një ofrues i shërbimit universal ka për qëllim të zhvendosë një pjesë të konsiderueshme ose të gjitha asetet e rrjetit të tij të aksesit lokal në një person juridik në pronësi tjetër, duhet të informojë paraprakisht AKEP-in, në mënyrë që t'i mundësojë AKEP-it të vlerësojë efektet e transaksionit të synuar në ofrimin e aksesit në vendndodhje fikse dhe të shërbimeve telefonike, sipas nenit 25/1 të këtij ligji. AKEP-i mund të vendosë, të ndryshojë ose të heqë detyrimet e veçanta, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Neni 27

Tarifat dhe kushtet e përgjithshme për shërbimin universal (ndryshuar pikat 1, 3 dhe 6 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i monitoron ndryshimet dhe nivelin e tarifave të shërbimeve, të përcaktuara në nenet 25/1 deri në 25/4 dhe pikës 3 të këtij neni, të ofruara nga ofruesi/t e shërbimit universal ose nga tregu, nëse nuk kemi ofrues të shërbimit universal të caktuar.

2. Tarifat e shërbimeve individuale, të ofruara nga shërbimi universal, duhet të jenë të njëjta në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Ofruesit e shërbimit universal mund të ofrojnë tarifa opsionale, paketa tarifore të veçanta dhe mënyra pagese të veçanta për pajtimtarët me të ardhura të pakta dhe/ose për pajtimtarët me nevoja të veçanta, në mënyrë që këta pajtimtarë të mos jenë përjashtuar nga aksesit në rrjet dhe përdorimi i shërbimeve të përcaktuara në këtë kre.

4. Ofruesit e shërbimit universal janë të detyruar të përcaktojnë tarifat dhe kushtet e përgjithshme të pagesës, në mënyrë që pajtimtarët e shërbimeve të veçanta që ofrohen nga shërbimi universal, të mos jenë të detyruar të paguajnë për shërbimet e panevojshme ose që nuk kërkohej për sigurimin e shërbimeve të përfshira në skemën e shërbimit universal.

5. Tarifat e shërbimit universal janë objekt rregullimi, sipas parashikimeve të këtij ligji.

6. AKEP-i detyron ofruesit e shërbimit universal t'u ofrojnë pajtimtarëve të tyre mundësinë për të përdorur shërbimet e mëposhtme:

a) bllokimin me zgjedhje dhe pa pagesë të thirrjeve dalëse a mesazheve të shkurtra SMS me vlerë të shtuar ose MMS-ve apo, kur është teknikisht e mundur, të shërbimeve të tjera të ngjashme;

b) sistemet e parapagimit, për të pasur akses në rrjetet e komunikimit elektronik publik dhe përdorimit të shërbimeve telefonike të vlefshme për publikun;

c) pagesa të shtrira në kohë për tarifën e lidhjes në rrjetin e komunikimit elektronik publik;

ç) këshilla për tarifën, ku pajtimtarët mund të kërkojnë që sipërmarrësi t'i informojë për tarifa të tjera alternative me kosto më të ulët, nëse janë të disponueshme;

d) mundësinë e kontrollit të shpenzimeve të komunikimeve, duke përfshirë njoftimin paralajmërues pa pagesë të pajtimtarit, në rastin kur këto shpenzime janë shumë më të larta se shpenzimet normale të tij;

dh) mundësinë e verifikimit dhe të kontrollit të shpenzimeve të kryera nga përdorimi i rrjetit publik të komunikimeve nga një vendndodhje fikse dhe/ose shërbimet telefonike të disponueshme për publikun.

Neni 28

Cilësia e shërbimit universal

1. AKEP-i përcakton kërkesat teknike për cilësinë e shërbimit universal, madje dhe ato minimale, parametrat teknikë dhe mënyrën e matjes së tyre.

2. Ofruesit e shërbimit universal janë të detyruar të paktën një herë në vit të publikojnë informacion për cilësinë e shërbimit universal.

3. AKEP-i monitoron cilësinë e shërbimit universal dhe merr masat e nevojshme për sigurimin e cilësisë së shërbimit universal të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Nëse AKEP-i ka dyshime të justifikuara për besueshmërinë e informacionit të siguruar, sipas pikës 2 të këtij neni, në zbatim të detyrave të ngarkuara nga ky ligj, kryen kontroll, nëpërmjet ekspertizës së

pavarur. Shpenzimet e ekspertizës së pavarur mbulohen nga ofruesit e shërbimit universal, në verifikim.

5. Nëse vlerat e matura të treguesve teknikë të cilësisë për një ofrues të caktuar të shërbimit universal nuk përmbushin treguesit e kërkuar të paktën në tri periudha të njëpasnjëshme, AKEP-it i lind e drejta të fillojë procesin e anulimit të këtij sipërmarrësi, si ofrues i shërbimit universal, dhe përcaktimin e një ofruesi të ri të shërbimit universal.

Neni 29

Skema e kompensimit për sigurimin e shërbimit universal (ndryshuar pika 1me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Ofruesit e shërbimit universal kanë të drejtë të kërkojnë kompensim, nëse ofrimi i shërbimit, sipas neneve 25/1 deri në 25/4 dhe nenit 27 pika 3 të këtij ligji, përbëjnë një ngarkesë të padrejtë dhe krijojnë kosto shtesë. Nëse AKEP-i arrin në përfundimin se ofrimi i këtyre shërbimeve mund të përbëjë një ngarkesë të padrejtë për sipërmarrësin/it e përcaktuar për ofrimin e shërbimit universal, AKEP-i llogarit koston neto për ofrimin e këtij shërbimi.

2. Kompensimi, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk mund të kalojë në asnjë rrethanë kostot reale për ofrimin e shërbimit universal.

3. Kostot reale, sipas pikës 2 të këtij neni, llogariten si diferencë ndërmjet kostove reale për sigurimin e shërbimit universal dhe kostove, që ofruesi i shërbimit universal do të kishte pasur, nëse nuk do të ishte ofrues i shërbimit universal ku, në çdo rast, do të merren parasysh çdo përfitim i ofruesit të shërbimit universal, përfshirë edhe të mirat e patrupëzuara.

4. AKEP-i përcakton mënyrën e llogaritjes së kostos reale dhe të përfitimeve të patrupëzuara, që duhen pasur parasysh në llogaritjen e kostove të sigurimit të shërbimit universal, pa anashkaluar rekomandimet e BE-së për këtë shërbim.

5. Ofruesit e shërbimit universal janë të detyruar t'i mbajnë të ndara llogaritë për kostot e sigurimit të shërbimit universal.

6. Ofruesit e shërbimit universal janë të detyruar të dërgojnë në AKEP, brenda datës 30 prill të çdo viti, informacion për kostot reale, bilancin vjetor dhe të dhënat e përdorura në llogaritjen e kostove reale për sigurimin e shërbimit universal. Në të kundërt, ata do të humbin të drejtën e deklarimit të kostove reale.

7. AKEP-i cakton ekspertizë kontabël të pavarur për kryerjen e kontrollit dhe verifikimin e informacionit të paraqitur sipas pikës 6 të këtij neni.

8. AKEP-i konfirmon llogaritjen e kostove reale për sigurimin e shërbimit universal. Nëse ofruesi i shërbimit universal është zgjedhur përmes një procedure tenderi publik, AKEP-i në vlerësim merr parasysh edhe kostot e sigurimit të shërbimit universal, të paraqitura nga ofruesi. Gjithashtu AKEP-i vlerëson diferencat në kosto vetëm në rastet kur kushtet kanë ndryshuar nga koha e zhvillimit të tenderit dhe nëse ofruesi i shërbimit universal provon, në mënyre bindëse, objektive dhe transparente, këto diferenca. AKEP-i publikon rezultatet e llogaritjes së kostove dhe të ekspertizës së kryer për informacionin e paraqitur nga ofruesi i shërbimit universal.

9. AKEP-i përcakton shkallën e kompensimit. Në bazë të llogaritjeve ajo mund të vendosë që ofruesi i shërbimit universal të mos gëzojë të drejtën e kompensimit, ose të vendosë për një kompensim më të vogël nga ai i kërkuar nga ofruesi.

10. Ofruesi i shërbimit universal mund të bëjë ankim për vendimin e marrë sipas pikës 9 të këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 30

Financimi i shërbimit universal

1. Për kompensimin e kostove të shërbimit universal krijohet fondi i këtij shërbimi. Fondi i shërbimit universal menaxhohet dhe administrohet nga AKEP-i. Ky fond është i paprekshëm për qëllime të tjera dhe, nëse nuk shpenzohet, akumulohet dhe mbartet në vitin pasardhës.

2. Fondi i shërbimit universal krijohet nga sipërmarrësit, që zotërojnë rrjete të komunikimeve elektronike publike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike publike dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me rregulloren e AKEP-it.

3. AKEP-i përcakton, me vendim, kuotën e financimit, sipas pikës 2 të këtij neni, e cila, për të gjithë sipërmarrësit, subjekt i pagesës, nuk do të jetë më e lartë se 1 për qind e totalit të të ardhurave, të siguruara nga rrjetet e komunikimeve elektronike publike dhe ofrimi i shërbimeve të komunikimeve

elektronike publike.

4. Sipërmarrësit janë të detyruar të paguajnë kontributet, sipas pikës 2 të këtij neni, në një llogari të veçantë të AKEP-it, brenda një periudhe të caktuar kohe, por jo më vonë se data 30 maj e vitit pasardhës.

5. Sipërmarrësit, brenda datës 30 prill të çdo vit informojnë AKEP-in për të ardhurat e një viti më parë, të siguruara nga ofrimi i rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike në Republikën e Shqipërisë, duke depozituar në AKEP bilancin vjetor shoqëruar me raportin e ekspertit kontabël.

6. AKEP-i rimbursos nga llogaria e kontributeve vjetore të shërbimit universal secilin ofrues, të përcaktuar për ofrimin e shërbimit universal, në një madhësi të barabartë me kostot reale, të miratuara për sigurimin e shërbimit universal.

7. Shuma për kompensimin e shërbimit universal auditohet në bazë vjetore nga grup ekspertësh kontabël, të autorizuar nga AKEP-i.

8. AKEP-i paraqet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë një raport vjetor, i cili përmban:

a) pasqyrat financiare dhe raportin vjetor të auditimit, për llogaritë e kompensimit të shërbimit universal;

b) një informacion për rregullat e konfidencialitetit të informacionit të pronësisë së biznesit, për llogaritjen e kostove reale të sigurimit të shërbimit universal, për përfitimet në të mira të patrupëzuara, të vlerësuara në llogaritjen e kostove reale dhe kompensimin e këtyre kostove.

KREU VI RREGULLIMI I KONKURRENCËS

Neni 31 Të përgjithshme

1. Tregjet, që justifikojnë rregullimin dhe janë subjekt i rregullimit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, janë tregjet me pengesa, me natyrë juridike ose strukturore të larta dhe të qëndrueshme, për hyrjen në treg, tregjet të cilat nuk janë të orientuar drejt konkurrencës efektive brenda një periudhe kohore të përshtatshme, tregjet ku zbatimi vetëm i ligjit për konkurrencën nuk mund të zgjidhë në mënyrën e duhur dështimet e tregut.

2. Përcaktimi i tregjeve, analiza e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregjet përkatëse bëhet në përputhje me këtë ligj dhe aktet në zbatim të tij.

3. Sipërmarrësit, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, janë subjekt i masave të vendosura nga AKEP-i, në përputhje me këtë ligj dhe aktet në zbatim të tij.

4. Përcaktimi i tregjeve, analiza e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP-i në mënyrë periodike, por jo më pak se një herë në dy vjet, në bazë të një rregulloreje, të hartuar në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me rekomandimet përkatëse të BE-së.

Neni 32 Përcaktimi i tregut

AKEP-i përcakton tregjet përkatëse kombëtare të komunikimeve elektronike dhe produktet përkatëse, të cilat justifikojnë rregullimin dhe janë subjekte të rregullimit të veçantë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, me parimet e ligjit për konkurrencën dhe kushtet aktuale të tregut shqiptar, duke pasur parasysh kërkesat e rregullimit të veçantë në sektor dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve.

Neni 33 Sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg

1. Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

2. Për të bërë vlerësimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, AKEP-i bazohet, ndërmjet të tjerave, në kriteret e mëposhtme:

a) në madhësinë e sipërmarrësit, madhësinë e sipërmarrësit në raport me tregun përkatës, si edhe me ndryshimet në kohë, në pozicionin relativ të tij, ndaj lojtarëve të tregut;

b) në pengesat e larta për hyrje dhe zgjerimin e pritshëm, si rrjedhojë e konkurrencës së mundshme;

c) në fuqinë kundërvepruese të blerësve;

ç) në zhvillimin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës;

d) në fazën e tregut përkatës;

dh) në përparësitë teknologjike;

e) në përparësitë e rrjetit të shitjes dhe të shpërndarjes;

ë) në ekonomitë e shkallës, ekonomitë e sektorit dhe të dendësisë;

f) në shkallën e integritit vertikal;

g) në zhvillimin e produkteve të diferencuara;

gj) në aksesin në burimet financiare;

h) në kontrollin mbi infrastrukturën, që nuk mund të zëvendësohet lehtësisht;

i) në sjelljen e përgjithshme në treg, si tarifatat, paketat e shërbimeve dhe të produkteve ose vendosjen e pengesave.

3. Dy ose më shumë sipërmarrës vlerësohen se kanë një pozitë zotëruese nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore apo të lidhjeve të tjera, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cila të çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit.

4. Për të bërë përcaktimin e dominancës së bashkuar të dy ose më shumë sipërmarrësve, AKEP-i bazohet, ndërmjet të tjerash, në kriteret e mëposhtme:

a) në zhvillimin e përqendrimit të tregut, shpërndarjen e pjesëve të tregut dhe ndryshimin në kohë të tyre;

b) në pengesat për hyrjen në treg dhe efektin e tyre në konkurrencën e mundshme;

c) në zhvillimin e kundërveprimit të fuqisë blerëse;

ç) në transparencën aktuale të tregut;

d) në fazën e tregut përkatës;

dh) në produktet homogjene;

e) në strukturën e kostos;

ë) në zhvillimin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës;

f) në zhvillimin e përmirësimeve teknologjike dhe shkallën e maturisë së teknologjisë;

g) në mungesën e kapaciteteve të tepërta;

gj) në lidhjet informale dhe lidhjet e tjera ndërmjet lojtarëve të tregut;

h) në mekanizmat ndëshkues;

i) në zhvillimin e shtysave për konkurrencë të tarifave;

j) në fuqinë ekonomike dhe financiare të sipërmarrësit.

5. Kur një sipërmarrës ka fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, ai vlerësohet se mund të ketë fuqi të ndjeshme në treg edhe në një treg përkatës tjetër, të lidhur horizontalisht, vertikalisht ose gjeografikisht me tregun e analizuar, nëse lidhjet ndërmjet dy tregjeve janë të tilla që mundësojnë shtrirjen e fuqisë së ndjeshme nga tregu i parë në tjetrin, duke fuqizuar kështu fuqinë e sipërmarrësit në treg.

Neni 34

Analiza e tregut

(shtuar pika 5 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i kryen, në intervale të rregullta, por jo më pak se një herë në dy vjet, analizën e tregjeve përkatëse, të identifikuar sipas parashikimeve të këtij ligji. Pas përcaktimit nëse një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, ose nëse ekziston faktikisht një konkurrencë efektive, atëherë detyrimet anulohen, mbahen, shtohen ose vendosen në përfundim të analizës së tregut.

2. Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji. Detyrimet e veçanta, që kanë qenë të vendosura ndaj sipërmarrësve për tregun përkatës, do të ndryshohen ose mbahen nga AKEP-i, bazuar në analizën e tregut, duke pasur parasysh edhe objektivat rregullatorë, të përcaktuar në këtë ligj.

3. Nëse AKEP-i bazuar në procedurën e analizës së tregut arrin në përfundimin se tregu përkatës ka konkurrencë efektive, pra asnjë sipërmarrës nuk ka fuqi të ndjeshme në treg, në këtë rast ajo nuk vendos detyrimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, përjashtuar ato të përcaktuara në nenin 51 të këtij ligji. Nëse ndaj sipërmarrësve në këtë treg janë vendosur detyrime të veçanta, ato hiqen. Në vendimin për heqjen

e këtyre detyrimeve përcaktohet edhe një periudhë kohe jo më shumë se 6 muaj, në përfundim të së cilës heqja e detyrimeve bëhet efektive.

4. AKEP-i publikon vendimet e marra në zbatim të pikave 2 e 3 të këtij neni, sipas përcaktimit në nenin 118 të këtij ligji.

5. Detyrimet e vendosura në përputhje me këtë nen bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe duhet të jenë proporcionale e të justifikuara nga pikëpamja e objektivave rregullatore të vendosura në nenin 7 të këtij ligji.

Neni 35

Procedurat specifike të këshillimit

AKEP-i kryen këshillim publik me grupet e interesit për përfundimet e arritura në përcaktimin dhe analizën e tregjeve, përkatësisht sipas neneve 32 e 34 të këtij ligji. Këshillimi bëhet për një periudhë kohore të përcaktuar 60 ditë. AKEP-i publikon materialet e këshillimit, përfshi edhe komentet e paraqitura nga grupet e interesit. Për mbrojtjen e sekretit tregtar dhe atij operacional të të gjitha palëve, AKEP-i është pika e vetme e informacionit, përmes së cilës do të realizohet i gjithë procesi i këshillimit.

Neni 36

Masat rregulluese

1. Vendosja, ndryshimi, mbajtja ose heqja e detyrimeve, të përcaktuara në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji, ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg bëhen me vendim të AKEP-it, në përfundim të procedurës së përcaktimit të tregjeve dhe analizës së tregjeve.

2. Vendimet e AKEP-së, sipas pikës 1 të këtij neni, merren pas këshillimit publik.

Neni 37

Rishikimi i përcaktimit të tregut dhe analizës së tregut

1. Kur AKEP-i gjykon se faktet, që justifikuan përfundimet e arritura për përcaktimin dhe analizën e tregjeve, kanë ndryshuar dhe nuk pasqyrojnë situatën aktuale në treg, atëherë rishikon përfundimet dhe vendimet përkatëse.

2. Pavarësisht rastit të pikës 1 të këtij neni, AKEP-i është i detyruar që një herë në dy vjet të rishikojë përfundimet për përcaktimin dhe analizën e tregjeve, duke paraqitur përfundimet përkatëse.

Neni 38

Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës

1. Në procesin e përcaktimit të tregjeve dhe analizës së tyre, AKEP-i bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës, sipas përcaktimit të nenit 12 të këtij ligji.

2. AKEP-i dhe Autoriteti i Konkurrencës shkëmbejnë informacionin e nevojshëm, të cilin pala marrëse është e detyruar ta administrojë me të njëjtin nivel konfidencialiteti, si dhe pala dërguese.

Neni 39

Detyrimi i mosdiskriminimit

1. AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrime për mosdiskriminim për aksesin dhe interkoneksionin.

2. Detyrimet për mosdiskriminim sigurojnë, në veçanti, që një sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t'u ofrojë sipërmarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikundër ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij.

3. AKEP-i i kërkon sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg të publikojë një ofertë reference për aksesin dhe interkoneksionin. Sipërmarrësi duhet të ofrojë në këtë ofertë reference shërbime mjaftueshmërisht të detajuara, zbërthimin e ofertave përkatëse në elementet përbërëse, në përputhje me nevojat e tregut dhe deklarin e termave e të kushteve shoqëruese, përfshirë edhe tarifatat.

4. AKEP-i kërkon dhe detyron ndryshime në ofertën referencë të aksesit dhe interkoneksionit, me

qëllim që të realizohen detyrimet e vendosura sipas këtij ligji dhe akteve në zbatim të tij.

Neni 40

Detyrimi i transparencës

1. AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrime për transparencë në lidhje me aksesin dhe interkoneksionin.

2. AKEP-i, pavarësisht parashikimeve të nenit 16 të këtij ligji, vendos ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrimet për të publikuar këtë informacion:

- a) informacion për kontabilitetin;
- b) specifikimet teknike;
- c) karakteristikat e rrjetit;
- ç) termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- d) tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme.

3. AKEP-i përcakton edhe shkallën e hollësive dhe mënyrën e publikimit të informacionit të mësipërm nga sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg.

Neni 41

Detyrimi për ndarjen e llogarive

1. AKEP-i u kërkon sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg të paraqesin deri në hollësi koston për veprimtari të veçanta, që lidhen me aksesin dhe interkoneksionin, për të parandaluar subvencionimin e ndërsjellë, të pandershëm.

2. Për këtë qëllim, në veçanti, sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg të integruar, vertikalisht, i kërkohej të bëjë transparente tarifat e shumicës dhe tarifat e transferimeve të brendshme. AKEP-i përcakton formatin dhe metodologjinë e llogaritjes që do të përdoret, duke përfshirë shkallën e hollësishme dhe mënyrën, me të cilën ato do të paraqiten dhe do të bëhen të disponueshme.

3. Nëse AKEP-i ka vendosur detyrime specifike, sipas neneve 39 e 40 të këtij ligji, atëherë do të kërkojë, pavarësisht sa është parashikuar në nenin 16 të këtij ligji, që të dhënat e llogarive, përfshirë të gjithë informacionin dhe dokumentet shoqëruese, të paraqiten përkundrejt kërkesës në mënyrën dhe formën e përcaktuar. AKEP-i mund ta publikojë këtë informacion, nëse kjo vlerësohet e nevojshme për të nxitur konkurrencën në treg. AKEP-i mban parasysh kërkesat për ruajtjen e sekreteve tregtare dhe operacionale.

Neni 42

Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit

(ndryshuar shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 dhe shtuar fjalë në shkronjën “a” të pikës 3 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për akses dhe interkoneksion, si dhe për përdorimin e elementeve të veçanta të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në veçanti, në ato raste kur AKEP-i vlerëson se nga refuzimi i aksesit ose nga kushtet dhe termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qëndrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë.

2. Sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg i kërkohej njëra, disa, apo të gjitha prej masave të mëposhtme, në mënyrë të veçantë:

a) t’u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elemente të rrjetit, të cilat nuk janë aktive dhe/ose akses të hapur në qarkun lokal, duke lejuar, ndërmjet të tjerash, zgjedhjen dhe/ose parazgjedhjen e bartësit dhe/ose ofertat e rishitjes së linjës së pajtimtarit;

b) të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t’u rishitur nga palët e treta;

c) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;

ç) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;

d) të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;

dh) të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat,

tubacionet kablllore ose shtyllat, kullat;

e) të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore - pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose *roaming*-ut në rrjetet *mobile*;

ë) të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (*software*), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;

f) të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit.

g) të ofrojë akses në shërbimet shoqëruese.

3. Në vendosjen e detyrimeve, sipas pikës 2 të këtij neni dhe për të vlerësuar nëse detyrimi për akses dhe interkoneksion është i justifikuar dhe proporcional, për rregullimet e parashtruara në këtë ligj, AKEP-i duhet të ketë parasysh, veçanërisht, faktorët e mëposhtëm:

a) aftësitë teknike dhe ekonomike për përdorimin ose instalimin e faciliteteve konkurruese, në pikëpamje të shkallës së zhvillimit të tregut, duke pasur parasysh natyrën dhe tipin e interkoneksionit e të aksesit, që është në diskutim, përfshirë mundësinë e aksesit në produkte të tjera të një niveli më të lartë, si aksesin në tubacione;

b) mundësinë e ofrimit të aksesit të propozuar, në relacion me kapacitetet e disponueshme;

c) investimin fillestar nga pronari i faciliteteve, duke mbajtur parasysh riskun e përfshirë në kryerjen e investimit;

ç) nevojën për të garantuar konkurrencën në terma afatgjatë në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike dhe, veçanërisht, duke krijuar stimuj për investime efçente në facilitete, të cilat, në terma afatgjatë, sigurojnë më shumë konkurrencë;

d) të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale.

4. Kur një sipërmarrës dëshmon se përdorimi i facilitetit mund të rrezikojë mirëmbajtjen e tërësisë së rrjetit ose funksionet e rrjetit, AKEP-i nuk vendos detyrim për këtë facilitet ose vendos detyrimin në një formë tjetër. Mirëmbajtja e tërësisë së rrjetit dhe siguria e funksioneve të rrjetit duhet të justifikohen nga sipërmarrësi, bazuar në standardet objektive.

Neni 43

Detyrimi për zgjedhjen e bartësit dhe parazgjedhjen e bartësit

1. AKEP-i u kërkon sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës të lidhjes në rrjetin telefonik publik dhe përdorimit të tij, që t'u mundësojnë pajtimtarëve të tyre aksesin në shërbimet e çdo ofruesi të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, me të cilët janë të interkonektuar, nëpërmjet zgjedhjes ose parazgjedhjes së bartësit.

2. Tarifat për aksesin, si edhe për pagesën e aktivizimit për zgjedhjen ose parazgjedhjen e bartësit duhet të jenë të orientuara drejt kostos.

3. Zgjedhja ose parazgjedhja e bartësit në rrjetet e tjera mund të urdhërohet nga AKEP-i, sipas parashikimeve të nenit 42 të këtij ligji.

Neni 44

Detyrimi për ofrimin e linjave me qira

1. AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrime për ofrimin e një grupi minimal të linjave me qira, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit, të orientimit në kosto dhe transparencës, duke pasur parasysh dokumentet dhe praktikat rregullatore ndërkombëtare përkatëse.

2. Tarifat dhe termat e përgjithshëm për ofrimin e linjave me qira, sipas pikës 1 të këtij neni, miratohen, paraprakisht, nga AKEP-i.

3. AKEP-i vendos detyrime ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg për të zbatuar sistemin e llogaritjes së kostos edhe për shërbimin e ofrimit të linjave me qira. AKEP-i ose ekspertiza e pavarur e përzgjedhur nga ajo, sipas legjislationit në fuqi, verifikon çdo vit përputhshmërinë me sistemin e llogaritjes së kostos, duke publikuar përfundimet e verifikimit.

Neni 45

Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive

1. Nëse AKEP-i, në zbatim të procedurës të përmendur në nenin 34 të këtij ligji, identifikon se një sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg i mban tarifën në një nivel të lartë, të paarsyeshëm, ose në një nivel të ulët, të paarsyeshëm, në dëm të përdoruesve fundorë, vendos detyrime për mbulimin e kostos dhe

kontrollin e tarifave, përfshirë detyrimin për orientimin e tarifave drejt kostos për aksesin dhe/ose interkoneksionin, si edhe detyrime për sistemet e mbajtjes së llogarive.

2. Në vendosjen e detyrimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, AKEP-i ka në vëmendje edhe investimin e bërë nga sipërmarrësi, lejimin e një norme të arsyeshme fitimi mbi kapitalin e punësuar, përfshirë edhe riskun.

Neni 46

Marrëveshjet e aksesit

1. Një sipërmarrës i rrjetit të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg, ndaj të cilit është vendosur detyrim për akses, sipas nenit 42 të këtij ligji, duhet t'u japë sipërmarrësve të tjerë, që kërkojnë akses në rrjetin e tij, një ofertë, që ata të ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike. Oferta e aksesit duhet të paraqitet pa vonesë, por, në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së kërkesës.

2. Marrëveshjet e aksesit të lidhura nga një operator publik i rrjeteve të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg me sipërmarrësit e tjerë hartohen me shkrim.

3. Një sipërmarrës i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike me fuqi të ndjeshme në treg duhet të paraqesë në AKEP marrëveshjet e aksesit, ku ai është palë, brenda 15 ditëve nga data e lidhjes së tyre. AKEP-i publikon vendin dhe orarin kur marrëveshjet e mësipërme të jenë të vlefshme për inspektim nga subjektet, që kërkojnë shërbime dhe facilitete të aksesit.

Neni 47

Detyrimi për interkoneksion dhe marrëveshjet e interkoneksionit (hequr fjalë me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Çdo sipërmarrës i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, duhet që, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë, t'u japë një ofertë interkoneksioni sipërmarrësve të tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, që të sigurojë komunikimin e përdoruesve, ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe bashkëveprimin e shërbimeve në të gjithë komunitetin. Të gjithë sipërmarrësit do të përpiqen të realizojnë objektivin, për të mundësuar dhe përmirësuar komunikimin ndërmjet përdoruesve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike.

2. Sipërmarrësit duhet ta përdorin informacionin e përfituar nga operatorët e tjerë në procesin e negociatave për interkoneksionin vetëm për atë qëllim për të cilin janë dhënë këto të dhëna. Sipërmarrësit duhet të respektojnë, gjatë të gjithë kohës, konfidencialitetin e informacionit të transmetuar dhe nuk do t'ia kalojnë atë ndonjë pale tjetër, për të cilët ky informacion mund të sjellë një avantazh në konkurrencë, përjashtuar rastet kur është përcaktuar ndryshe, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet operatorëve.

3. Oferta referencë e interkoneksionit, sipas nenit 39 të këtij ligji dhe marrëveshjet e interkoneksionit, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të paraqiten në AKEP.

Neni 48

E drejta e palëve për të negociuar

Sipërmarrësit, që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike kanë të drejtë të negociojnë dhe të lidhin marrëveshje teknike dhe ekonomike për aksesin dhe interkoneksionin, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 49

Roli i AKEP-it për sigurimin e aksesit dhe interkoneksionit (ndryshuar pika 2 dhe shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i, në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, nxit dhe, nëse është e nevojshme, detyron realizimin e aksesit dhe të interkoneksionit, si edhe bashkëveprimin e shërbimeve, duke synuar nxitjen e konkurrencës së qëndrueshme dhe efçente, për përfitimin maksimal të përdoruesve fundorë.

2. Pavarësisht nga masat që mund të merren ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, AKEP-i vendos:

a) ndaj sipërmarrësve, të cilët kontrollojnë aksesin te përdoruesit fundorë, detyrimin në masën e duhur, për të siguruar lidhjen pikë fundore – pikë fundore, duke përfshirë, në rastet e justifikuara, detyrimin

për të interkonektuar rrjetet e tyre në mungesë të këtij interkoneksioni;

b) në rastet e justifikuara dhe në masën e duhur, detyrimin ndaj sipërmarrësve, të cilët kontrollojnë aksesin te përdoruesit fundorë për të mundësuar ndërveprueshmërinë e këtyre shërbimeve.

3. Detyrimet dhe kushtet e vendosura në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni duhet të jenë objektive, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese, si dhe të vendosura pas konsultimit publik, në përputhje me nenin 110 të këtij ligji.

4. AKEP-i ndërhyr në nismën e tij, kur është e justifikuar, në përputhje me objektivat e nenit 7 të këtij ligji ose me kërkesë të cilësdo palë, në përputhje me nenet 50 dhe 60 të këtij ligji.

Neni 50

Ankesa në AKEP

1. Nëse sipërmarrësit nuk arrijnë që, brenda 45 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për akses dhe interkoneksion, të lidhin marrëveshjen përkatëse, secila prej tyre mund të paraqesë ankesë në AKEP. Me marrjen e ankesës, AKEP-i fillon procedimin, në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative dhe me parashikimet në nenin 60 të këtij ligji.

2. Në raste të justifikuara, AKEP-i mund të fillojë procedimin edhe me nismën e vet, me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatorë.

3. Në përfundim të procedimit, AKEP-i nxjerr urdhër, sipas parashikimeve të nenit 60 të këtij ligji.

Neni 51

Detyrime edhe ndaj sipërmarrësve, që nuk kanë fuqi të ndjeshme në treg

AKEP-i vendos, sipas neneve 39, 40, 41, 42 e 45 detyrime ndaj sipërmarrësve, që nuk kanë fuqi të ndjeshme në treg, në rast se:

- a) sipërmarrësit i është dhënë e drejta e përdorimit të frekuencave, sipas kreut VII të këtij ligji;
- b) kjo është e nevojshme për të siguruar funksionimin normal të rrjeteve;
- c) kjo kërkohet për të plotësuar angazhimet ndërkombëtare.

Neni 52

Oferta referencë

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg, që është subjekt i një detyrimi për akses dhe interkoneksion, sipas nenit 42 të këtij ligji, paraqet për miratim në AKEP, brenda 45 ditëve pas vënies së këtij detyrimi, një ofertë referencë për shërbimet dhe/ose facilitetet e aksesit. Jo më vonë se 90 ditë nga paraqitja e ofertës së referencës, AKEP-i e miraton atë ose imponon ndryshime, sipas pikës 3 të këtij neni. Në rast se brenda këtij afati AKEP-i nuk shprehet, miratimi konsiderohet i dhënë.

2. Oferta referencë përmban kushtet e ofrimit dhe të përdorimit, përfshirë tarifat. Oferta referencë duhet të jetë lehtësisht e kuptueshme nga sipërmarrësit.

3. AKEP-i kontrollon dhe nëse vëren se oferta referencë nuk i plotëson kërkesat, që lidhen me kushtet e veçanta, për ndershmërinë, mosdiskriminimin, transparencën, arsyeshmërinë dhe grafikun kohor, imponon ndryshimin e ofertës referencë të paraqitur. Përgjithësisht, AKEP-i përcakton një kohëzgjatje minimale për vlefshmërinë e ofertës referencë të paraqitur. Sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg duhet të njoftojë AKEP-in 3 muaj përpara përfundimit të kësaj kohëzgjatjeje minimale për çdo ndryshim ose ndërprerje të ofertës referencë.

4. Kur një shërbim ose facilitet aksesit është subjekt i një marrëveshjeje aksesit, sipas nenit 46 të këtij ligji, AKEP-i detyron sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg, që t'ua ofrojnë këtë shërbim ose facilitet, në baza jodiskriminuese, edhe sipërmarrësve të tjerë. Kjo zbatohet edhe për shërbimet dhe facilitetet e aksesit, që një sipërmarrës i rrjeteve të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg është i detyruar të ofrojë ose të bëjë të disponueshme, sipas një vendimi të dhënë nga Këshilli Drejtues i AKEP-së, në përputhje me nenin 60 të këtij ligji.

5. Nëse kushtet në treg kanë ndryshuar në mënyrë të ndjeshme, AKEP-i detyron sipërmarrësin e

rrjeteve të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg, të ndryshojë ofertën referencë. Kjo përfshin shërbimet, facilitetet dhe kushtet kryesore të ofrimit të tyre. Në rastin e ndryshimit të ofertës referencë zbatohen pikat 2, 3, 4 e 5 të këtij neni.

6. Sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg është i detyruar të përditësojë ofertën referencë, të publikuar.

7. Kur një sipërmarrës ka detyrimin për të ofruar akses të hapur në qarkun lokal, në ofertën referencë që duhet të publikojë, sipas përcaktimeve të këtij neni, është i detyruar të përfshijë, të paktën, elementet e mëposhtme:

I. Kushtet për aksesin e hapur në rrjetin lokal:

a) elementet e rrjetit, për të cilat ofrohet akses i mbulon, në veçanti elementet e mëposhtme:

i) akses i hapur në linjat e rrjetit lokal (*local loop*);

ii) akses i hapur në brezin e frekuencave jozanore të rrjetit lokal (*lokal loop*), në rastin e aksesit të përbashkët.

iii) kur është e përshtatshme akses në tubacione për të mundësuar shtrirjen e rrjeteve të aksesit.

b) informacioni për vendndodhjet e aksesit fizik, duke përfshirë kabinetet dhe permutatorët, disponueshmërinë e rrjeteve lokale, nënlokale dhe rrjeteve mbështetëse në pjesë të veçanta të aksesit në rrjet dhe, kur është e nevojshme, informacion lidhur me vendndodhjet e tubacioneve dhe disponueshmërinë brenda tubacioneve;

c) kushtet teknike të lidhura me aksesin dhe përdorimin e linjave të rrjetit lokal, përfshirë karakteristikat teknike të linjave metalike dypërcjellëse dhe/ose fibrave optike, dhe/ose të ngjashme, shpërndarësve të kabllave apo faciliteteve shoqëruese dhe, kur është e nevojshme, kushtet teknike lidhur me aksesin në tubacione;

ç) procedurat për porositjen, dhënien, kufizimet e përdorimit.

II. Shërbimet e bashkëvendosjes:

a) informacion për vendndodhjen ekzistuese të godinave apo pajisjeve përkatëse të sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg ose vendndodhjen e pajisjeve dhe planet për përditësimin e tyre;

b) opsionet e bashkëvendosjes në vendet e përcaktuara, sipas pikës 1 të këtij neni (përfshirë bashkëvendosjen fizike dhe, sipas përshtatshmërisë, edhe bashkëvendosjen në distancë dhe bashkëvendosjen virtuale);

c) karakteristikat e pajisjeve: kufizimet (nëse ekzistojnë) për pajisjet, që mund të bashkëvendosen;

ç) çështjet e sigurisë: masat e përcaktuara nga sipërmarrësi ofrues i shërbimeve të aksesit të hapur në rrjetin lokal, për të garantuar sigurinë e këtyre vendeve;

d) kushtet e hyrjes për punonjësit e sipërmarrësve përfitues të mundshëm;

dh) standardet për sigurinë;

e) rregullat për alokimin e vendit, kur hapësirat e bashkëvendosjes janë të kufizuara;

ë) kushtet, sipas të cilave përfituesit e aksesit të shpërndarë mund të inspektojnë vendet, në të cilat bashkëvendosja është e mundur, apo vendet ku bashkëvendosja është refuzuar, me argumentin e mungesës së hapësirës.

III. Sistemet e informacionit:

Kushtet për akses në sistemet mbështetëse operacionale të sipërmarrësit ofrues të aksesit të shpërndarë të sistemeve të informacionit apo bazave të të dhënave për porositjen paraprake, dhënien, porositjen, mirëmbajtjen dhe kërkesat për riparime dhe faturimet.

IV. Kushtet e ofrimit:

a) koha që mund të kalojë deri në përgjigjen ndaj kërkesave për ofrimin e shërbimeve dhe faciliteteve; marrëveshjet për nivelin e shërbimit, eliminimin e dështimeve, procedurat për t'u kthyer shërbimin në një nivel normal dhe parametrat e cilësisë së shërbimit;

b) kushtet standarde të kontratave, përfshirë, nëse është e përshtatshme, zhdëmtimin që paguhet kur nuk realizohet përgjigja brenda kohës;

c) çmimet apo formulat e përcaktimit të çmimeve për secilin prej shërbimeve, funksioneve dhe faciliteteve të përmendura më sipër.

Neni 53

Tarifat dhe qëllimi i rregullimit të tyre

1. Tarifat e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike vendosen nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike. Në përcaktimin e tyre sipërmarrësit duhet të synojnë orientimin e tarifave drejt kostos. Në çdo rast sipërmarrësit duhet të shmangin përdorimin e tarifave

abuzive, shpërdoruese dhe antikonkurruese.

2. Qëllimi i rregullimit të tarifave është parandalimi i sjelljeve antikonkurruese dhe i diskriminimit të përdoruesve fundorë dhe konkurruesve në treg që mund të rezultojnë nga veprimet e sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg për tarifë.

3. Masat për rregullimin e tarifave duhet të jenë të bashkërenduara dhe proporcionale në relacion për rregullimin e përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.

Neni 54

Publikimi i tarifave të përdoruesve fundorë

1. Sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun ka detyrimin:

a) të publikojë tarifën e shërbimeve dhe të mundësojë informimin e publikut edhe nëpërmjet aksesit në distancë;

b) të njoftojë, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, çdo ndryshim në tarifën e shërbimeve, jo më pak se 7 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre ose të ndryshimeve dhe ky njoftim duhet të bëhet për jo më pak se 3 ditë rresht;

c) të paraqesë në AKEP tarifën e shërbimeve, si dhe çdo ndryshim të tyre.

2. AKEP-i publikon vlerësimin e përgjithshëm krahasues të tarifave aktuale, të cilësisë dhe kushteve të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun për sipërmarrësit e ndryshëm, me qëllim që përdoruesit fundorë të kenë mundësi t'i krahasojnë këto të dhëna.

Neni 55

Rregullimi i tarifave

(shtuar shkronja "c" e pikës 2 me ligjin nr. 107/2018, datë 20.12.2018)

1. Në rregullimin e tarifave të komunikimeve elektronike, AKEP-i vepron sipas përcaktimeve të këtij ligji. Me rregullim të tarifave kuptohet përcaktimi ose ndryshimi i vlerës së tarifave, pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar.

2. AKEP-i ka të drejtë të zbatojë rregullimin e tarifave nëpërmjet një vendimi për rregullimin e tarifave për:

a) shërbimet e përfshira në skemën e shërbimit universal, të ofruara nga ofruesi i shërbimit universal, sipas përcaktimeve në nenin 57 të këtij ligji;

b) shërbimet e ofruara nga sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg në tregun përkatës.

c) shërbimet e roaming-ut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime.

3. AKEP-i monitoron dhe vlerëson ecurinë në treg të niveleve të tarifave që janë ose mund të jenë subjekt i rregullimit për shërbimet e komunikimeve elektronike, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Gjatë rregullimit të tarifave, AKEP-i merr parasysh mbrojtjen e interesave të sipërmarrësit, tarifën e të cilit janë në rregullim, në mënyrë që tarifën që do të rezultojnë nga vendimi i AKEP-së, sipas pikës 2 të këtij neni, të jenë të orientuara drejt kostos. Kjo nuk do zbatohet për shërbimet e ofruara në përputhje me pikën 3 të nenit 27 të këtij ligji.

Neni 56

Zbatimi i rregullimit të tarifave

1. Nëse nga analiza e tregut të kryer, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, është arritur në përfundimin se për tregun përkatës të aksesit dhe interkoneksionit (tregu i shumicës) nuk ka konkurrencë efektive, që nënkupton se në treg nga sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg janë zbatuar tarifa të larta të paarsyeshme, ose tarifa të ulëta të paarsyeshme, në dëm të përdoruesve fundorë dhe nëse masat e parashikuara në nenet 39 deri 43 të këtij ligji nuk janë të mjaftueshme, AKEP-i ka të drejtë të vendosë detyrimin për rregullimin e tarifave në këtë treg përkatës, sipas nenit 57 të këtij ligji duke nxjerrë vendimin për rregullimin e tarifave.

2. Nëse nga analiza e tregut të kryer, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, për tregun përkatës për

përdoruesit fundorë (tregu i pakicës) është arritur në përfundimin se në këtë treg nuk ka konkurrencë efektive dhe nëse masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk janë të mjaftueshme, AKEP-i ka të drejtë të vendosë ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrime të veçanta sipas shkronjave “a” ose “b” të kësaj pike:

- a) detyrimet e veçanta përfshijnë kërkesat që sipërmarrësi:
 - i) të mos zbatojë tarifa tepër të larta;
 - ii) të mos pengojë hyrjen në treg të lojtarëve të rinj;
 - iii) të mos kufizojë konkurrencën, nëpërmjet zbatimit të tarifave të larta të paarsyeshme ose tarifave të ulëta të paarsyeshme;
 - iv) të mos shfaqë parapëlqime të diferencuara ndaj përdoruesve fundorë të veçantë;
 - v) të mos ofrojë paketa të paarsyeshme shërbimesh;
- b) detyrimin për nxjerrjen e vendimit përkatës për rregullimin e tarifave, sipas nenit 57 të këtij ligji.

3. Nëse rregullimi i tarifave, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është vendosur ndaj një sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg, vendimi i marrë nga AKEP-i lejon që sipërmarrësi të ketë një normë të arsyeshme të kthimit të kapitalit të punësuar, duke marrë parasysh rrezikun e lidhur me të.

4. Nëse tarifat e zbatuara për ofrimin e shërbimeve të portabilitetit të numrit dhe zgjedhjes/parazgjedhjes së bartësit pengojnë pajtimtarët për përdorimin e këtyre shërbimeve, AKEP-i nxjerr një vendim për rregullimin e tarifave përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 57

Metoda e rregullimit të tarifave

1. AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave të mëposhtme:
 - a) përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;
 - b) korigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:
 - i) kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe;
 - ii) raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar;
 - iii) procedura, që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove eficientë, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;
 - c) përcaktimin e një periudhe kohore, në asnjë rast më të gjatë se 12 muaj, gjatë së cilës ndalohet rritja e tarifave mbi nivelin aktual të tyre në një treg përkatës.
2. Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:
 - a) praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;
 - b) tarifat mesatare të vendeve të BE-së;
 - c) tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;
 - d) raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;
 - e) normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.
3. Metodatat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.
4. Sipërmarrësit, që kanë detyrimin për të zbatuar detyrimet e veçanta dhe rregullimin e tarifave, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 56, duhet të aplikojnë paraprakisht në AKEP për miratimin e tarifave, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vendimin e AKEP-it për rregullimin e tarifave.
5. AKEP-i ose një ekspertizë kontabël e pavarur e përzgjedhur nga ajo, verifikon përputhshmërinë e tarifave nën rregullim me metodën dhe kushtet e përcaktuara për rregullimin e tarifave.

Neni 58

Vendimi për tarifat

1. Përpara marrjes së vendimit për rregullimin e tarifave, AKEP-i kryen procesin e konsultimit me palët e interesuara, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
2. Vendimi për rregullimin e tarifave përfshin parashikime në lidhje me:
 - a) një kufi kohor të arsyeshëm;

- b) detyrimin për dhënie informacioni, sipas nenit 16 të këtij ligji;
- c) kushte për kohën e zbatimit në treg të tarifave të miratuara;
- ç) kushte shoqëruese, në rast se ndonjë tarifë zbatohet ndryshe nga ajo e miratuar, ose ndryshohet pasi të jetë miratuar;
- d) detyrime për përshtatjen e tarifave të miratuara, në rast se ndryshojnë tarifat e aksesit dhe interkoneksionit (tarifat e shumicës);
- dh) kushtet për njoftimin e ndryshimeve në tarifat nën rregullim, të cilat mund të jenë të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 54 pika 1 shkronja “b” të këtij ligji;
- e) një nga metodat e përzgjedhura nga AKEP-i sipas nenit 57 të këtij ligji.

Neni 59

Zbatimi i detyrimit për orientimin e tarifave drejt kostos

1. Kur një sipërmarrës ka detyrimin për orientimin e tarifave drejt kostos, është i detyruar të provojë që tarifat e shërbimeve të ofruara prej tij janë rrjedhojë e kostos eficiente, duke mundësuar një normë fitimi të arsyeshme.
2. Me qëllim llogaritjen e kostos së ofrimit eficient të shërbimeve, AKEP-i përdor metoda të llogaritjes së kostos, të pavarura nga ato të përdorura nga sipërmarrësit.
3. Me kërkesë të AKEP-it, brenda një afati kohor prej 45 ditësh, sipërmarrësi duhet të provojë se tarifat e tij janë të orientuara drejt kostos. Nëse sipërmarrësi, brenda afatit të caktuar, dështon në justifikimin e tarifave si më sipër, AKEP-i konsideron se tarifat nuk janë të orientuara drejt kostos.
4. AKEP-i, duhet të sigurojë që sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg, ndaj të cilit është vendosur detyrimi për llogaritjen e kostos, të bëjë publikisht të vlefshme përkrahimin e sistemit të llogaritjes së kostos, duke treguar të paktën kategoritë kryesore, në të cilat janë grupuar kostot dhe rregullat e përdorura për caktimin e kostove.
5. AKEP, ose një ekspertizë e kualifikuar e pavarur, e përzgjedhur nga AKEP-i, ka të drejtë të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë me sistemin e llogaritjes së kostos.

Neni 60

Vendimi i AKEP-it

(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Në rastet kur një marrëveshje aksesi dhe interkoneksioni, sipas neneve 46 dhe 47 të këtij ligji, nuk është arritur tërësisht ose pjesërisht dhe kur janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë ligj për vendosjen e një detyrimi për të dhënë akses, AKEP-i, pasi shqyrton pretendimet e palëve, sipas nenit 50 të këtij ligji merr vendim për lidhjen e marrëveshjes për akses dhe interkoneksionin. Në vendimin e këshillit drejtues të AKEP-it përcaktohet edhe afati për zbatimin e tij, i cili nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.
2. Vendimi i këshillit drejtues të AKEP-it për lidhjen e marrëveshjes për akses dhe interkoneksion është i lejuar vetëm nëse dhe për sa kohë që palët përkatëse dështojnë në arritjen e një marrëveshjeje aksesi ose interkoneksioni.
3. Parashtrimi i pretendimeve të palëve, sipas pikës 1 të këtij neni, përpara AKEP-it duhet të bëhet me shkrim. Ato duhet të jenë të provuara. Në veçanti ato duhet të përfshijnë:
 - a) kohën kur është kërkuar aksesi dhe/ose interkoneksioni dhe, konkretisht, për cilat shërbime dhe/ose facilitete;
 - b) argumentet e plota për të dëshmuar se janë zhvilluar negociata serioze, ose se pala tjetër ka kundërshtuar të hyjë në negociata;
 - c) pikat, për të cilat nuk është arritur marrëveshje;
 - ç) shënime sqaruese për mundësinë e realizimit teknik të çdo mase të veçantë teknike, që kërkohet.
4. Pretendimet mund të tërhiqen për sa kohë që vendimi nuk është nxjerrë nga AKEP-i.
5. Pavarësisht sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, për të arritur synimet e vendosura në nenin 7 të këtij ligji, AKEP-i mundet, gjithashtu, që ta trajtojë rastin me nismën e vet.
6. Objekt i një vendimi të tillë mund të jetë secili prej termave dhe kushteve të një marrëveshjeje aksesi dhe/ose interkoneksioni, përfshirë edhe tarifat. AKEP-i mund t'i bashkëlidhë këtij vendimi kushte për ndershmërinë, transparencën, mosdiskriminimin, arsyeshmërinë dhe grafikun kohor. Në lidhje me përcaktimin e tarifave, zbatohen nenet 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 të këtij ligji.
7. Kur pjesë e pretendimeve të parashtruara dhe e shqyrtimit përkatës janë termat dhe kushtet e një marrëveshjeje aksesi dhe interkoneksioni, si edhe tarifat e pagueshme për shërbimet dhe/ose facilitetet e

kërkuara, AKEP-i mund të marrë vendime për termat, kushtet dhe tarifën. Afati i zbatimit të këtyre vendimeve është një muaj nga data e hyrjes në fuqi të tyre.

8. Sipërmarrësit duhet të zbatojnë vendimin e këshillit drejtues të AKEP-it brenda afateve të përcaktuara në të. Në rast të moszbatimit të vendimit, AKEP-i vendos gjobë, sipas parashikimeve të nenit 137 të këtij ligji.

Neni 61

Kontrolli i veçantë ndaj sjelljeve antikonkurruese

1. Sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg, që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike, nuk duhet të abuzojnë me pozitën e tyre në treg.

2. Kur AKEP-i, me nismën e vet, ose nëpërmjet njoftimit nga sipërmarrës të tjerë apo palë të tjera të interesuara, gjykon se sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg po abuzon me pozitën e tij, e parashtron rastin përpara Autoritetit të Konkurrencës, duke i kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore.

KREU VII

SPEKTRI I FREKUENCAVE

Neni 62

Administrimi i spektrit të frekuencave

(ndryshuar fjalë në shkronjën "b" të pikës 3, ndryshuar pika 4 dhe shtuar pikat 5-12 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Spektri i frekuencave është burim natyror i fundmë. Administrimi i spektrit duhet të sigurojë përdorimin e frytshëm dhe efektiv të tij, në përputhje edhe me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtarë dhe detyrimet, që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Për sigurimin e përdorimit të frytshëm dhe pa interferenca të frekuencave hartohet Plani Kombëtar i Frekuencave dhe Plani i Përdorimit të Frekuencave.

3. Spektri i frekuencave administrohet nga:

a) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për spektrin e frekuencave të caktuara për përdorim për qëllime civile, përveç frekuencave të caktuara për transmetimet radio dhe televizive;

b) Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) për brezat e frekuencave, të caktuara për përdorim për transmetimet radio dhe televizive, për atë kohë sa nuk është parashikuar ndryshe nga legjislacioni në fuqi;

c) Ministria e Mbrojtjes, Ministria Brendshme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për spektrin e frekuencave të caktuara për përdorim për qëllime qeveritare, të mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë së rendit publik.

4. Për përdorimin e frekuencave, përdoruesit civilë paguajnë një tarifë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për taksat në Republikën e Shqipërisë. Niveli i tarifës do të reflektojë nevojën për të garantuar një përdorim optimal të radiofrekuencave, si një burim i fundëm dhe duhet justifikuar në mënyrë objektive, transparente, jodiskriminuese e proporcionale në raport me qëllimin e tyre.

5. Administrimi i spektrit duhet të sigurojë që të gjitha llojet e teknologjisë së përdorur për shërbimet e komunikimeve elektronike dhe të gjitha llojet e shërbimeve të komunikimeve elektronike mund të përdoren në brezat e radio frekuencave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave, të vlefshme për shërbimet e komunikimeve elektronike.

6. Pavarësisht nga sa përcaktohet në pikën 5 të këtij neni, Plani Kombëtar i Frekuencave dhe Plani për Përdorimin e Frekuencave mund të parashikojnë kufizime proporcionale dhe jodiskriminuese për llojet e rrjeteve radio ose teknologjisë së aksesit pa tela, të përdorur për shërbimet e komunikimeve elektronike, kur kjo është e nevojshme:

a) për të parandaluar interferencat e dëmshme;

b) për të mbrojtur shëndetin publik nga fushat elektromagnetike;

c) për të siguruar cilësinë teknike të shërbimit;

ç) për të siguruar maksimizimin e përdorimit të frekuencave që bashkëpërdoren;

d) për ruajtjen dhe përdorimin efikas të spektrit; ose

dh) për të siguruar përmbushjen e objektivave me interes të përgjithshëm, në përputhje me pikën 7 të këtij neni.

7. Pavarësisht nga sa përcaktohet në pikën 5 të këtij neni, Plani Kombëtar i Frekuencave dhe Plani

për Përdorimin e Frekuencave mund të parashikojnë kufizime proporcionale dhe jodiskriminuese për llojet e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të cilat do të ofrohen kur kjo është e nevojshme, për të siguruar përmbushjen e objektivave me interes të përgjithshëm, siç janë:

- a) përmbushja e kërkesave të Radio Rregulloreve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU);
- b) siguria për jetën;
- c) promovimi i një bashkëveprimi social, rajonal ose territorial;
- ç) parandalimi i përdorimit joefikas të radiofrekuencave; ose
- d) promovimi i larmisë kulturore, gjuhësore dhe shumëllojshmërisë së mediave, për shembull, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të transmetimeve radiotelevizive.

8. Përcaktimet e pikës 5 të këtij neni zbatohen për frekuencat që do të caktohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

9. Për një periudhë pesëvjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, AKEP-i mund të lejojë mbajtësit e autorizimeve individuale për frekuencat e dhëna para hyrjes në fuqi të këtij ligji, të paraqesin aplikim pranë AKEP-it për rivlerësimin e kufizimeve, sipas pikës 5 të këtij neni.

10. AKEP-i njofton, me shkrim, mbajtësin e autorizimit individual që ka aplikuar, sipas pikës 9 të këtij neni, për vendimin e rivlerësimit të kufizimeve, në një afat të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se 60 ditë nga aplikimi. Mbajtësi i autorizimit individual ka të drejtë të tërhiqet, me shkrim, nga kërkesa për rishikimin e kufizimeve brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit të AKEP-it. Në rast se mbajtësi i autorizimit individual nuk tërhiqet, me shkrim, brenda 30 ditëve nga kërkesa për rishikimin e kufizimeve, atëherë vendimi i AKEP-it bëhet i detyrueshëm për mbajtësin e autorizimit individual.

11. Pas periudhës pesëvjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, AKEP-i merr masat për rivlerësimin e të gjitha autorizimeve të mbetura, në përputhje me kërkesat e pikës 5 të këtij neni.

12. Në zbatimin e kërkesave të këtij neni AKEP-i siguron konkurrencën e ndershme. Rivlerësimi i autorizimeve, sipas kërkesave të këtij neni, nuk do të thotë dhënie e një autorizimi të ri.

Neni 63

Plani Kombëtar i Frekuencave

1. Plani Kombëtar i Frekuencave dhe çdo ndryshim i tij miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Plani Kombëtar i Frekuencave hartohet nga ministri, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, të përcaktuara në pikën 3 të nenit 62 të këtij ligji.

2. Plani Kombëtar i Frekuencave hartohet në përputhje me radorregulloret përkatëse të ITU-së dhe Tabelën për Përcaktimin e Përbashkët Europian të Frekuencave (ECA). Plani Kombëtar i Frekuencave përcakton brezat e frekuencave për shërbimet e radiokomunikimeve. Për sigurimin e përdorimit të frytshëm dhe pa interferenca të dëmshme të frekuencave, ky plan përmban edhe dispozita, që udhëzojnë përdorimin e frekuencave, si dhe përcaktime të tjera më të hollësishme.

Neni 64

Plani i Përdorimit të Frekuencave

1. AKEP-i harton Planin e Përdorimit të Frekuencave për brezat e frekuencave në administrim.

2. Plani i Përdorimit të Frekuencave hartohet në përputhje me përcaktimet dhe udhëzimet e PKRF-së dhe përcakton nënbrezat për shërbimet e ndryshme të radiokomunikimeve, si dhe përmban parametrat dhe kushtet teknike të përdorimit të frekuencave.

3. AKEP-i ka të drejtë që, për interesin publik, t'i japë përparësi përdorimit të spektrit të frekuencave, për ofrimin e shërbimit universal dhe për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

4. AKEP-i publikon Planin e Përdorimit të Frekuencave, kushtet, procedurat dhe pagesat për përdorimin e spektrit të frekuencave, si dhe e përditëson periodikisht këtë informacion.

5. Informacioni për brezat e frekuencës, të rezervuara në skemën e përdorimit të spektrit të frekuencave për qëllime mbrojtjeje dhe të sigurisë kombëtare nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit, nuk publikohet.

6. AKEP-i, nëpërmjet dokumenteve rregullatore, përcakton mënyrën e krijimit të shenjave të thirrjes, të kodeve dhe numrave identifikues, përdorimet e tyre dhe llojet e shërbimeve të radiokomunikimeve, për të cilat ato përdoren.

7. AKEP-i përcakton, nëpërmjet dokumenteve rregullatore, kushtet teknike dhe të funksionimit të shërbimeve radioamatore.

Neni 65

Përdorimi i frekuencave

1. Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuenca vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. E drejta e përdorimit të frekuencave kufizohet vetëm në rast se kjo kushtëzohet nga pamjaftueshmëria e frekuencave dhe nga detyrimi për të siguruar përdorimin eficient të tyre.

3. Kur frekuencat përdoren në kundërshtim me këtë ligj e rregulloret përkatëse dhe pa autorizimin përkatës, të lëshuar sipas këtij ligji, AKEP-i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme, në përputhje me këtë ligj.

4. Për përdorimin e frekuencave të caktuara në PKRF, për qëllime të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së vendit, nuk do të kërkohet autorizim nga AKEP-i.

5. Disa frekuenca mund të përdoren pa autorizim, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me rregullat e detyrimit ndërkombëtare, të pranura nga Republika e Shqipërisë.

Neni 66

Dhënia në përdorim e frekuencave

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

Në përcaktimin e frekuencave që mund të përdoren, sipas autorizimit të përgjithshëm dhe në lëshimin e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave, AKEP-i mban parasysh që frekuencat janë një pasuri kombëtare me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore. Dhënia në përdorim e frekuencave nga AKEP-i bëhet në bazë të parimit të objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit e mosdiskriminimit, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, radiatorregulloret e ITU-së dhe në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.

Neni 67

Procedura e dhënies së autorizimit individual

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Kur përdorimi i radio frekuencave nuk është subjekt i autorizimit të përgjithshëm, sipas pikës 5 të nenit 65 të këtij ligji, apo subjekt i një konkurrimi publik, sipas neneve 68 e 69 të këtij ligji, AKEP-i lëshon autorizime individuale, sipas procedurave të përcaktuara në këtë nen. Nëse AKEP-i merr aplikime të ndryshme për autorizime individuale në të njëjtin brez frekuencash, i shqyrton ato sipas radhës së paraqitjes së tyre.

2. AKEP-i përcakton kushtet për përdorimin e frekuencave në autorizimin e përgjithshëm, kur nuk është e nevojshme të jepet autorizim individual për përdorimin e frekuencave, sipas pikës 5 të nenit 65 të këtij ligji.

3. Dhënia për përdorim e frekuencave bëhet në përputhje me Përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave, pa diskriminim, në mënyrë transparente dhe objektive.

4. Dhënia për përdorim e frekuencave bëhet vetëm në rast se:

a) qëllimi i përdorimit të tyre është parashikuar në Planin Kombëtar të Frekuencave dhe planin e caktimit dhe përdorimit të frekuencave;

b) janë të mundshme për përdorim;

c) garantojnë pajtueshmërinë me përdorimin e frekuencave të tjera;

ç) garantojnë përdorimin eficient dhe pa interferenca të dëmshme nga aplikanti.

5. Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave jepet përkundrejt aplikimit të paraqitur në AKEP, i cili duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e aplikantit;

b) të dhënat e regjistrimit;

c) personat e kontaktit të aplikantit;

ç) shpjegime për nevojën e përdorimit të frekuencës;

d) zgjidhjet teknike dhe, në veçanti, të dhëna për zonën gjeografike të përdorimit, mënyrën e llogaritjes së radiopërhapjes dhe përcaktimin e zonës së shërbimit, koordinatat gjeografike të vendndodhjes së transmetuesve, fuqinë, modulimin dhe llojin e transmetimit, sistemin e antenave dhe pajisjet radio.

6. AKEP-i është i detyruar të lëshojë autorizimin individual brenda 30 ditëve nga marrja e aplikimit, në përputhje me përcaktimet e pikës 5 të këtij neni.

7. AKEP-i refuzon dhënien e autorizimit individual në rast se:

- a) aplikantit i është hequr frekuenca në 5 vitet e fundit për shkelje të ligjit;
- b) dhënia e frekuencave nuk garanton shfrytëzimin eficient të spektrit;
- c) përdorimi i frekuencës së kërkuar shkakton interferenca të dëmshme të pashmangshme me pajisje të tjera radio ose me sisteme të tjera elektrike apo elektronike;
- ç) dhënia e frekuencës së kërkuar rrezikon rendin publik ose sigurinë kombëtare.

Neni 68

Marrja e mendimeve të palëve të interesuara

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Nëse AKEP-i, në bazë të vlerësimit të tregut, konsideron se interesi për brezin e kërkuar të frekuencave mund të tejkalojë disponueshmërinë e frekuencave në këtë brez, si dhe për garantimin e një përdorimi efektiv të tyre, ai zhvillon një proces këshillimi publik me palët e interesuara, lidhur me kushtet e përdorimit të këtij brezi frekuencash dhe procedurën që mendohet të zbatohet për dhënien në përdorim të tyre.

2. AKEP-i është i detyruar të kryejë procesin e këshillimit publik me paraqitjen e një kërkesë, nga çdo palë e interesuar për frekuenca specifike, jo më vonë se 30 ditë pas paraqitjes së kërkesës. AKEP-i fillon procesin e këshillimit publik për frekuenca specifike, subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara, edhe me kërkesë të ministrit.

3. Njoftimi për këshillim publik përmban të dhëna për frekuencat që do të caktohen, numrin e pritshëm të të drejtave të përdorimit që do të jepen, kushtet që mendohet të vendosen për këto të drejta përdorimi, kërkesën që palët e interesuara të shprehin mendimin e tyre për vlerën e tregut të frekuencave dhe të gjitha çështjet, për të cilat AKEP-i është i interesuar të marrë opinionin e palëve të interesuara. Afati i paraqitjes së mendimeve, në çdo rast, nuk do të jetë më pak se 30 ditë.

4. AKEP-i është i detyruar të respektojë konfidencialitetin e propozimeve të mundshme të bëra nga palët e interesuara për vlerën e tregut për këto frekuenca.

5. Brenda 30 ditëve pas afatit përfundimtar të paraqitjes së mendimeve të palëve të interesuara në procesin e këshillimit publik, AKEP-i publikon mendimet e tyre dhe qëndrimin e tij për çështjet e ngritura.

6. AKEP-i, mbështetur në përfundimet e tij, sipas pikës 5 të këtij neni, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i këshillimit publik, i propozon ministrit kufizimin ose jo të të drejtave të përdorimit të frekuencave, procedurën e konkurrimit publik, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore për këtë qëllim, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre, duke konsideruar zhvillimin e konkurrencës, interesin publik dhe mbrojtjen e konsumatorit, rrethanat e tregut dhe përdorimin efektiv të frekuencave.

7. Ministri, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së propozimit të AKEP-it, sipas pikës 6 të këtij neni, miraton numrin e autorizimeve individuale, vlerën minimale për dhënien e tyre dhe nxjerr urdhër për fillimin e konkurrimit publik, sipas nenit 69 të këtij ligji. Në çdo rast, vendimi për kufizimin e të drejtave të përdorimit duhet të jetë i arsyetuar.

8. Kur në përfundim të procesit të këshillimit të kryer, sipas këtij neni, kufizimi i numrit të autorizimeve individuale nuk është i nevojshëm dhe nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesin e përdoruesve ose me interesin e zhvillimit të konkurrencës ekonomike, AKEP-i vijon procesin me dhënien e autorizimit individual, sipas nenit 67 të këtij ligji, pasi të marrë miratimin e ministrit për vijimin e procedurës dhe vlerën minimale të dhënies në përdorim të frekuencave.

9. Fituesi i së drejtës për përdorimin e frekuencave, që jepen me procedurën e konkurrimit publik, sipas nenit 69 të këtij ligji, kryen një pagesë për frekuencat në vlerën e arritur në procesin e konkurrimit, e cila derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Neni 69

Procedura e konkurrimit publik

(ndryshuar titulli dhe fjalia e parë e pikës 1 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Jo më vonë se 15 ditë pas miratimit të ministrit, sipas pikës 7 të nenit 68 të këtij ligji, AKEP-i zhvillon procedurën e konkurrimit publik për të dhënë autorizime individuale për një numër të kufizuar të drejtash për përdorimin e frekuencave, sipas rregullave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave,

me propozim të ministrit, për procedurën përkatëse. Procedura duhet të jetë objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale për të përmbushur objektivat e nenit 7 të këtij ligji.

2. Koha e fillimit të shërbimit, periudha e autorizimit dhe numri i sipërmarrësve përcaktohen nga ministri, ndërsa veprimtaritë e tjera kryhen nga AKEP-i.

Neni 70

Përmbajtja e autorizimit individual

1. Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave përmban:
 - a) të dhëna për përfituesin;
 - b) frekuencat e përfituara;
 - c) vendndodhjen dhe zonën e mbulimit;
 - ç) afatin e vlefshmërisë së autorizimit;
 - d) kushtet, që duhet të përmbushen për shfrytëzimin e frekuencës së caktuar, sipas nenit 71 të këtij ligji.
2. Përdoruesit e frekuencave janë të detyruar të njoftojnë AKEP-in për të gjitha ndryshimet e mundshme, të dhëna në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga koha e ndodhjes së tyre.

Neni 71

Kushtet për shfrytëzimin e frekuencave të caktuara

1. Kushtet, që duhet të plotësohen nga përdoruesi, për shfrytëzimin e frekuencave, zbatohen edhe për shërbimet e komunikimeve elektronike, ose rrjetet e komunikimeve elektronike, për të cilat janë dhënë frekuencat.
2. AKEP-i përfshin në autorizim kushte për:
 - a) masat, për të siguruar përdorimin eficient të frekuencave dhe, ku është e nevojshme, detyrimet për mbulimin dhe fortësinë e sinjalit (fuqinë e transmetimit);
 - b) kushtet teknike të funksionimit, të nevojshme për shmangien e interferencave të dëmshme dhe kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike;
 - c) afatin e vlefshmërisë së përdorimit të frekuencave;
 - ç) transferimin e të drejtave të pronësisë për përdorimin e frekuencave dhe kushtet për këtë transferim;
 - d) kryerjen e pagesave;
 - dh) detyrime të tjera, të marra përsipër nga fituesi gjatë pjesëmarrjes në tenderin publik (p.sh. dinamika e ngritjes së rrjetit të komunikimeve elektronike etj.);
 - e) detyrime për aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 72

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së autorizimit individual të frekuencave

(shtuar një fjali në fund të pikës 1 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i lëshon autorizim individual për një interval kohe jo më të madh se 15 vjet. Kohëzgjatja do të jetë e përshtatshme për shërbimin e ofruar në këndvështrim të objektivit të caktuar, duke marrë parasysh nevojën për të lejuar një periudhë të përshtatshme për kthimin e investimit.
2. AKEP-i lëshon autorizim individual, që përdoret për shërbime të lëvizshme, ajrore dhe detare, me kohëzgjatje deri në ndërprerjen e përdorimit të tyre.
3. AKEP-i lëshon autorizime individuale për përdorimin e frekuencave për qëllime kërkimi, matjeje dhe prove të pajisjeve të radiokomunikimit për një zonë të kufizuar mbulimi dhe për një periudhë kohore jo më shumë se 90 ditë.
4. AKEP-i lëshon autorizime individuale për përdorim të frekuencave për ngjarje të veçanta për një periudhë kohore jo më shumë se 60 ditë.

Neni 73

Zgjatja e vlefshmërisë së autorizimit individual të përdorimit të frekuencave

(shtuar një fjali në fund të pikës 3 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Me kërkesë të mbajtësit të autorizimit, vlefshmëria e autorizimit mund të shtyhet vetëm në rast se në përfundim të këtij afati janë përmbushur të gjitha kushtet e përdorimit të këtyre frekuencave.
2. Aplikimet për zgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit të frekuencave bëhen jo më pak se 30 ditë

dhe jo më shumë se 90 ditë përpara përfundimit të vlefshmërisë së tij.

3. Në rast shtyrjeje, AKEP-i lëshon një autorizim të ri të përdorimit të frekuencave me një kohëzgjatje jo më të madhe se ajo e autorizimit të mëparshëm. Në rastin e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim, rregullat dhe procedurat e rinovimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

4. Vlefshmëria e autorizimeve të përdorimit të frekuencave, të cilat lëshohen për qëllime kërkimi, matjeje dhe për vënie në provë të pajisjeve të radiokomunikimit, si dhe për ngjarje të veçanta, mund të mos zgjaten.

Neni 74

Transferimi i autorizimit individual

1. Ndalohet transferimi i së drejtës për përdorimin e frekuencës në një sipërmarrës tjetër, në rast se për këtë nuk është dhënë, paraprakisht, miratimi nga AKEP-i. Miratimi mund të jepet vetëm përkundrejt kërkesës me shkrim nga mbajtësi i autorizimit.

2. Pas marrjes së kërkesës për transferim, sipas pikës 1 të këtij neni, AKEP-i duhet të verifikojë, nëse sipërmarrësi, të cilit kërkohet që t'i kalojë e drejta e përdorimit të radiofrekuencës, i përmbush të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe rregullat përkatëse, të zbatueshme nga AKEP-i, si edhe që, nga transferimi i kërkuar, nuk krijohen deformime në konkurrencë dhe nuk dëmtohet përdorimi i rregullt, i sigurt dhe eficient i spektrit të frekuencave.

3. AKEP-i e vlerëson kërkesën për transferim të së drejtës për përdorim të frekuencës edhe në kuadër të rritjes së efikasitetit të përdorimit të spektrit të frekuencave, mbrojtjes së interesit publik dhe transparencës për transferimin.

Neni 75

Ndryshimet në autorizimin individual

(shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i ndryshon autorizimin individual me nismën e vet:

a) kur ka ndryshuar Plani Kombëtar i Frekuencave ose Plani i Përdorimit të Frekuencave, ose rregullat për kushtet e përdorimit të frekuencave;

b) për nevoja publike, që nuk mund të plotësohen në mënyrë tjetër;

c) kur ndryshimi i kërkuar i shërben përdorimit eficient të frekuencave dhe është me interes publik;

ç) kur interferencat e dëmshme nuk mund të shmangen në mënyrë tjetër;

d) kur ndryshimi buron nga aktet ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i lëshon një autorizim individual të ri të përdorimit të frekuencave, i cili përfshin ndryshimet. Në këtë autorizim të ri përfshihet edhe një periudhë e arsyeshme kohe, brenda së cilës mbajtësi i autorizimit duhet të përshtasë përdorimin e frekuencave me autorizimin e ri.

3. Shfuqizuar.

4. Mbajtësi i autorizimit individual përballon me shpenzimet e veta kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme, që burojnë nga ndryshimet në autorizimin e ri individual të përdorimit të frekuencave.

5. Përdoruesit e frekuencave të caktuara, autorizimi i përdorimit të të cilave është ndryshuar, gëzojnë të drejtën që t'u caktohet brez tjetër ekuivalent i frekuencave brenda hapësirave të mundshme, sipas planit të përdorimit të frekuencave, në rast se arsyet për ndryshimin ose revokimin e autorizimit nuk shkaktohen për fajin e tyre.

6. Kur ndryshimet në autorizimin individual të frekuencave kërkohen nga mbajtësi i tij, autorizimi i ri mund të jepet sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe në një mënyrë që të mos shkelë të drejtat e përdoruesve të tjerë.

Neni 76

Revokimi i autorizimit individual

1. AKEP-i revokon autorizimin individual për frekuencë me kërkesën e palës, të cilës i është lëshuar ose me nismën e vet.

2. AKEP-i revokon një autorizim individual për frekuencë me nismën e vet, në rast se vërteton se:

a) aplikimi për autorizim për frekuencë përmban të dhëna të rreme;

b) përfituesi i së drejtës për përdorim nuk i ka përdorur frekuencat e dhëna brenda një viti nga data e dhënies në përdorim, ose i ka përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në autorizim;

- c) janë shkelur dispozitat e këtij ligji ose kushtet e autorizimit individual të frekuencave;
- ç) nuk janë eliminuar, brenda afatit të përcaktuar, mangësitë e evidentuara nga AKEP-i dhe që i janë njoftuar sipërmarrësit;
- d) nuk janë kryer pagesat për përdorimin e frekuencave brenda 30 ditëve nga afati i përcaktuar ose 15 ditë pas njoftimit nga AKEP-i;
- dh) nuk ka mundësi të tjera për të shmangur interferencat e dëmshme, të shkaktuara nga sinjalet e pajisjeve radio, të marrësve ose sistemeve elektrike e elektronike të tjera;
- e) pagesat për vitin, kur autorizimi individual revokohet, nuk janë të rimbursueshme.

Neni 77

Përfundimi i vlefshmërisë së autorizimit individual të frekuencave

(shtuar një fjali në fillim të pikës 2 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Vlefshmëria e autorizimit individual përfundon:
 - a) me mbarimin e afatit kohor, për të cilin është dhënë;
 - b) në rast se mbajtësi i autorizimit nuk ekziston më;
 - c) në rast se mbajtësi i autorizimit nuk arrin të fillojë përdorimin e frekuencave brenda 1 viti nga koha e dhënies së autorizimit, nëse në të nuk është përcaktuar ndryshe.
2. Në rastet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, AKEP-i merr vendim për përfundimin e autorizimit individual të frekuencave.
3. Pagesat e kryera për vitin, kur përfundon autorizimi individual i frekuencave, nuk janë të rimbursueshme.

Neni 78

Pagesat për përdorimin e frekuencave

Për caktimin dhe përdorimin e frekuencave bëhet pagesa, sipas përcaktimeve të nenit 119 të këtij ligji.

KREU VIII

**PAJISJET RADIO DHE PAJISJET FUNDOR
TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

Neni 79

Përdorimi i pajisjeve fundore

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Sipërmarrësit nuk mund të refuzojnë, për arsye teknike, një kërkesë të arsyeshme për lidhjen e një pajisjeje radio ose të një pajisjeje fundore telekomunikacioni, që është në përputhje me kërkesat e rregulloreve për pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve.
2. Përdoruesit nuk mund të lidhin në rrjetin publik të komunikacioneve pajisje radioje ose pajisje fundore telekomunikacioni, që nuk janë në përputhje me kërkesat e rregulloreve për këto pajisje.
3. Rregullat teknike për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

KREU IX

NUMERACIONI, EMRAT DHE ADRESAT

Neni 80

Plani i numeracionit

1. Plani i numeracionit përcakton strukturën, gjatësinë dhe caktimin e numrave për akses në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.
2. AKEP-i administron planin e numeracionit në mënyre që:
 - a) të sigurojë strukturimin dhe përdorimin eficient të numrave dhe serive numerike;
 - b) të kënaqë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave, sipas këtij ligji;

c) të sigurojë që caktimi dhe përdorimi i numrave bëhet në mënyrë të ndershme, transparente dhe jodiskriminuese.

3. AKEP-i ruan të gjitha të dhënat, që lidhen me administrimin e planit të numeracionit.

4. AKEP-i publikon caktimin e numrave dhe të serive numerike, si dhe përdoruesit e tyre në faqen e vet të internetit.

Neni 81

Përdorimi i numrave, i emrave dhe i adresave

1. Numrat dhe seritë numerike përdoren vetëm pas miratimit nga AKEP-i, në përputhje me rregullat përkatëse.

2. AKEP-i harton rregulla edhe për caktimin dhe përdorimin e emrave e të adresave, duke synuar sigurimin e transparencës, ndershmërisë dhe të mosdiskriminimit të përdoruesve të tyre.

Neni 82

Caktimi i numrave

(shtuar një fjali në fund të pikës 1 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike aplikojnë për caktimin e numrave dhe serive numerike. AKEP-i vendos për këto aplikime brenda jo më shumë se tri javëve.

2. Aplikimi duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) emrin, adresën e selisë qendrore dhe dokumentet që vërtetojnë regjistrimin e veprimtarisë;

b) të dhënat për tipin, sasinë dhe qëllimin e përdorimit të numrave ose serive numerike, për të cilat aplikon;

c) planin e vlerësimit të nevojave për 3 vitet e mëvonshme;

ç) datën e planifikuar të fillimit të përdorimit të numrave apo serive numerike të caktuara;

d) të dhëna shtesë që AKEP-i mund të kërkojë, për të administruar përdorimin e numrave.

3. AKEP-i përcakton në mënyrë të hollësishme, me anë të një dokumenti rregullator, përmbajtjen dhe formatin tip të aplikimit dhe kërkesat, që duhet të plotësohen nga aplikuesi.

4. AKEP-i refuzon caktimin e numrave, në rast se:

a) aplikimi përmban të dhëna të rreme;

b) aplikanti nuk është i përshtatshëm për caktimin e numrave apo serive numerike, sipas parashikimeve të këtij ligji;

c) qëllimi i përdorimit nuk justifikon kërkesën për sasinë dhe llojin e numrave të kërkuara.

5. Sipërmarrësit kanë të drejtë të caktojnë numrat apo seritë numerike për përdoruesit e tyre fundorë, brenda numeracionit të caktuar nga AKEP-i.

Neni 83

Kushtet për përdorimin e numrave

1. Mbajtësi i së drejtës së përdorimit të numrave sipas këtij ligji:

a) është i detyruar të kthejë numrat apo seritë numerike të caktuara, në rast se ato nuk janë në përdorim;

b) nuk mund të përdorë numrat dhe seritë numerike, të caktuara për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë dhënë;

c) nuk mund ta transferojë apo t'i japë me qira numrat apo seritë e numrave të caktuara pa miratimin paraprak të AKEP-it;

ç) mund t'i transferojë numrat dhe seritë numerike të caktuara së bashku me veprimtarinë e ushtruar, kur mbajtësi i ri përmbush kërkesat për përdorimin e numrave dhe të serive numerike, në përputhje me vendimin e AKEP-it;

d) është i detyruar të paguajë pagesat për numeracion, sipas përcaktimit të këtij ligji;

dh) duhet të përmbushë kërkesën për transferimin e numeracionit në të gjitha rastet kur kërkohet një gjë e tillë;

e) është i detyruar të përdorë numrat apo seritë e numrave të caktuara vetëm për qëllimin për të cilin i janë dhënë dhe të mos i shkaktojë dëm ndonjë grupi të caktuar përdoruesish;

ë) të përmbushë detyrimet, që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, për caktimin dhe përdorimin e numrave.

Neni 84

**Ndryshimi i vendimeve për caktimin e numrave
dhe të serive numerike**

1. Për përmbushjen e detyrimeve ose të rekomandimeve ndërkombëtare dhe për të siguruar sasi të kënaqshme të numrave, AKEP-i mund të ndryshojë strukturën dhe konfigurimin e hapësirës së numeracionit dhe caktimin e numrave. Ndryshimet miratohen pas këshillimit publik. Në këto raste, mbajtësi i numrave dhe serive numerike nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim.

2. AKEP-i mund të ndryshojë vendimet për caktimin e numrave dhe të serive numerike edhe në bazë të kërkesës së mbajtësit të tyre, kur kjo është e mundur.

Neni 85

Anulimi i vendimeve për caktimin e numrave dhe të blloqeve të numrave

1. AKEP-i mund të heqë të drejtën për përdorim të numrave dhe serive të numrave, në rast se vëren se:

a) mbajtësi i së drejtës për përdorim të numrave dhe serive numerike nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, për caktimin e numrave dhe të serive numerike;

b) mbajtësi i së drejtës për përdorim të numrave dhe serive numerike nuk ka kryer në kohë pagesën vjetore për përdorimin e numrave dhe të serive numerike;

c) mbajtësi i së drejtës për përdorim të numrave dhe serive të numrave nuk ka filluar t'i përdorë ato brenda 3 vjetëve nga data e caktimit të tyre.

Gjithashtu, AKEP-i mund ta heqë të drejtën për përdorim të numrave dhe serive numerike me kërkesë të mbajtësit të së drejtës për përdorimin e numrave apo serive numerike.

2. Për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 1 të këtij neni, AKEP-i njofton heqjen e së drejtës së përdorimit të numrave dhe serive numerike, duke dhënë edhe arsyetimin për këtë vendim.

3. Në rastet kur anulimi është rezultat i moskryerjes së pagesave për numeracion pranë AKEP-it, koha për heqje nuk do të jetë më e vogël se 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit, në referencë me pikën 2 të këtij neni.

4. Kur merret vendim, sipas parashikimeve në pikën 1 të këtij neni, për heqjen e numrave dhe të serive numerike të caktuara, fillimi i zbatimit të këtij vendimi nuk mund të jetë më pak se 60 ditë nga data e marrjes së njoftimit.

5. Heqja e numrave dhe serive numerike i bëhet sipërmarrësit, përkundrejt njoftimit me shkrim, të dërguar nga AKEP-i.

Neni 86

Pagesat për përdorimin e numrave dhe të serive numerike

1. Mbajtësit e të drejtave për përdorimin e numrave dhe të serive numerike paguajnë pranë AKEP-it një pagesë për përdorimin e numrave dhe të serive numerike të caktuara.

2. Kriteret për llogaritjen e pagesave bazohen në llojin, përdorimin dhe gjatësinë e numrave.

3. Pagesa për përdorimin e numrave dhe të serive të numrave të caktuara bëhet për çdo vit në formë paradhënieje, duke filluar nga data e marrjes së vendimit për caktimin e numrave dhe serive numerike.

4. Pagesat për përdorimin e numrave dhe serive numerike bëhen sipas përcaktimeve të nenit 119 të këtij ligji.

Neni 87

Portabiliteti i numrave

(ndryshuar pika 2, ndryshuar fjalë në pikat 5 dhe 6 dhe shtuar pikat 8, 9, 10 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Sipërmarrësit e rrjeteve telefonike publike krijojnë në rrjetet e tyre mundësinë që pajtimtarët të

mbartin numrin e tyre të telefonit, pavarësisht nga sipërmarrësi që u ofron shërbimin telefonik, si më poshtë:

- a) në rastin e numrave gjeografikë – në një rajon të caktuar;
 - b) në rastin e numrave jogjeografikë – në çdo rajon.
2. Parashikimi i pikës 1 të këtij neni zbatohet për të gjithë numrat e Planit të Numeracionit. AKEP-i mund të përcaktojë seri numrash, të cilat nuk janë subjekt i mbartjes së numrit.

3. Numrat telefonikë nuk mbarten nga rrjetet publike telefonike fikse në rrjetet publike telefonike të lëvizshme dhe anasjelltas.

4. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike fikse janë të detyruar të mundësojnë portabilitetin e numrit gjeografik për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata ndryshojnë sipërmarrësin, që u ofron shërbimin publik telefonik fiks.

5. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike të lëvizshme janë të detyruar të mundësojnë portabilitetin e numrit jogjeografik për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata ndryshojnë sipërmarrësin, që u ofron shërbimin publik telefonik të lëvizshëm.

6. Sipërmarrësit mund të ngarkojnë sipërmarrësit e tjerë me një tarifë për portabilitetin e numrit. Tarifat duhet të jenë të orientuara në kosto dhe të mos shërbejnë si faktorë frenues për përdorimin nga pajtimtarët të shërbimit të portabilitetit të numrit.

7. Kostot e përshtatjes dhe të mirëmbajtjes së rrjeteve, në mënyrë që të mundësohet portabiliteti i numrit, përballohen nga sipërmarrësit përkatës.

8. Në rastet e parashikuara në pikën 4 të nenit 56 të këtij ligji, AKEP-i nuk imponon tarifa të pakicës për mbartjen e numrave, përmes caktimit të një tarife të përbashkët ose specifike për përdoruesit fundorë që mund të deformojnë konkurrencën.

9. Mbartja e numrave dhe aktivizimi i tyre bëhen brenda një afati sa më të shkurtër kohor. Në rastet kur pajtimtari ka lidhur kontratë për mbartjen e numrit të një sipërmarrësi i ri, aktivizimi i numrit bëhet brenda një dite pune. Në çdo rast ndërprerja e shërbimit gjatë procesit të mbartjes nuk do të jetë më e gjatë se një ditë.

10. AKEP-i mund të parashikojë, në rregullore, përjashtime nga parimi i përcaktuar në pikën 9 të këtij neni, në raste të justifikuara dhe kur është e nevojshme, në lidhje me procese të veçanta për mbartjen e shumë numrave në të njëjtën kohë.

Neni 88

Zbatimi i portabilitetit të numrit

1. AKEP-i, nëpërmjet një rregulloreje të veçantë, përcakton mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit dhe afatet kohore përkatëse.

2. Në hartimin e rregullores së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i duhet të këtë parasysh:

- a) mundësitë teknike të portabilitetit të numrit;
- b) parametrat teknike, që duhet të sigurohen gjatë portabilitetit të numrit, që të mos sjellë përkeqësim të cilësisë së shërbimit apo të besueshmërisë së rrjetit;
- c) periudha kohore për zbatimin e portabilitetit të numrit nuk duhet të jetë më shumë se 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji;
- ç) provat teknike, që duhen parashikuar për sistemin e propozuar për portabilitetin e numrit.

Neni 89

Numeracioni për shërbimet e thirrjeve të emergjencës

1. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike janë të detyruar t'u sigurojnë përdoruesve të tyre të shërbimit telefonik të disponueshëm për publikun, përfshirë përdoruesve të telefonave publikë me pagesë, dërgimin pa pagesë të thirrjeve drejt numrave të emergjencës.

2. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar të lejojnë thirrjet pa pagesë drejt shërbimeve të emergjencës dhe, nëse është e mundur teknikisht, të sigurojnë identifikimin e numrit thirrës dhe informacion për vendndodhjen e tij.

Neni 90

Numrat jogjeografikë

1. Sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike ose të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar që, kur është e mundur teknikisht dhe ekonomikisht, t'u sigurojnë përdoruesve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, mundësinë të bëjnë thirrje drejt numrave jogjeografikë të caktuar në Republikën e Shqipërisë, sipas planit kombëtar të numeracionit.

2. Sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun nuk janë të detyruar të plotësojnë detyrimin e pikës 1 të këtij neni, në rastet kur pajtimtari i thirrur ka vendosur, për arsye biznesi, të kufizojë thirrjet e origjinuara nga zona të veçanta.

3. Sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të rrjeteve të komunikimeve publike duhet të lejojnë përdorimin e shërbimit publik telefonik nomadik nga përdoruesit e tyre.

KREU X MASAT PËR MBROJTJEN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PUBLIKE

Neni 91

Rrjetet e komunikimeve elektronike publike

Rrjeti i komunikimeve elektronike publike ndërtohet për të mbështetur shërbimet e komunikimeve elektronike publike dhe funksionon si rrjet mbarëkombëtar, pa dallim, për të gjithë përdoruesit, i hapur për të gjithë sipërmarrësit dhe i integruar në rrjetin ndërkombëtar, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Neni 92

Mbrojtja e rrjetit nga dëmtimet

Sipërmarrësi mban dokumentacion të plotë e të saktë për rrjetin e vet. Me kërkesë zyrtare, sipërmarrësit u japin organeve të ngarkuara me ligj për planifikimin urban dhe njëri-tjetrit të dhëna për pjesë të këtij rrjeti, për të shmangur dëmtimin e rrjetit nga punimet nëntokësore apo ndërtimore ose nga ndikimet e mundshme elektrike, që shkakton vënia në punë e pajisjeve të tjera pranë rrjetit të komunikimeve elektronike.

Neni 93

E drejta e përdorimit të pronës publike e private

1. Sipërmarrësi ka të drejtë të përdorë tokë, troje ose objekte në pronësi të shtetit, përfshirë ndërtesat dhe kanalizimet e ndërtuara mbi ose nën to, të drejtat nënujore dhe ato të hapësirës ajrore, rrugët, liqenet, pyjet etj., për vendosjen e pajisjeve të komunikimeve elektronike, si dhe për mirëmbajtjen e tyre.

2. Pronësia ose të drejtat e tjera ndaj pronave të paluajtshme, në rastet kur ato janë me interes të veçantë për ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe infrastrukturës shoqëruese, shpronësohen ose kufizohen sipas procedurave dhe mënyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë ligj.

3. Rrjetet e komunikimeve elektronike publike duhet të planifikohen në mënyrë që të krijojnë sa më pak të jetë e mundur rreziqe dhe shqetësime ndaj pronës private.

4. Para fillimit të punimeve në trojet ose në mjediset me pronësi publike, sipërmarrësit duhet të njoftojnë autoritetet përkatëse dhe të respektojnë të gjitha kërkesat e vendosura nga to. Mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësit dhe autoritetit përkatës zgjidhen nga gjykata.

5. Sipërmarrësi detyrohet të shfrytëzojë pronat e mësipërme, në përputhje me ligjet që mbrojnë mjedisin dhe, me përfundimin e punimeve, kur është objektivisht e mundur, detyrohet ta kthejë mjedisin në gjendjen e mëparshme.

6. Sipërmarrësi përdor tokën, trojet dhe objektet, pronë private, në marrëveshje me pronarët e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Kur nga vendosja ose mirëmbajtja e pajisjeve të komunikimeve elektronike dëmtohet prona ose ndryshon funksioni i saj, sipërmarrësi detyrohet të shpërblejë dëmin, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 94

Detyrimi i sipërmarrësit për mirëmbajtje

1. Sipërmarrësi detyrohet të mbajë pajisjet e komunikimeve elektronike në gjendje të mirë pune, duke respektuar kushtet teknike dhe standardet përkatëse.

2. Gjatë përmbushjes së detyrave për mirëmbajtjen e pajisjeve të komunikimeve elektronike, punonjësit e autorizuar nga sipërmarrësi kanë të drejtë të hyjnë në pronat publike dhe private, për të kryer punimet e nevojshme dhe për të vënë shenja të ndryshme, që tregojnë praninë e objekteve të komunikimeve elektronike.

3. Për të siguruar funksionimin normal të pajisjeve të komunikimeve elektronike, sipërmarrësi ka të drejtë të presë pemët, shkurret, degët e rrënjët, që rrezikojnë pajisjet e mësipërme, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast se pronari privat bëhet pengesë, sipërmarrësi u drejtohet organeve kompetente, të cilat marrin masat e nevojshme brenda 15 ditëve.

Neni 95

Mbrojtja e rrjetit nga dëmtimet e të tretëve

1. Për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të rrjetit ekzistues të komunikimeve elektronike, çdo person fizik ose juridik, që kryen punime ndërtimi e gërmimi, përpara fillimit të punimeve detyrohet të njoftojë sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

2. Në rast se punimet në rrjetin ekzistues të komunikimeve elektronike duhet të kryhen në mënyrë të pashmangshme, të gjitha shpenzimet për mbrojtjen, shmangien ose riparimin e dëmtimeve të këtyre rrjeteve përballohen nga subjekti që kryen punimet.

3. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve zgjidhen nga gjykata.

Neni 96

Detyrime për sipërmarrësit ndërtues

(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

Në rastet e ndërtimit të godinave për qëllime biznesi ose të godinave të banimit, sipërmarrësit ndërtues detyrohen të ndërtojnë infrastrukturën për rrjetin e brendshëm të komunikimeve elektronike.

Neni 97

Standardet e pajisjeve të komunikimeve elektronike

Në rrjetin e komunikimeve elektronike publike mund të vendosen vetëm pajisje, që kanë karakteristika teknike, sipas standardeve të harmonizuara e të miratuara nga organizmat ndërkombëtarë, ku Republika e Shqipërisë aderon.

KREU XI

TË DREJTAT E PËRDORUESVE

Neni 98

Transparenca dhe publikimi i informacionit

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun publikojnë informacion transparent, të krahasueshëm, të përshtatshëm dhe të përditësuar për tarifat dhe çmimet e aplikuara, çdo detyrim në përfundimin e kontratës, si dhe kushtet e përgjithshme për aksesin e përdorimin e shërbimeve të ofruara nga ata për përdoruesit fundorë, në përputhje me pikën 2 të këtij neni. Ky informacion publikohet në mënyrë të qartë, gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të aksesueshme. AKEP-i mund të përcaktojë, me rregullore, kërkesat shtesë lidhur me formën në të cilën këto informacione do të publikohen.

2. AKEP-i mund të vendosë, nëpërmjet një rregulloreje, se çfarë informacioni publikohet nga sipërmarrësi, i cili ofron rrjete të komunikimit publik dhe/ose shërbime telefonike të disponueshme për publikun dhe çfarë informacioni publikohet nga vetë AKEP-i për të garantuar që konsumatorët mund të marrin vendime të mirinformuar.

AKEP-i garanton që publikohet informacioni i mëposhtëm:

a) emrat dhe adresat e sipërmarrësve, të cilët ofrojnë rrjete të komunikimeve publike dhe/ose shërbime telefonike të disponueshme për publikun;

b) fushëveprimi i shërbimit të ofruar dhe gatishmëria gjeografike e shërbimeve;

c) tarifat standarde, të cilat tregojnë shërbimet e ofruara dhe përmbajtjen e secilit element të

tarifave (p.sh. detyrimet për akses, të gjitha llojet e detyrimeve për përdorimin, detyrimet për mirëmbajtje), duke përfshirë detajet e zbritjeve standarde të aplikuara, planet tarifore speciale e të orientuara, çdo detyrim shtesë, si dhe kostot lidhur me pajisjet fundore;

ç) politika e kompensimit/rimbursimit, përfshirë hollësitë specifike të çdo plani të ofruar për kompensim/rimbursim;

d) llojet e ofrara të shërbimit të mirëmbajtjes;

dh) kushtet e përgjithshme, duke përfshirë periudhën minimale kontraktuale, përfundimin e kontratës, procedurat dhe detyrimet e drejtpërdrejta të lidhura me portabilitetin e numrit dhe tregues të tjerë, nëse janë me rëndësi;

e) mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përfshirë ato të zhvilluara nga sipërmarrësit;

ë) informacion për të drejtat lidhur me shërbimin universal, duke përfshirë, nëse është e përshtatshme, facilitetet dhe shërbimet e përmendura pikën 6 të nenit 27 të këtij ligji.

3. AKEP-i inkurajon ofrimin e informacioneve krahasuese për t'u mundësuar përdoruesve fundorë dhe konsumatorëve të bëjnë një vlerësim të pavarur të kostos së përdorimit të modeleve alternative, për shembull, duke përdorur një guidë interaktive ose teknika të ngjashme. Kur këto facilitete nuk janë të disponueshme pa pagesë ose me çmim të arsyeshëm në treg, AKEP-i do t'i vërë vetë në dispozicion këto guida ose teknika. Palët e treta mund të përdorin, pa pagesë, informacionin e publikuar nga sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun, me qëllim të shitjes ose vënies në dispozicion të këtyre guidave ose teknikave të ngjashme.

4. AKEP-i mund të detyrojë sipërmarrësit, të cilët ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, ndërmjet të tjerash:

a) t'u ofrojnë pajtimtarëve informacion për tarifën e aplikueshme për çdo numër ose shërbim, subjekt i kushteve të veçanta të tarifimit. Lidhur me kategoritë individuale të shërbimeve, AKEP-i mund të kërkojë që ky informacion të ofrohet menjëherë para lidhjes së thirrjes;

b) të informojnë pajtimtarët për çdo ndryshim të aksesit në shërbime të emergjencës ose të informacionit për vendndodhjen e numrit thirrës në shërbimin ku janë pajtuar;

c) të informojnë pajtimtarët për çdo ndryshim të kushteve që kufizojnë aksesin në, dhe/ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikimeve dhe ku këto shërbime janë të lejueshme sipas ligjeve në fuqi;

ç) të ofrojnë informacion për çdo procedurë të vendosur nga ofruesi, në mënyrë që të masë dhe drejtojë trafikun, për të evituar ngarkesën ose mbingarkesën e lidhjeve të rrjetit dhe si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit;

d) të informojnë pajtimtarët për të drejtën e tyre për të vendosur për të përfshirë ose jo të dhënat e tyre personale në numërat, si dhe për llojin e të dhënave, në përputhje me nenin 104 të këtij ligji;

dh) të informojnë rregullisht pajtimtarët me aftësi të kufizuara për detajet e produkteve dhe shërbimeve të projektuara për ata.

5. Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit kushtet e përgjithshme të kontratave tip dhe t'ia paraqesin ato AKEP-it për vlerësim, të paktën, 15 ditë para publikimit.

Neni 99

Kontrata e pajtimit

(ndryshuar shkronja "c", "dh", shtuar shkronja "h", të pikës 1 ndryshuar pikat 3, 4, 5 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Sipërmarrësit sigurojnë lidhjen ose aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike, në bazë të kontratës që lidhet me pajtimtarët në zbatim të legjisllacionit në fuqi. Kontrata e pajtimit, në veçanti, duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e sipërmarrësit;

b) identitetin e plotë të pajtimtarit dhe adresën e tij;

c) shërbimet e ofrara, cilësinë e shërbimit të ofruar, si dhe kohën për lidhjen fillestare, duke përfshirë:

i) nëse ofrohet akses në shërbimet e emergjencës dhe informacioni për vendndodhjen e numrit thirrës dhe çdo kufizim në ofrimin e shërbimeve të emergjencës;

ii) informacion për çdo kusht tjetër që kufizon aksesin në, dhe/ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikimeve, ku këto kushte lejohen, sipas këtij ligji;

iii) informacion për çdo procedurë të vendosur nga sipërmarrësi për të matur dhe drejtuar trafikun, në mënyrë që të evitohet ngarkesa ose mbingarkesa e lidhjeve të rrjetit dhe si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit;

iv) çdo kufizim të vendosur nga ofruesi për përdorimin e pajisjeve fundore të ofruara;

v) nivelet minimale të cilësisë së shërbimit të ofruar si koha për lidhje fillestare dhe, kur është e përshtatshme, dhe cilësia e parametra të tjerë, siç përcaktohen nga AKEP-i;

ç) llojin dhe mënyrën e mirëmbajtjes së shërbimeve të ofruara;

d) një informacion të hollësishëm për tarifat, si dhe periudhën kohore për njoftimin e çdo ndryshimi të tyre;

dh) një informacion për hyrjen në fuqi, kohëzgjatjen e kontratës së pajtimtarit, kushtet për shtyrjen dhe përfundimin e kontratës dhe të ofrimit të shërbimeve, duke përfshirë:

i) çdo minimum të përdorimit ose kohëzgjatjes së nevojshme për të përfutur nga kushtet e ofruara promocionale;

ii) çdo detyrim lidhur me mbartjen e numrit dhe tregues të tjerë;

iii) çdo detyrim të papaguar me përfundimin e kontratës, duke përfshirë çdo rimbursim të kostos në lidhje me pajisjet fundore;

e) mënyrat e kompensimit dhe të rimbursimit në rastet kur shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në kontratë;

ë) udhëzime për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;

f) detyrimin për njoftim të përdoruesve për ndryshimet e parashikuara në kushtet e kontratës së pajtimtarit dhe udhëzimet për mënyrën e veprimit për pranimin e kushteve të reja, shtyrjen ose përfundimin e kontratës;

g) mundësinë që të dhënat e përdoruesit të mos publikohen në numërorin telefonik;

gj) procedurat në rast të moskryerjes së pagesës apo të kryerjes me vonesë të pagesave për shërbimet.

h) llojin e veprimit që mund të ndërmerret nga sipërmarrësi si kundërveprim ndaj incidenteve të sigurisë ose integritetit apo për shkak të kërcënimeve dhe cenimeve.

2. Në rast se ofruesit e shërbimeve publike të komunikimeve lidhin kontratë pajtimi me përdoruesit fundorë, këto kontrata duhet të përmbajnë elementet e përshkruara në pikën 1 të këtij neni.

3. Pajtimtarët kanë të drejtë të tërhiqen nga kontrata pa penalitet përkundrejt njoftimit të modifikimit të kushteve kontraktore të propozuara nga sipërmarrësi që ofron rrjete të komunikimit elektronik dhe/ose shërbime. Pajtimtarëve u jepet njoftimi i përshtatshëm, jo më pak se 30 ditë përpara për çdo modifikim dhe informohen në të njëjtën kohë për të drejtën e tyre për t'u tërhequr pa penalitet nga kontrata, nëse ata nuk i pranojnë kushtet e reja. AKEP-i mund të përcaktojë, nëpërmjet një rregulloreje, formatin e këtyre njoftimeve.

Përfundimi i kontratës, për shkak të mospranimit të ndryshimeve, nuk e shmang pajtimarin nga përmblushja e detyrimeve bazë të kontratës së mëparshme.

4. Kontratat e lidhura ndërmjet konsumatorëve dhe sipërmarrësve të shërbimeve të komunikimeve elektronike nuk duhet të detyrojnë lidhjen e kontratës me një afat fillestar prej më shumë se 24 muaj. Sipërmarrësit kanë detyrimin t'u ofrojnë përdoruesve mundësinë e lidhjes së kontratës me afat maksimal 12 muaj. Pavarësisht nga kohëzgjatja minimale e kontratës, kushtet dhe procedurat për përfundimin e kontratës nuk duhet të pengojnë/dekurajojnë pajtimtarin për ndryshimin e ofruesit të shërbimit.

5. Kontrata e pajtimit, që lidhet ndërmjet sipërmarrësit dhe pajtimtarit, bazohet në parimin e barazisë mes palëve. Ajo hartohet nga sipërmarrësit mbi bazën e legjislacionit në fuqi dhe rregullave të nxjerra nga AKEP-i në zbatim të këtij ligji. Një kopje tip e saj, si dhe çdo ndryshim i mëvonshëm që mund të pësojë, i dërgohet AKEP-it 15 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre. AKEP-i ka të drejtë të përcaktojë rregulla shtesë, si dhe të imponojë ndryshime, kur kontratat e pajtimit nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet normative të nxjerra për këtë qëllim, pas kryerjes së një procesi konsultimi, sipas nenit 110 të këtij ligji.

Neni 100

Regjistrimi i pajtimtarëve

1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike detyrohen të bëjnë regjistrimin e pajtimtarëve të tyre, me kontratë pajtimi ose kartë të parapaguar, përpara aktivizimit të shërbimit.

2. Formulari përcaktohet me të dhënat, të cilat janë të detyrueshme të jepen nga pajtimtarët për të mundësuar regjistrimin e tyre, sipas këtij neni, nga AKEP-i.

Ruajtja dhe administrimi i të dhënave për qëllime të ndjekjes penale
(ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Pavarësisht përcaktimeve të tjera në këtë ligj, sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike detyrohen të ruajnë dhe të administrojnë, për një afat 2-vjeçar, skedarët e të dhënave për pajtimtarët e tyre.

2. Skedarët duhet të përmbajnë të dhëna në lidhje me komunikimin zanor dhe me SMS/MMS, që mundësojnë:

- a) identifikimin e pajtimtarëve, duke siguruar marrjen dhe regjistrimin e identitetit të plotë të tyre;
- b) identifikimin e pajisjes fundore, të përdorur gjatë komunikimeve;
- c) përcaktimin e vendndodhjes, datës, kohës, kohëzgjatjes së komunikimit dhe numrit të thirrur dhe thirrës, përfshirë të dhënat për thirrjet pa përgjigje.

3. Në rastin e komunikimeve në internet, skedari duhet të përmbajë:

- a) të dhëna të nevojshme për ndjekjen dhe identifikimin e burimit/origjinimit të komunikimit:
 - i) identitetin e pajtimtarit (user ID) të caktuar;
 - ii) identitetin e pajtimtarit (user ID) dhe numrin e telefonit të caktuar për komunikimet që hyjnë në rrjetin publik telefonik;
 - iii) emrin dhe adresën e pajtimtarit ose përdoruesit të regjistruar, të cilit i është caktuar një adresë IP, identitetin e përdoruesit (user ID), ose numër telefoni i caktuar gjatë kohës së komunikimit;
- b) të dhëna të nevojshme për identifikimin e destinacionit të komunikimit:
 - i) në rastin e telefonisë në internet, identitetin e përdoruesit (user ID) ose numrin e telefonit të numrit të thirrur;
 - ii) në rastin e postës elektronike ose telefonisë në internet, emrin dhe adresën e pajtimtarit ose përdoruesit të regjistruar dhe identitetin e përdoruesit (user ID) të marrësit të synuar të komunikimit;
 - c) të dhëna të nevojshme për identifikimin e datës, kohës dhe kohëzgjatjes së komunikimit:
 - i) datën dhe orën e lidhjes (log in) dhe shkëputjes (log off) të shërbimit të aksesit në internet, sipas orës lokale;
 - ii) adresën IP, duke përcaktuar nëse është dinamike apo statike, të caktuar nga ofruesi i shërbimit internet;
 - iii) identitetin e pajtimtarit ose përdoruesit të regjistruar të shërbimit të aksesit internet.

4. Detyrimi për ruajtjen e të dhënave për thirrjet pa përgjigje, sipas shkonjës “c” të pikës 2, për komunikimet zanore, si dhe detyrimi për të dhënat, sipas nënshkonjës “i” të shkronjës “c” të pikës 3 të këtij neni, për komunikimet në internet, zbatohet për aq sa këto të dhëna krijohen ose përpunohen dhe ruhen nga ofruesi i shërbimeve dhe/ose rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, brenda juridiksionit të tyre gjatë ofrimit të shërbimeve të komunikimeve prej tyre.

5. Të dhënat në këta skedarë ruhen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Këta skedarë duhet t’u vihen në dispozicion pa vonesë, edhe në formë elektronike, autoriteteve që përcakton Kodi i Procedurës Penale, në bazë të kërkesës së tyre.

Shkatërrimi i të dhënave të ruajtura
(shtuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

Operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike janë të detyruar të shkatërrojnë të dhënat e ruajtura, në përfundim të afatit të ruajtjes, kur nuk është parashikuar ndryshe në legjislacionin në fuqi.

Cilësia e shërbimit publik të komunikimeve

1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të publikojnë informacionin e duhur, të krahasueshëm dhe të përditësuar për cilësinë e shërbimeve të ofruara prej tyre.

2. AKEP-i, në bazë të një rregulloreje të veçantë, përcakton treguesit e cilësisë së shërbimit.

Neni 102/1

Garantimi i aksesit të barabartë dhe mundësisë së zgjedhjes për përdoruesit me aftësi të kufizuara
(shtuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i, kur është e përshtatshme, përcakton nëpërmjet një rregulloreje kërkesat që duhet të plotësohen nga sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, për të garantuar që përdoruesit me aftësi të kufizuara:

a) kanë akses në shërbime të komunikimeve elektronike të barabartë me atë të përdorur nga shumica e përdoruesve fundorë;

b) përfitojnë nga zgjedhja e sipërmarrësve dhe shërbimeve në dispozicion të shumicës së përdoruesve fundorë.

2. Në mënyrë që të miratojë dhe implementojë masat e veçanta për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, AKEP-i inkurajon disponueshmërinë e pajisjeve fundore, të cilat ofrojnë shërbimet dhe funksionet e nevojshme për këta përdorues.

Neni 103

Paraqitja e identifikimit të linjës thirrëse (CLI)
(shfuqizuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

Neni 104

Numëratori telefonik dhe informacioni për numrat
(ndryshuar pikat 2 dhe 3 dhe shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Të gjithë pajtimtarët e shërbimeve telefonike publike kanë të drejtën të përfshihen në numërorin telefonik të përgjithshëm.

2. Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar:

a) të informojnë, pa pagesë, të gjithë pajtimtarët para se ata të përfshihen në një numërorator telefonik publik, për qëllimin e numërorit dhe funksionet e disponueshme të kërkit të informacionit;

b) t'u ofrojnë të gjithë pajtimtarëve, pa pagesë, mundësinë për të vendosur nëse të dhënat e tyre personale mund të përfshihen në një numërorator publik, për të përzgjedhur të dhënat që nuk dëshirojnë të përfshihen dhe mundësinë për të verifikuar dhe korrigjuar këto të dhëna;

c) t'u ofrojnë të gjithë pajtimtarëve, pa pagesë, mundësinë e mospërfshirjes së të dhënave të tyre personale ose heqjes së të dhënave nga një numërorator telefonik.

3. Sipërmarrësit janë të detyruar të marrin pëlqimin paraprak të pajtimtarit në rastin e përfshirjes së tyre në numërorin publik. Të gjithë përdoruesit fundorë të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun duhet të kenë akses në cilëndo rubrikë të shërbimeve të informacionit për numërorin telefonik.

4. Shfuqizuar.

5. Sipërmarrësit janë të detyruar të sigurojnë konfidencialitetin e të dhënave të pajtimtarit, përfshirë ruajtjen, përdorimin dhe paraqitjen e të dhënave, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.

Neni 105

Asistenca e operatorit

1. Sipërmarrësit janë të detyruar të organizojnë dhe t'i kenë funksionale shërbimet e asistencës ndaj përdoruesve fundorë, madje të përdorin të gjitha mjetet e mundshme për të informuar përdoruesit fundorë për këto shërbime e për mundësinë e përdorimit të tyre, si edhe për tarifat e mundshme, nëse këto shërbime, tërësisht ose pjesërisht, ofrohen me pagesë.

2. Të gjithë përdoruesit fundorë, që kanë akses në rrjetin e komunikimeve elektronike publike, duhet të kenë akses në shërbimet e asistencës së sipërmarrësit.

Neni 106

Faturimi

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Sipërmarrësit janë të detyruar t'u ofrojnë pa pagesë pajtimtarëve të tyre, për shërbimet telefonike

të vlefshme për publikun, faturë të detajuar, me qëllim që t'u mundësojë kontrollin mbi shumën e faturuar. Pajtimtarët, gjithashtu, kanë të drejtë të marrin faturë jo të detajuar pa pagesë. Në të dyja rastet, sipërmarrësi duhet të sigurojë dërgimin, pa pagesë, të faturës së detajuar ose jo të detajuar, në adresën e pajtimtarit, sipas opsionit të zgjedhur nga pajtimtari.

2. Në faturën e përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të mos përfshihen thirrjet drejt numrave pa pagesë dhe thirrjet drejt numrave të emergjencës.

3. Fatura e detajuar për shërbimet telefonike publike duhet të përfshijë, minimalisht, elementet e mëposhtme:

- a) periudhën e faturimit;
- b) pagesën fikse mujore për shërbimin;
- c) llojin dhe shumën e të gjitha pagesave të tjera të mundshme për periudhën e faturimit;
- ç) numrat e thirrur, datën, kohën, si dhe kohëzgjatjen e bisedave të kryera;
- d) pagesën përkatëse për çdo komunikim të kryer.

Neni 107

E drejta e ankimit

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Mënyra dhe procedura për ankesat e pajtimtarëve përcaktohen në kushtet e kontratës të pajtimtarit.

2. Pajtimtarët kanë të drejtë të ankohen apo të kërkojnë sqarime tek operatori që ofron shërbime të komunikimeve elektronike për kushtet kontraktore dhe/ose përmbushjen e këtyre kushteve nga operatori, përfshirë faturën dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.

3. Në rast se pajtimtari nuk është i kënaqur me sqarimet e dhëna nga operatori nëpërmjet telefonit apo njoftimeve të tjera me mjetet elektronike, ai mund të ankohet me shkrim. Ankesa duhet të paraqitet:

- a) brenda 15 ditëve nga marrja e faturës për shërbimin e ofruar, nëse ankesa i referohet shumës së faturuar për shërbimin e ofruar; ose
- b) brenda 15 ditëve nga ofrimi i shërbimit, nëse ankesa i referohet cilësisë së shërbimit të ofruar.

4. Pas marrjes së ankesës së referuar në pikën 2 të këtij neni, sipërmarrësi duhet të verifikojë shumën e faturuar për shërbimet e ofruara ose për cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe, pas verifikimit, të konfirmojë shumën e faturuar ose ta korrigjojë atë. Sipërmarrësi i dorëzon pajtimtarit përgjigjen, me shkrim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së ankesës nga pajtimtari.

5. Nëse pajtimtari, nuk është dakord me përgjigjen me shkrim të sipërmarrësit, pajtimtari mund të fillojë një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, sipas nenit 120/1 të këtij ligji, ose mund ta paraqesë rastin para gjykatës, sipas Kodit të Procedurës Civile.

Neni 108

Kufizimi ose ndërprerja e aksesit

1. Sipërmarrësit, që ofrojnë akses në rrjetet e komunikimeve elektronike publike, mund ta kufizojnë ose ndërpresin përkohësisht aksesin në shërbimet e tyre, pa miratimin paraprak të përdoruesve, nëse kjo është e nevojshme për përmirësimin, modernizimin, mirëmbajtjen apo për probleme teknike në rrjet.

2. Sipërmarrësit duhet të vënë në dijeni AKEP-in dhe përdoruesit për kufizimet apo ndërprerjet e shërbimit, të cilat do të zgjasin më shumë se 30 min. Ky njoftim bëhet:

- a) të paktën 48 orë më parë, në rast të një përmirësimi, modernizimi ose mirëmbajtjeje të planifikuar të rrjetit;
- b) sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë, pas ndodhjes së kufizimit apo ndërprerjes së shkaktuar nga defekte apo dëmtime të rrjetit.

3. Sipërmarrësit duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që ta bëjnë sa më të shkurtër kohën e kufizimit ose të ndërprerjes.

Neni 109

Ndërprerjet e shërbimit për pajtimtarin

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Sipërmarrësit që ofrojnë akses në rrjetet e komunikimeve elektronike publike mund ta kufizojnë aksesin në shërbimet e tyre dhe/ose mund ta ndërpresin lidhjen e pajtimtarit, apo mund të ndërpresin

kontratën me pajtimtarin vetëm në rast se pajtimtari nuk përmbush kushtet e kontratës, apo nuk kryen pagesat, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

2. Sipërmarrësit duhet të përcaktojnë qartë dhe me detaje në kushtet e kontratës rastet kur bëhet kufizimi, ndërprerja e shërbimit apo ndërprerja e kontratës.

3. Sipërmarrësi është i detyruar t'i dërgojë faturën pajtimtarit me paspagim. Nëse pajtimtari nuk përmbush detyrimet kontraktore brenda afatit kohor të përcaktuar në faturë, sipërmarrësi është i detyruar t'i dërgojë pajtimtarit një njoftim me shkrim ose në një formë tjetër që është parashikuar dhe pranuar në kontratë nga pajtimtari, duke vendosur afatin kohor prej jo më pak se 15 ditëve për të përmbushur detyrimet kontraktore. Ky njoftim me shkrim duhet të informojë pajtimtarin për kushtet përkatëse kontraktore, në veçanti për kufizimin, ndërprerjen e shërbimit apo ndërprerjen e kontratës dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Sipërmarrësit nuk duhet të veprojnë në përputhje me pikën 1 të këtij neni para afatit kohor të përcaktuar në njoftimin me shkrim.

4. Sipërmarrësit nuk janë të detyruar të njoftojnë paraprakisht pajtimtarët për masat e marra, në rast se shkelja e evidentuar e kontratës:

a) shkakton një kërcënim serioz të rendit e sigurisë publike, shëndetit dhe mjedisit;

b) shkakton një dëmtim serioz fizik, material ose funksional të rrjetit.

5. Nëse pajtimtari kundërshton shumën e faturuar, sipërmarrësi mund të mos veprojë sipas pikës 1 të këtij neni, deri në arritjen e një vendimi përfundimtar, kur pajtimtari do të jetë i detyruar të paguajë brenda një afati të caktuar kohor.

6. Nëse është teknikisht e mundur, operatorët janë të detyruar të kufizojnë aksesin vetëm për ato shërbime që pajtimtari ka shkelur kushtet e kontratës, përveç rasteve kur pajtimtari abuzon, ose, në mënyrë të përsëritur, kryen me vonesë ose nuk paguan faturat.

7. Sipërmarrësve u ndalohet të kufizojnë aksesin për përdorimin e numrave të emergjencës.

Neni 110

Këshillimi publik

(shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i, në procesin e përgatitjes së dokumenteve rregullatore për tregun e komunikimeve elektronike dhe përpara marrjes së vendimeve, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, ose që kanë lidhje me të drejtat e përdoruesve fundorë, në veçanti përdoruesit me aftësi të kufizuara, është i detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik.

2. Në procesin e këshillimit publik, AKEP-i publikon dokumentet rregullatore të propozuara dhe kërkon paraqitjen me shkrim të mendimit të palëve të interesuara, brenda një afati kohor të publikuar, i cili nuk duhet të jetë më pak se 30 ditë.

3. Në rast se AKEP-i e gjykon të nevojshme, kryen edhe seancë dëgjimore, ku ftohen palët e interesuara për të parashtuar mendimin për dokumentet rregullatore të propozuara.

4. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni dhe para miratimit të dokumenteve rregullatore, AKEP-i duhet të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit.

KREU XII

KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË RASTE TË VEÇANTA

Neni 111

Masat e jashtëzakonshme për sigurimin e shërbimit

1. Sipërmarrësit detyrohen që, me rrjetet dhe shërbimet, të përballojnë nevojat e shtetit në situatë të jashtëzakonshme dhe kur e kërkojnë interesat e mbrojtjes kombëtare e sigurisë së rendit publik.

2. Sipërmarrësit, që ofrojnë akses në rrjetet e komunikimeve elektronike publike dhe shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun, hartojnë dhe paraqesin në AKEP një plan, për të siguruar integritetin e rrjetit të komunikimeve publike dhe akses në shërbimet e komunikacioneve publike, të zbatueshëm në situatë të jashtëzakonshme. Në kuptim të këtij ligji, me situatë të jashtëzakonshme kuptojmë dëmtimet e rënda të rrjetit, fatkeqësitë natyrore, gjendjen e emergjencës ose gjendjen e luftës.

3. Planet, sipas pikës 2 të këtij neni, sigurojnë akses të pandërprerë dhe përdorimin e numrave të emergjencës.

4. Planet detyrojnë sipërmarrësit të zbatojnë masat emergjente përgjatë gjithë kohëzgjatjes së situatës të jashtëzakonshme.

5. Ministri, në bashkëpunim me strukturat e tjera, të caktuara me ligj për trajtimin e situatave të jashtëzakonshme dhe me AKEP-in, i propozon Këshillit të Ministrave masat, që duhet të përfshihen në planet e masave, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 112

Bashkëpunimi i sipërmarrësve në raste të veçanta

1. Sipërmarrësit detyrohen të bashkëveprojnë ndërmjet tyre dhe me organizatat qeveritare, ndërqeveritare dhe jofitimprurëse për përdorimin e burimeve të komunikimeve elektronike, për lehtësimin dhe përballimin e rasteve të veçanta:

a) duke vendosur pajisje të komunikimit tokësor dhe satelitor për parandalimin, mbikëqyrjen dhe sigurimin e parandalimit të dëmeve natyrore, fatkeqësive në përgjithësi e atyre shëndetësore në veçanti;

b) duke shpërndarë njoftime për shkatërrimet natyrore, fatkeqësitë shëndetësore ndërmjet organizmave të lidhur me to dhe përhapjen e të dhënave në publik, veçanërisht në komunitetet që rrezikohen më tepër;

c) uke vendosur dhe vënë në punë shërbimet e komunikimeve elektronike fleksibël, që përdorin organizatat humanitare.

2. Për lehtësimin e realizimit të masave të mësipërme, sipërmarrësit mund të lidhin marrëveshje të veçanta dhe të vendosin pagesa të veçanta ose të nënshkruajnë shtesa në marrëveshjet ekzistuese.

Neni 113

Sigurimi i shërbimit universal gjatë grevave

Ofruesit e shërbimit universal janë të detyruar të përcaktojnë paraprakisht personelin e tyre, që siguron shërbimin universal të pandërprerë në rast grevash, si edhe për përmbushjen e detyrimeve të sipërmarrësit, në përputhje me parashikimet e nenit 112 të këtij ligji.

KREU XIII

FUKSIONIMI I AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Neni 114

Statusi dhe Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është person juridik, publik, jobuxhetor. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare drejtohet nga Këshilli Drejtues, i cili është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar nga ai vetë.

2. Selia e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare është në Tiranë.

3. Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se 1 herë. Kuvendi cakton kryetarin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kryetari i Këshillit Drejtues është drejtuesi ekzekutiv i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

4. Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë specialistë, me arsim të lartë, të kualifikuar, që kanë, të paktën, 10 vjet përvojë pune dhe të jenë përfaqësues nga sektori i komunikimeve elektronike, postar, i ekonomisë dhe i drejtësisë.

5. Çdo anëtar i Këshillit Drejtues, me emërimin, duhet të japë dorëheqjen nga çdo post ose funksion zyrtar e partiak, të tërhiqet nga çdo veprimtari private fitimprurëse, si dhe të shesë e të shlyejë çdo interes financiar, që mund të ketë në shoqëri, që ushtrojnë veprimtari tregtare nën juridiksionin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Për këto veprime, anëtari informon me shkrim Kuvendin.

6. Nuk mund të zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues:

a) personi, bashkëshorti ose të afërmit deri në shkallë të dytë, që kanë lidhje me anëtarët e Këshillit të Ministrave;

b) personi që është dënuar nga gjykata për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë;

- c) personi, që është debitor, kreditor ose aksionar në një shoqëri, e cila i nënshtrohet kuadrit rregullator të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
- ç) personi, që përjashtohet me ligj për të mbajtur poste publike shtetërore.

Neni 115

Marrja e vendimeve dhe struktura e Këshillit Drejtues
(ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Këshilli Drejtues merr vendimet me shumicë votash, kur janë të pranishëm të paktën tre anëtarë. Secili anëtar, duke përfshirë edhe kryetarin, ka të drejtën e një vote. Asnjë vend mungesë ose vend vakant në Këshillin Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare nuk cenon të drejtën e anëtarëve që mbeten, për të ushtruar të gjitha të drejtat e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

2. Në procesin e votimit nuk marrin pjesë anëtarët e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, kur vërtetohet njëri nga rastet e parashikuara në nenin 37 të Kodit të Procedurës Administrative.

3. Pagat e anëtarëve të Këshillit Drejtues caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Struktura organizative, numri dhe pagat e punonjësve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare përcaktohen, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Këshilli Drejtues vendos rregullat dhe kriteret e punësimit, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 116

Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues
(ndryshuar fjalë në pikat 1 dhe 3 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Anëtar i Këshillit Drejtues lirohet ose shkarkohet nga organi që e ka zgjedhur, me propozim të Këshillit të Ministrave, kur:

- a) është në pamundësi fizike dhe mendore, për të kryer funksionet e ngarkuara;
- b) gjatë ushtrimit të detyrës, është dënuar nga gjykata, për kryerjen e një veprë penale me vendim të formës së prerë;
- c) zgjidhet ose kandidon si deputet i Kuvendit ose në organet e pushtetit vendor, me përjashtim të rastit kur është anëtar i shoqatave profesionale dhe mban funksione në to;
- ç) pa shkak të arsyeshëm, nuk ka pranuar të kryejë ose nuk kryen detyrën ose është i paafët për të ushtruar detyrën për një periudhë 6-mujore ose më shumë;
- d) përfshihet në ndonjërin nga dispozitat e nenit 114 pika 6 të këtij ligji;
- dh) vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Kur një anëtar lirohet ose shkarkohet nga detyra, sipas pikës 1 të këtij neni, anëtar i ri emërohet nga organi përkatës, sipas nenit 114 të këtij ligji.

3. Çdo anëtar i shkarkuar nga detyra nuk ka të drejtë të rizgjidhet në Këshillin Drejtues.

4. Para se të lirohet ose shkarkohet një anëtar i Këshillit Drejtues, atij i jepet mundësia për të parashtruar pretendimet e tij para komisioneve të Kuvendit. Vendimi për të liruar dhe shkarkuar kryetarin, një anëtar ose më shumë se një anëtar duhet të jetë i bazuar në ligj dhe të jetë i arsyetuar për shkaqet që çojnë në lirin ose shkarkimin e tyre. Vendimi i Kuvendit publikohet.

Neni 117

Financimi dhe buxheti i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare
(ndryshuar fjalë në pikën 1, shtuar një paragraf në pikën 2 dhe shtuar një fjali në pikën 3 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Burimet e financimit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare janë pagesat, sipas përcaktimeve në nenet 24, 78 dhe 86 të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

2. Jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të çdo viti financiar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare cakton një fond të shpenzimeve administrative, të parashikuara, të cilin e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave.

Jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i vitit financiar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe

Postare përgatit projektbuxhetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Projektbuxheti i AKEP-it propozohet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave si bashkëpropozim i ministrit me Ministrin e Financave.

3. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit. AKEP-i zbaton rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë e përcaktojnë kufijtë e përdorimit të nivelit të shpenzimeve.

4. Të gjitha të ardhurat e tepërta shpenzimet e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

Neni 118

Publikimi

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Dokumentacioni i arkivuar në AKEP për veprimtarinë e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike është i hapur për publikun, në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit publik dhe legjislacionin përkatës për sekretin tregtar të biznesit.

2. Dokumentacioni i rëndësishëm, si vendimet, kriteret, procedurat për njoftim, dhënien e autorizimit të së drejtës së përdorimit, autorizimet e dhëna, rregullat e rregulloret teknike, standardet etj. publikohen në buletin dhe në faqen elektronike të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Neni 119

Pagesat

(shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Pagesat, që kryhen në AKEP, janë:

a) pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve në nenin 24 të këtij ligji;

b) pagesa për financimin e shërbimit universal, sipas përcaktimeve në nenin 30 të këtij ligji;

c) pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas përcaktimeve në nenin 78 të këtij ligji;

ç) pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike, sipas përcaktimeve në nenin 86 të këtij ligji.

2. Përcaktimi i pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave dhe numrave, të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e AKEP-it.

3. Përcaktimi i pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave e të numrave bëhet në bazë të parimit të proporcionalitetit, transparencës dhe objektivitetit, duke minimizuar shpenzimet administrative shtesë dhe taksat shtesë. Në veçanti:

a) të ardhurat totale vjetore nga pagesat e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni duhet të përputhen me koston administrative vjetore të AKEP-it për administrimin e radiofrekuencave dhe numrave;

b) ndryshimi i pagesave për breza të ndryshëm të frekuencave ose për kategoritë e ndryshme të numrave duhet të përputhet me ndryshimin në koston administrative për administrimin e këtyre brezave dhe kategoritë e ndryshme të numrave.

4. AKEP-i, në zbatim të parimit të transparencës, çdo vit publikon, në faqen e tij zyrtare, një përmbledhje të situatës financiare, duke dhënë kostot administrative/shpenzimet dhe të ardhurat totale të krijuara respektivisht nga pagesat për mbikëqyrjen e tregut, pagesat për numeracionin dhe ato për frekuencat. AKEP-i, gjithashtu, publikon bilancin financiar vjetor që depoziton në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim.

KREU XIV

MOSMARRËVESHJET

Neni 120

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve
(ndryshuar titulli me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të

komunikimeve elektronike, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij.

2. Në rastet referuar pikës 1 të këtij neni, AKEP-i fillon një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me marrjen e kërkesës nga cilado palë në mosmarrëveshje.

3. Në procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, AKEP-i zbaton Kodin e Procedurës Administrative, për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj.

4. Në marrjen e vendimeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, AKEP-i mban parasysh përmbushjen e objektivave rregullatorë për nxitjen e konkurrencës dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve, sipas parashikimeve në këtë ligj.

5. AKEP-i është i detyruar të publikojë të gjitha vendimet që merr për mosmarrëveshjet, duke pasur parasysh ruajtjen e sekretit tregtar të palëve në mosmarrëveshje.

Neni 120/1

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve

(shtuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Nëse një mosmarrëveshje mes një pajtimtari dhe një sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimit publik nuk mund të zgjidhet nëpërmjet procedurave për trajtimin e ankesave, sipas nenit 107 të këtij ligji, pajtimtari mund të kërkojë nga AKEP-i të zgjidhë mosmarrëveshjen.

2. Kërkesa e pajtimtarit, referuar në pikën 1 të këtij neni, paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë fakte dhe prova, në të cilat është bazuar. Kërkesa duhet të paraqitet brenda 15 ditëve pasi pajtimtari të ketë marrë nga sipërmarrësi përgjigjen me shkrim, të referuar në nenin 107 pika 4 të këtij ligji.

3. AKEP-i zgjidh mosmarrëveshjet në mënyrë transparente, të shpejtë, objektive dhe jodiskriminuese brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës.

4. Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike duhet të marrin pjesë në procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve e të bashkëpunojnë me AKEP-in, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes, dhe t'i paraqesin këtij të fundit të gjitha të dhënat e nevojshme.

5. Kur AKEP-i të ketë shqyrtuar të gjitha provat në dispozicion, i paraqet pajtimtarit dhe sipërmarrësit një rekomandim, me shkrim, si duhet zgjidhur mosmarrëveshja. Nëse të dyja palët, pajtimtari dhe sipërmarrësi, pranojnë, me shkrim, rekomandimin brenda 15 ditëve, ai bëhet i detyrueshëm. Në rast të kundërt, secila palë mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

6. AKEP-i përcakton procedurat dhe strukturën përkatëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me anë të një rregulloreje. Procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjes pranë AKEP-it është pa pagesë.

7. Kur AKEP-i konstaton se një çështje e caktuar është subjekt i shumë kërkesave për zgjidhje të mosmarrëveshjeve me një sipërmarrës të caktuar, ekzaminon nëse procedura për trajtimin e ankesave, sipas nenit 107 të këtij ligji, zbatohet në mënyrë të duhur nga sipërmarrësi. Nëse është e nevojshme, AKEP-i detyron sipërmarrësin të përmirësojë procedurat për trajtimin e ankesave.

KREU XV

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE E PRIVATËSISË

Neni 121

Ruajtja e fshehtësisë

1. Sipërmarrësit duhet të marrin masa ndaj sistemeve të komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave, për të mbrojtur sekretin e komunikimeve elektronike dhe të të dhënave vetjake, si dhe për të ndaluar aksesin e paautorizuar në sistemet e komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave.

2. Sipërmarrësi, të autorizuarit dhe punonjësit e tij detyrohen të ruajnë e të mbrojnë të dhënat dhe fshehtësinë e komunikimeve, që kryhen nëpërmjet rrjetit e shërbimeve të tij gjatë gjithë periudhës së kryerjes së veprimtarisë, por dhe pas përfundimit të saj.

3. Sipërmarrësi mund të marrë dijeni për mesazhe ose të dhëna të transmetuara nëpërmjet rrjetit të tij, vetëm në masën që i nevojitet për të kryer detyrën në sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

4. Ndalohe marrja, regjistrimi, publikimi dhe përdorimi i të dhënave dhe i mesazheve të transmetuara nga rrjeti i komunikimeve elektronike dhe që nuk janë për publikun, si dhe dhënia e tyre personave të paaautorizuar, për sa kohë që nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin në fuqi.

Neni 122

Masat mbrojtëse

(shtuar një fjali në pikën 1, shtuar një paragraf në pikën 2 dhe shtuar pikat 4-13 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar që, individualisht ose kur është e nevojshme, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, të zbatojnë masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve, të ofruara prej tyre. Në mënyrë të veçantë duhet të merren masa për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin e aksidenteve të sigurisë mbi përdoruesit e rrjeteve të ndërlidhura.

2. Këto masa duhet të sigurojnë një nivel të mbrojtjes dhe sigurisë së përshtatshme ndaj rreziqeve të mundshme, të parashikuara.

Masat duhet që, të paktën:

a) të sigurojnë që të dhënat personale të jenë të aksesueshme vetëm nga personeli i autorizuar për qëllime ligjore të autorizuara;

b) të mbrojnë të dhënat personale të ruajtura ose të transmetuara nga aksidentet apo nga shkatërrimi i kundërligjshëm, humbja ose ndryshimi aksidental dhe ruajtja, përpunimi, aksesimi apo zbulimi i paaautorizuar ose i jashtëligjshëm;

c) të sigurojnë implementimin e politikave të sigurisë, lidhur me përpunimin e të dhënave personale.

3. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të informojnë përdoruesit e tyre për një rrezik të veçantë, në mënyrë se si rreziku mund të reduktohet nga përdoruesit, si dhe kostot e mundshme, që duhet të mbulohen nga përdoruesi, nëse rreziku që ndodh është jashtë masave, që mund të marrë sipërmarrësi.

4. Në rast të cenimit të të dhënave personale, sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun njofton pa vonesë AKEP-in për këtë shkelje.

5. Kur një shkelje e të dhënave personale mund të ndikojë për keq në të dhënat personale dhe privatësinë e pajtimtarit ose individit, sipërmarrësi, gjithashtu, njofton pa vonesë pajtimtarin ose individin për shkeljen.

6. Nëse sipërmarrësi i ka vërtetuar AKEP-it që i ka zbatuar masat e nevojshme mbrojtëse teknologjike dhe këto masa janë aplikuar për të dhënat përkatëse, atëherë nuk kërkohet nga sipërmarrësi të njoftojë pajtimtarin ose individin për shkeljen e të dhënave personale. Këto masa mbrojtëse teknologjike i bëjnë këto të dhëna të palexueshme për çdo person që nuk ka akses të autorizuar në këto të dhëna.

7. Pa paragjykim ndaj detyrimit të sipërmarrësit për të njoftuar pajtimtarët dhe individët në fjalë, nëse sipërmarrësi nuk e ka njoftuar pajtimtarin ose individin për shkelje të të dhënave personale, AKEP-i, pasi të ketë marrë parasysh ndikimin për keq të shkeljes, mund të kërkojë që sipërmarrësi të njoftojë pajtimtarin.

8. Njoftimi i pajtimtarit ose individit përshkruan, të paktën, natyrën e shkeljes së të dhënave personale dhe personin e kontaktit ku mund të merret informacion më i detajuar, si dhe rekomandon masa për të minimizuar efektet e mundshme të këqija të shkeljes së të dhënave personale. Njoftimi për AKEP-in, përveç kësaj, përshkruan pasojat dhe masat e propozuara ose të ndërmarra nga ofruesi për shkeljen e të dhënave personale.

9. Sipërmarrësit mbajnë një inventar të shkeljeve të të dhënave personale, që përmban fakte lidhur me këto shkelje, ndikimin e tyre dhe masat e ndërmarra rregullatore, të mjaftueshme për t'u mundësuar autoriteteve kompetente kombëtare verifikimin e përpunimit me përcaktimet e pikës 3. Ky inventar përfshin vetëm informacion të nevojshëm për këtë qëllim.

10. AKEP-i mund të përcaktojë me hollësi detyrimet e pikave 1 deri në 9 të këtij neni me anë të një rregulloreje. Në veçanti AKEP-i mund të kërkojë që sipërmarrësit:

a) të ofrojnë informacion të nevojshëm për të vlerësuar sigurinë dhe/ose integritetin e shërbimeve dhe rrjeteve, duke përfshirë politika të dokumentuara të sigurisë;

b) t'i paraqesin auditit të sigurisë, të kryer nga një organ i certifikuar dhe i pavarur ose nga një autoritet kompetent, rezultatet dhe në këtë mënyrë t'i vënë ato në dispozicion të AKEP-it. Kostoja e auditit do të paguhet nga sipërmarrësi.

11. Në rast të shkeljes së sigurisë ose kur audit i sigurisë zbulon masa jo të mjaftueshme të

sigurisë, AKEP-i me një vendim i detyron sipërmarrësit të zbatojnë masat e nevojshme të sigurisë. AKEP-i mund të përcaktojë kërkesat minimale për masat që duhet të merren dhe afatet kohore për zbatimin e tyre.

12. AKEP-i mund të informojë vetë publikun ose të kërkojë nga sipërmarrësi që ta njoftojë atë, nëse vlerëson që bërja publike e kësaj shkeljeje është në interes të publikut.

13. AKEP-i mund të shkëmbejë informacion për shkeljet e sigurisë me Komisionin Europian dhe Agjencinë Europiane për Sigurinë e Rrjeteve dhe të Informacionit (ENISA), si dhe me autoritetet kompetente në vendet e tjera, në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave për transferimin ndërkombëtar.

Neni 123

Konfidencialiteti i komunikimit

(ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Konfidencialiteti i komunikimit përfshin:

- a) përmbajtjen e komunikimit;
- b) të dhënat e trafikut dhe të vendndodhjes në lidhje me komunikimet;
- c) të dhëna për përpjekjet e pasuksesshme për vendosjen e lidhjes.

2. Janë të ndaluara të gjitha format e mbikëqyrjes, përgjimit, ndërprerjes, regjistrimit, ruajtjes, transferimit dhe devijimit të komunikimeve, si dhe të dhënat, referuar pikës 1 të këtij neni, përveç rasteve kur kjo është e nevojshme për përcjelljen e mesazheve, të faksit, të postës elektronike, të sekretarisë telefonike, mesazheve zanore, mesazheve të shkurtra apo për rastet e parashikuara me ligj.

3. Nëse sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike kanë nevojë të marrin informacion për përmbajtjen e komunikimeve ose të kopjojnë apo të ruajnë komunikimet e të dhënat e trafikut, ata janë të detyruar të informojnë pajtimtarin në momentin e nënshkrimit të kontratës ose me fillimin e ofrimit të shërbimit të komunikimeve. Kur informacioni ose përmbajtja e komunikimit nuk është më e nevojshme për ofrimin e shërbimit specifik të komunikimeve publike, duhet ta fshijnë atë sa më shpejt që të jetë e mundur teknikisht.

4. Pajtimtarët ose përdoruesit mund të regjistrojnë komunikimet, por ata janë të detyruar të informojnë dërguesin apo marrësin e komunikimit për regjistrimin ose të përshtatin funksionimin e pajisjes regjistruese, në mënyrë që dërguesi apo marrësi i komunikimit të jetë i informuar për funksionimin e saj dhe kryerjen e regjistrimit.

5. Regjistrimi i komunikimeve dhe i të dhënave shoqëruese të trafikut lejohet me qëllim sigurimin e evidencës së transaksioneve në treg ose të ndonjë komunikimi tjetër biznesi, apo brenda strukturave të ngarkuara me ligj për marrjen e thirrjeve të emergjencës, me qëllim regjistrimin, identifikimin dhe zgjidhjen e tyre.

6. Përdorimi i rrjeteve të komunikimit elektronik për ruajtjen e të dhënave apo për marrjen e aksesit në të dhënat e ruajtura në pajisjet fundore të pajtimtarit ose të përdoruesit për përpunim të mëtejshëm lejohet vetëm në rastet kur pajtimtari ose përdoruesi në fjalë ka dhënë pëlqimin, duke i ofruar informacion të qartë dhe të kuptueshëm për qëllimin e përpunimit, sipas kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo nuk parandalon çdo ruajtje teknike ose aksesin vetëm për qëllim të transmetimit të një komunikimi nëpërmjet një rrjeti të komunikimeve elektronike, ose kur kjo është e domosdoshme që një ofrues i shërbimit të shoqërisë së informacionit të ofrojë shërbimin e kërkuar në mënyrë të qartë nga pajtimtari.

7. Ruajtja e të dhënave ose aksesit në të dhënat lejohet vetëm për përshpejtimin e transmetimit të mesazhit në një rrjet të komunikimeve elektronike, ose nëse kjo është e domosdoshme, për ofrimin e një shërbimi të shoqërisë së informacionit, të cilin pajtimtari ose përdoruesi e ka kërkuar paraprakisht dhe në mënyrë të qartë.

Neni 124

Të dhëna për trafikun e komunikimit

1. Të dhënat e trafikut të pajtimtarit dhe përdoruesit, të përpunuara apo të ruajtura nga një operator i rrjetit të komunikimit publik ose një ofrues i shërbimeve publike të komunikimit, duhet të fshihen ose të bëhen të paidentifikueshme sapo të mos jenë më të nevojshme për transferimin e mesazhit.

2. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit mund të ruajnë dhe të përpunojnë të dhënat e trafikut, të nevojshme për faturim dhe pagesat e interkoneksionit deri në përfundimin e pagesave.

3. Ofruesit e shërbimit publik të komunikimeve, për qëllime marketingu të shërbimeve të komunikimeve elektronike ose për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar, mund të përpunojnë të dhëna të trafikut vetëm pas pranimit paraprak nga pajtimtari ose përdoruesit. Pajtimtarët ose përdoruesit duhet të jenë informuar për llojin e të dhënave të trafikut që përpunohet, para se të japin miratimin për përpunimin e tyre. Pajtimtarët dhe përdoruesit kanë të drejtën të tërhiqen në çdo kohë nga miratimi që kanë bërë.

4. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit janë të detyruar të përcaktojnë në kontratë mënyrën e ruajtjes, kohëzgjatjen, mënyrën e përpunimit të të dhënave të trafikut dhe të deklarojnë se do t'i ruajnë këto informacione, në përputhje me këtë ligj.

5. Të dhënat e trafikut mund të përpunohen vetëm nga personat përgjegjës, të autorizuar nga operatorët dhe ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve publike të komunikimit, të cilët janë përgjegjës për faturimin ose menaxhimin e trafikut, shërbimin me klientin, marketingun e shërbimeve të komunikimit elektronik, dedektimin e mashtrimeve, ose ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar, ndërkohë që përpunimi, detyrimisht, duhet të kufizohet vetëm për zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

6. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit janë të detyruar t'i japin AKEP-it, për zhvillimin e veprimtarive të parashikuara nga ky ligj, të dhëna për trafikun, pas një kërkesë paraprake.

Neni 125

Identifikimi i linjës thirrëse dhe të thirrur

1. Operatorët ose ofruesit e rrjeteve publike të komunikimit, që ofrojnë identifikimin e linjës thirrëse, janë të detyruar t'i mundësojnë dërguesit të thirrjes që, para çdo thirrjeje, të ketë mundësi të fshehtë identifikimin e thirrjes së tij, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë. Ofruesit e shërbimeve publike të komunikimeve detyrohen të sigurojnë për pajtimtarët e tyre parandalimin e identifikimit të të gjitha thirrjeve në linjat e tyre, në mënyrë automatike dhe pa pagesë.

2. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit nuk do të respektojnë detyrimet, që rrjedhin nga pika 1 e këtij neni, vetëm për thirrjet drejt shërbimeve të emergjencës.

3. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit, që ofrojnë identifikimin e thirrjeve, janë të detyruar t'i mundësojnë marrësit të thirrjeve të mos identifikojë dërguesin e thirrjeve, përpara çdo thirrjeje, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë.

4. Në rast se operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit ofrojnë identifikimin e linjës së thirrur dhe identifikimi është i mundur para se të fillojë komunikimi, pajtimtari i thirrur duhet të ketë mundësi që, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë, të refuzojë të gjitha thirrjet hyrëse, për të cilat dërguesi i thirrjes ka parandaluar identifikimin e linjës thirrëse.

5. Nëse një operator ose ofrues i shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit ofron identifikimin e linjës thirrëse, ai është i detyruar t'i mundësojë përdoruesit të thirrur të përdorë parandalimin e identifikimit të linjës së lidhur me përdoruesin thirrës, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë.

6. Në rast se një pajtimtar kërkon me shkrim që operatori të gjurmtojë thirrjet keqdashëse, operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit mund që përkohësisht të regjistrojnë origjinën e të gjitha thirrjeve që përfundojnë në pajisjen fundore të pajtimtarit, përfshirë edhe ato për të cilat ka pasur një kërkesë për fshehjen e identifikimit.

7. Të dhënat për gjurmimin duhet të ruhen dhe trajtimi i mëtejshëm i tyre nga sipërmarrësi duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit janë të detyruar, që në kushtet e përgjithshme të kontratës së pajtimtarit, të parashikojnë mundësinë e paraqitjes dhe të parandalimit të identifikimit të linjës së thirrur dhe asaj thirrëse.

9. Parashikimet e këtij neni zbatohen për linjat e pajtimtarëve të lidhur me centrale numerike dhe me centrale analoge vetëm nëse këto kërkesa janë teknikisht të mundshme dhe nëse nuk shkaktjnë kosto të pajustifikuara.

Neni 126

Të dhëna për vendndodhjen

1. Të dhënat për vendndodhjen, përveç të dhënave të tjera të trafikut të pajtimtarit apo përdoruesit, mund të përpunohen vetëm në një formë anonime ose pasi pajtimtari apo përdoruesi të ketë rënë dakord, por vetëm gjatë kohëzgjatjes së ofrimit të shërbimit me vlerë të shtuar.

2. Përdoruesit ose pajtimtarët mund të tërhiqen në çdo kohë nga miratimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Përdoruesit dhe pajtimtarët, përpara se të japin miratimin për përpunimin e të dhënave, duhet të jenë të informuar për:

- a) llojin e të dhënave, që do të përpunohen;
- b) qëllimet dhe kohëzgjatjen e përpunimit;
- c) mundësinë që të dhënat për vendndodhjen e tyre t'u transferohen palëve të treta, për ofrimin e shërbimit me vlerë të shtuar.

4. Përdoruesit dhe pajtimtarët, që kanë pranuar përpunimin e të dhënave të vendndodhjes së tyre, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të kenë mundësi që, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë, të refuzojnë përpunimin e këtyre të dhënave për çdo lidhje me rrjetin ose çdo transmetim komunikimi.

5. Të dhënat e vendndodhjes, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të përpunohen vetëm nga personat përgjegjës të punësuar në operatorin ose ofruesin e shërbimit publik të komunikimeve ose në palët e treta, që ofrojnë shërbime me vlerë të shtuar, por duhet të kufizohen vetëm kur janë të nevojshme për ofrimin e shërbimit me vlerë të shtuar.

6. Nëse është e mundur teknikisht, operatorët janë të detyruar t'u ofrojnë të dhëna për vendndodhjen për shërbimet e numrave të emergjencës organeve kompetente për shërbimet e emergjencës.

Neni 127

Ridrejtimi automatik i thirrjeve

1. Pajtimtari duhet të ketë mundësinë që, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë, të ndalojë automatikisht thirrjet e ridrejtuar nga një palë e tretë në drejtim të pajisjes së tij fundore.

2. Parashikimi i pikës 1 të këtij neni zbatohet vetëm nëse implementimi i saj është teknikisht i mundur ose nuk shkakton kosto të paarsyeshme.

Neni 128

Komunikimet pa kërkesë

(ndryshuar fjalë në pikat 1 dhe 2 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Përdorimi i sistemeve të thirrjeve automatike për dërgimin e thirrjeve drejt pajtimtarëve telefonikë pa ndërhyrjen njerëzore (p.sh. faks ose postë elektronike), me qëllime marketingu mund të lejohet vetëm pas miratimit paraprak të pajtimtarëve i cili mund të revokohet në çdo kohë.

2. Personat fizikë ose juridikë, që kanë adresat e postës elektronike nga klientët e produkteve ose shërbimeve të tyre, mund t'i përdorin këto adresa për marketing të drejtpërdrejtë të produkteve apo shërbimeve të ngjashme, por janë të detyruar t'u japin klientëve të tyre mundësinë që, në çdo kohë, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë, të kenë mundësi të ndalojnë përdorimin, për qëllime marketingu, të postës së tyre elektronike.

3. Ndalohej dërgimi i një mesazhi me SMS ose nëpërmjet postës elektronike për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, kur në të është fshehur identiteti i dërguesit ose kur mungon një adresë e vlefshme, tek e cila marrësi mund të kërkojë ndalimin e këtyre komunikimeve.

Neni 129

Të dhënat e pajtimtarit

1. Operatorët mund të marrin për pajtimtarët e tyre të dhënat e mëposhtme:
- a) emrin ose titullin e pajtimtarit;
 - b) numrin identifikues të personit fizik dhe numrin e regjistrimit të personit juridik;
 - c) veprimtarinë, që ushtron pajtimtari me kërkesë të tij;
 - ç) adresën e pajtimtarit;
 - d) numrin e pajtimtarit;
 - dh) me kërkesën e pajtimtarit mund të përfshihet titulli akademik pas emrit të pajtimtarit;
 - e) në bazë të pagesës, të dhëna shtesë, në qoftë se pajtimtari dëshiron, duke u siguruar se nuk shkelen të drejtat e palëve të treta;
 - ë) korrektesën e pagesës.

2. Të dhënat e përmendura në pikën 1 të këtij neni mund të përdoren vetëm për:

- a) nënshkrimin, monitorimin dhe përfundimin e kontratës së pajtimtarit;
- b) faturimin e shërbimeve;

c) përgatitjen dhe botimin e numërorit të pajtimtarit, në përputhje me këtë ligj.

3. Në përfundimin e pajtimtarit/kontratës, të dhënat e pikës 1 të këtij neni duhet të ruhen jo më pak se një vit nga data e lëshimit të faturës së fundit për shërbimet e ofruara dhe, nëse gjatë këtij afati kohor nga organet kompetente është lëshuar një urdhër për ruajtjen dhe transferimin e këtyre të dhënave, ato ruhen për periudhën e përcaktuar në urdhrin e dhënë nga organet kompetente.

Neni 130
Numërori
(shfuqizuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

Neni 131
Përgjimi i ligjshëm i komunikimeve

Përgjimi i ligjshëm i komunikimeve elektronike bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të përmbushin detyrimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU XVI
**INSPEKTIMI, MONITORIMI I SPEKTRIT TË FREKUENCAVE
DHE MASAT ADMINISTRATIVE**

Neni 132
Inspektimi

1. Inspektimi i veprimtarisë së sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo personi tjetër fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, kryhet nga inspektorët e AKEP-it.

2. Inspektorët e AKEP-it pajisen me dokument të posaçëm identifikimi. Ata kryejnë inspektim në mjediset, ku sipërmarrësi zhvillon veprimtarinë edhe pa e njoftuar paraprakisht, për të verifikuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave përkatëse, të nxjerra në zbatim të tij.

3. Sipërmarrësi ose çdo person tjetër, fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, është i detyruar t'i lejojë inspektorët të kryejnë inspektimin kudo ku ka pajisje të komunikimeve elektronike, si dhe t'i ofrojnë inspektorëve të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar prej tyre.

4. Kur nevojitet ekspertizë e veçantë, inspektori mund të kërkojë ekspert.

Neni 133
Monitorimi i spektrit të frekuencave

1. AKEP-i monitoron spektrin e frekuencave të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave me qëllim që:

a) përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit;

b) spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të këtij ligji;

c) të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike.

2. AKEP-i bashkëpunon për monitorimin e frekuencave, nëse një kërkesë e tillë vjen nga institucionet e tjera, të ngarkuara nga ky ligj për administrimin e spektrit të frekuencave.

3. Monitorimi i frekuencave bëhet në përputhje me rregulloren përkatëse, të hartuar nga AKEP-i.

4. Monitorimi i frekuencave mund të bëhet edhe me kërkesë të subjekteve, të cilat zotërojnë një autorizim të lëshuar nga AKEP-i.

Neni 134
Bllokimi i pajisjeve dhe ndalimi i funksionimit të tyre

1. Kur një person fizik apo juridik zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, i paautorizuar nga AKEP-i, inspektorët bllokojnë pajisjet.

2. Pajisjet e bllokuara inventarizohen dhe sekuestrohen. Me kalimin e afatit 1-mujor nga data e bllokimit, nëse nuk është bërë ankim nga sipërmarrësi, pajisjet u jepen për shitje subjekteve të ngarkuara me ligj. Pjesa e të ardhurave nga shitja, që rregullohet me kontratën përkatëse ndërmjet AKEP-it dhe subjektit të mësipërm, kalon në Buxhetin e Shtetit.

3. Kur inspektorët zbulojnë se pajisjet radio të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike shkaktojnë interferenca të dëmshme, pavarësisht se për përdorimin e tyre është marrë autorizimi përkatës, kanë të drejtë të bëjnë ndalimin e funksionimit të tyre.

4. Bllokimi dhe ndalimi i funksionimit të pajisjeve, sipas këtij neni, tregohet me një vulë, përmbajtja dhe forma e të cilës përcaktohen nga AKEP-i.

5. Përkundrejt kërkesës me shkrim të sipërmarrësit, drejtuar AKEP-it, inspektori bën verifikimin e nevojshëm dhe, nëse vëren se interferencat e dëmshme janë shmangur, lejon funksionimin e mëtejshëm të pajisjes së ndaluar, sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Për zbatimin e detyrave, që burojnë nga nenet 132, 133 e 134 të këtij ligji, AKEP-i bashkëpunon me autoritetet publike vendore dhe ato policore.

Neni 135

Kundërvajtjet administrative

(ndryshuar pika 1 dhe referenca në pikën 3 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Kur inspektorët e AKEP-it vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo person tjetër fizik a juridik, që ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, ka shkelur këtë ligj dhe rregulloret e miratuara:

a) i propozojnë Këshillit Drejtues të AKEP-it masën e gjobës, sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët I deri në IV të tij, dhe masat për ndreqjen e shkeljes së konstatuar;

b) vendosin gjobë, sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët V deri në VIII të tij dhe kërkojnë marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur një afat për realizimin e saj.

2. Kur inspektorët e AKEP-it vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, ka shkelur këtë ligj dhe rregulloret e miratuara, përveç sa është përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kanë të drejtë:

a) t'i propozojnë Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare heqjen e së drejtës së përdorimit të frekuencave/numeracionit;

b) t'i propozojnë Këshillit Drejtues heqjen e së drejtës së ofrimit të shërbimeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

3. Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, pasi shqyrton propozimin e inspektorëve në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 dhe shkronjat “a” e “b” të pikës 2 të këtij neni, vendos:

a) të paralajmërojë sipërmarrësin me shkrim, duke përcaktuar shkeljen e bërë;

b) të miratojë propozimin e inspektorëve.

4. Para marrjes së vendimit, Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare thërret në seancë dëgjimore sipërmarrësin, për t'i dhënë mundësi të japë shpjegime. AKEP-i merr vendim në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative.

Neni 136

Ankimi

(ndryshuar fjalia e parë e pikës 1 me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Kundër gjobës së vendosur, sipas këtij ligji, bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP-it brenda 10 ditëve nga data e dhënies së saj. Këshilli Drejtues merr vendim brenda 30 ditëve nga data e ankimit. Kundër vendimit të këshillit drejtues të AKEP-it mund të bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit në gjykatën e rrethit, ku është kryer kundërvajtja.

2. Kundër vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP-it, sipas pikës 3 të nenit 134 të këtij ligji, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, brenda 30 ditësh nga marrja e vendimit.

Neni 137

Gjobat

(ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:

I. Me gjobë në vlerën nga 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) deri në 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, për shkeljet e mëposhtme të kryera nga personi juridik:

1. Nuk ka njoftuar paraprakisht AKEP-in për fillimin e punimeve dhe përdorimin e rrjeteve apo shërbimeve publike të komunikimit, sipas nenit 14 të këtij ligji;

2. Nuk ka krijuar një person juridik të veçantë, ose nuk ka ndarë llogaritë financiare të të ardhurave nëse përdor rrjete apo shërbime publike komunikimi për vetveten, me qëllim ofrimin e shërbimit publik të komunikimit, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji;

3. Nuk siguron shërbimin universal sipas kërkesave të nenit 25 të këtij ligji;

4. Nuk zbaton detyrimin për transparencë sipas nenit 40 të këtij ligji;

5. Nuk zbaton detyrimin për mosdiskriminim sipas nenit 39 të këtij ligji;

6. Nuk zbaton detyrimin për mbajtjen e llogarive të ndara sipas nenit 41 të këtij ligji;

7. Nuk zbaton detyrimet, që lidhen me kontrollin e tarifave ose llogaritjen e kostos, sipas neneve 45 dhe 59 të këtij ligji;

8. Nuk zbaton vendimin e AKEP-it për rregullimin e tarifave, sipas nenit 58 të këtij ligji;

9. Nuk zbaton vendimin e AKEP-it për lidhjen e marrëveshjes për akses dhe intekoneksion, sipas nenit 60 të këtij ligji;

10. Nuk zbaton detyrimet e imponuara, që lidhen me sigurimin e një minimumi linjash me qira, sipas nenit 44 të këtij ligji;

11. Nuk zbaton detyrimet e imponuara, që lidhen me lejimin e aksesit dhe përdorimin e faciliteteve të një rrjeti specifik, sipas neneve 46 dhe 47 të këtij ligji;

12. Nuk zbaton detyrimet e imponuara, që lidhen me sigurimin e zgjedhjes ose parazgjedhjes së bartësit, sipas nenit 43 të këtij ligji;

13. Nuk zbaton detyrimet për ofertën referencë, sipas nenit 52 të këtij ligji;

14. Përdor frekuenca pa marrë autorizim për përdorimin e tyre, sipas nenit 65 të këtij ligji;

15. Përdor numra dhe seri numerike pa miratim të AKEP-it, sipas nenit 81 të këtij ligji;

16. Nuk jep të dhëna për rrjetin, sipas nenit 92 të këtij ligji;

17. Kryen mbikëqyrje, përgjim, ndërprerje, regjistrim, ruajtje dhe devijim të komunikimit dhe të dhënave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 123 pika 3 të këtij ligji;

18. Nuk përmbush detyrimet për përgjimin e ligjshëm, sipas nenit 131 të këtij ligji;

19. Nuk lejon inspektorët e AKEP-it të hyjnë në mjediset, ku gjenden pajisjet e komunikimit dhe pajisjet teknike, ose nuk dorëzon të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët, sipas nenit 132 pika 3 të këtij ligji;

20. Nuk përmbush detyrimet për ruajtjen e të dhënave, sipas neneve 101 dhe 101/1 të këtij ligji.

II. Me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për shkeljet e cilësuara në paragrafin I të këtij neni, të kryera nga personi fizik.

III. Me gjobë në vlerën nga 10 000 000 (dhjetë milionë) deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, për shkeljet e mëposhtme të kryera nga personi juridik:

1. Nuk ndërton apo krijon rrjete publike të komunikacioneve dhe facilitete shtesë që lidhen me to, për të mundësuar përdorimin e përbashkët të tyre, sipas pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji;

2. Nuk zbaton vendimin e AKEP-it për pagesën e përdorimit të përbashkët të rrjeteve dhe faciliteteve për sigurimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimit, sipas pikës 7 të nenit 22 të këtij ligji;

3. Në rast se sipërmarrësi i caktuar si ofrues i shërbimit universal për publikimin e numërorit bën diskriminimin në përfshirjen e të dhënave të operatorëve të ndryshëm në numërorin e përgjithshëm ose në rubrikën e shërbimeve të informacionit, sipas nenit 25 të këtij ligji;

4. Nuk zbaton tarifa të njëjta për shërbimet e siguruara nën skemën e shërbimit universal në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas pikës 2 të nenit 27 të këtij ligji;

5. Nuk përcakton tarifat dhe kushtet e përgjithshme të pagesës për shërbimet e veçanta të përfshira në skemën e shërbimit universal, sipas pikës 4 të nenit 27 të këtij ligji;

6. Nuk përmbush parametrat e cilësisë, për të paktën 3 periudha të njëpasnjëshme, sipas pikës 5 të nenit 28 të këtij ligji;

7. Nuk bën pagesën e nevojshme të kontributeve për mbulimin e kostove reale të shërbimit universal, brenda afatit kohor dhe në vlerën e përcaktuar nga AKEP-i, sipas pikës 4 të nenit 30 të këtij ligji;

8. Nuk paraqet në AKEP informacionin e kërkuar mbi të ardhurat vjetore, sipas pikës 5 të nenit 30 të këtij ligji;

9. Nuk i përgjigjet kërkesës për dhënien e ofertës së aksesit brenda afatit, sipas pikës 1 të nenit 46 të këtij ligji;

10. Nuk plotëson detyrimin për interkoneksion, sipas pikës 1 të nenit 47 të këtij ligji;

11. Nuk plotëson detyrimet për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave që shkëmbehen gjatë negociimit të interkoneksionit, sipas pikës 2 të nenit 47 të këtij ligji;

12. Transferon të drejtën e përdorimit të frekuencave pa miratimin paraprak të AKEP-it, sipas pikës 1 të nenit 74 të këtij ligji;

13. Nuk zbaton portabilitetin e numrit për pajtimtarët e tij, sipas nenit 87 të këtij ligji.

14. Nuk publikon informacion transparent për tarifat dhe për kushtet e përgjithshme për aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, sipas pikës 1 të nenit 98 të këtij ligji;

15. Nuk informon përdoruesit dhe AKEP-in për kufizimin ose ndalimin e aksesit në shërbimet e tyre, sipas pikës 2 të nenit 108 të këtij ligji;

16. Kufizon aksesin në shërbimet e tij, ndërpret ose përfundon kontratën e pajtimtarëve në kundërshtim me përcaktimin e kontratës, sipas pikës 1 të nenit 109 të këtij ligji;

17. Zbaton masa diskriminuese dhe jo-proporcionale, ndryshe nga sa përcaktohet në nenin 109 të këtij ligji;

18. Nuk informon me shkrim pajtimtarët e tij për shkeljet e bëra prej tyre, dhe nuk vendos një afat kohor për plotësimin e detyrimeve kontraktore, sipas pikës 3 të nenit 109 të këtij ligji;

19. Nuk harton dhe paraqet në AKEP planin e masave për situata të jashtëzakonshme, sipas pikës 2 të nenit 111 të këtij ligji;

20. Nuk përmbush detyrimet e pikës 1 të nenit 112 të këtij ligji;

21. Nuk siguron akses të pandërprerë në shërbimet e emergjencës brenda planit të masave, sipas nenit 113 të këtij ligji;

22. Nuk mbron dhe ruan konfidencialitetin e komunikimeve elektronike, sipas pikës 2 të nenit 121 të këtij ligji;

23. Përfiton për vete ose për ndonjë palë tjetër informacion mbi përmbajtjen, faktet dhe rrethanat e transmetimit të mesazhit në tejkalim të nivelit minimal të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve elektronike specifike, apo nuk i përdor këto të dhëna vetëm për ofrimin e shërbimit dhe në përputhje me kontratën specifike, sipas pikës 3 të nenit 123 të këtij ligji;

24. Nuk informon përdoruesit në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për qëllimin dhe përdorimin e të dhënave, apo nuk i jep mundësinë përdoruesit të refuzojë përdorimin e të dhënave, apo nuk merr miratimin paraprak të përdoruesit për përdorimin e të dhënave, sipas pikës 6 të nenit 123 të këtij ligji;

25. Nuk fshin të dhënat mbi trafikun, apo nuk i bën anonime këto të dhëna pas përfundimit të nevojës për transmetim të mesazhit, sipas pikës 1 të nenit 124 të këtij ligji;

26. Përpunon të dhëna mbi trafikun pa miratimin paraprak të përdoruesit apo pajtimtarit, sipas pikës 3 të nenit 124 të këtij ligji;

27. Lejon persona të paautorizuar të përpunojnë të dhëna mbi trafikun, sipas pikës 5 të nenit 124 të këtij ligji;

28. Nuk përpunon të dhëna për vendndodhjen, sipas përcaktimeve të nenit 126 të këtij ligji;

29. Lejon përdorimin e të dhënave mbi vendndodhjen nga ana e personave të paautorizuar, sipas pikës 5 të nenit 126 të këtij ligji;

30. Nuk vepron në përputhje me kërkesat e nenit 128 të këtij ligji për komunikimet pa kërkesë.

31. Shfuqizuar.

IV. Me gjorbë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë për shkeljet e cilësuar në paragrafin III të këtij neni, të kryera nga personi fizik.

V. Me gjorbë në vlerën deri në 1 000 000 (një milion) lekë, për shkeljet e mëposhtme të kryera nga personi juridik:

1. Nuk vepron në përputhje me kërkesat për miratimin dhe caktimin e frekuencave, sipas neneve 70 dhe 71 të këtij ligji;

2. Nuk vepron në përputhje me kushtet për përdorimin e numrave dhe serive numerike, sipas nenit 83 të këtij ligji;

3. Nuk planifikon rrjetet e komunikimeve elektronike, në mënyrë të tillë që të krijojnë sa më pak rreziqe dhe shqetësime ndaj pronës private, sipas pikës 3 të nenit 93 të këtij ligji;

4. Nuk njofton paraprakisht autoritetet përkatëse përpara fillimit të punimeve, sipas pikës 4 të nenit 93 të këtij ligji;

5. Kontrata e pajtimtarit nuk përmban të gjithë elementet e kërkuara, sipas pikës 1 të nenit 99 të

këtij ligji;

6. Nuk informon paraprakisht pajtimtarët për ndryshimin e kushteve të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 99 të këtij ligji;

7. Nuk i ofron pajtimtarëve një nivel të kënaqshëm të faturës së detajuar, në mënyrë që të lejojë pajtimtarin të kontrollojë shumën përfundimtare, sipas nenit 106 të këtij ligji;

8. Fatura e detajuar nuk i përmban të gjitha të dhënat, sipas pikës 3 të nenit 106 të këtij ligji;

9. Nuk siguron identifikimin e numrit të thirrur, si dhe parandalimin e tyre, sipas pikës 1 të nenit 125 të këtij ligji;

10. Në kushtet e përgjithshme të kontratës së pajtimtarit nuk saktëson mundësinë e sigurimit të CLI (identifikimin e numrit të thirrur), si dhe parandalimin e tij, sipas pikës 8 të nenit 125 të këtij ligji;

11. Nuk informon përdoruesin apo pajtimtarin për elementet e përshkruara në pikës 3 të nenit 126 të këtij ligji, para se ato të japin miratimin e tyre për përpunimin e të dhënave.

12. Nuk i ofron përdoruesit apo pajtimtarit mundësinë e refuzimit të përkohshëm të përpunimit të të dhënave të vendndodhjes, sipas pikës 4 të nenit 126 të këtij ligji;

13. Nëse të dhënat e pajtimtarit përdoren në kundërshtim me pikën 2 të nenit 129 të këtij ligji;

14. Nuk informon pa pagesë dhe paraprakisht pajtimtarin për numërorin dhe përdorimin e të dhënave në numëror, sipas pikës 1 të nenit 130 të këtij ligji;

15. Nuk i ofron mundësinë përdoruesit se cilat prej të dhënave dëshiron të përfshihen në numëror, sipas pikës 2 të nenit 130 të këtij ligji;

16. Refuzon që pa pagesë të mundësojë pajtimtarin që të verifikojë, të ndryshojë apo të fshijë të dhënat e numërorit, sipas pikës 3 të nenit 130 të këtij ligji;

17. Nuk paguan shumën e plotë për mbikëqyrjen e tregut, sipas pikës 3 të nenit 24 të këtij ligji;

18. Nuk paguan në kohë shumën e plotë për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas nenit 78 të këtij ligji;

19. Nuk paguan në kohë shumën e plotë për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike, sipas nenit 86 të këtij ligji.

VI. Me gjobë në vlerën deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për shkeljet e cilësuar në paragrafin V të këtij neni, të kryera nga personi fizik.

VII. Me gjobë në vlerën deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, për çdo shkelje tjetër të kryer nga personi juridik, të pacilësuar në pikat e mësipërme.

VIII. Me gjobë në vlerën deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë ndaj personit fizik, për shkeljet e cilësuar në paragrafin VII të këtij neni.

1/1. Në vendosjen e gjobave, sipas këtij neni, do të merret parasysh:

a) rëndësia dhe kohëzgjatja e kundërvajtjes;

b) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;

c) nëse kundërvajtësi rezultoi i dënuar administrativisht edhe më parë;

ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

2. Gjopa është titull ekzekutiv, që vilet nga AKEP-i dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit.

3. Kundër dënimit me gjobë bëhet ankim sipas nenit 136 të këtij ligji.

Neni 138

Dispozita kalimtare

1. Këshilli drejtues i ERT-së, i emëruar sipas ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vazhdon të funksionojë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Anëtarët e tij vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë brenda afatit të caktuar në mandatin e emërimit. Llogaritja e afatit të mandatit bëhet duke filluar nga data e emërimit të tyre.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave, të dala në zbatim të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në daljen e vendimeve përkatëse, në përputhje me këtë ligj.

3. Vendimet, urdhrat dhe udhëzimet e ERT-së dhe të ministrit mbeten në fuqi deri në daljen e vendimeve, të urdhrave dhe udhëzimeve, në përputhje me këtë ligj.

4. Të gjitha licencat e lëshuara në mbështetje të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mbeten në fuqi dhe veprojnë, pavarësisht nga shfuqizimi i këtij ligji, deri në çastin e ndryshimit të tyre, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, por jo më vonë se 6-muaj nga hyrja në fuqi e ligjit.

Dispozita të veçanta dhe kalimtare
(vendosur me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012)

1. AKEP-i imponon detyrime rregullatore, sipas neneve 43 e 44 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për aq sa është e nevojshme për të rregulluar dështimet e tregut dhe nëse detyrimet e imponuara rregullatore për tregjet me shumicë nuk janë të mjaftueshme.

2. Procedura e konkurrimit publik, sipas nenit 69 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, mund të mbështetet në një këshillim publik të kryer para se amendimet e neneve 68 dhe 69 të këtij ligji të hyjnë në fuqi.

3. Detyrimi për afatin e mbartjes së numrit, sipas pikës 9 të nenit 87 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, shtuar me pikën 4 të nenit 32 të këtij ligji, zbatohet 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Hyrja në fuqi e detyrimit për ruajtjen e të dhënave, të parashikuara në nenin 101 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 36 të këtij ligji, për shërbimin e internetit, zbatohet 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Neni 52 i këtij ligji zbatohet 6 muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

6. Emërimi i Kryetarit të Këshillit Drejtues dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues për mandatin e parë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të bëhen nga Kuvendi, për kryetarin për një periudhë 5-vjeçare, për dy prej anëtarëve për një periudhë 4-vjeçare dhe për dy anëtarët e tjerë për një periudhë 3-vjeçare.

7. Vendimet e Këshillit të Ministrave, të dala në zbatim të neneve 69, 117 dhe 119 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, mbeten në fuqi deri në daljen e vendimeve përkatëse, në përputhje me këtë ligj.

Neni 139
Shfuqizime

Ligji nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 140
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5747, datë 9.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.